

IRZ



Makavej, 2016



Republic of Macedonia  
Ministry of Justice  
Republika e Maqedonisë  
Ministria e Drejtësisë

FONDACIONI GJERMAN PËR  
BASHKËPUNIM NDERKOMBËTARE  
JURIDIK



Edicioni 3/2016

Publikationen zur rechtlichen Zusammenarbeit 2016


Buletini i praktikës gjyqësore të GJEPD

botuar nga  
Enti për përfaqësim të Republikës së  
Maqedonisë para GJEPD  
dhe  
Fondacioni gjerman për bashkëpunim  
ndërkombëtarë juridik, Shoqatë e  
regjistruar (IRZ)

Edicioni 3/2016

Buletini i praktikës gjyqësore të  
Gjykatës Evropiane për të drejtat e  
njeriut

Publikationen  
zur rechtlichen Zusammenarbeit



Buletini i praktikës gjyqësore të  
Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut

botuar nga  
Enti për përfaqësim të Republikës së Maqedonisë para GJEPD

dhe  
Fondacioni gjerman për bashkëpunim ndërkombëtarë  
juridik, Shoqatë e regjistruar (IRZ)

Edicioni 3/2016 në gjuhën shqipe



Newsletter zur Rechtsprechung des  
Europäischen Gerichtshofs für Menschenrechte

Gemeinsam herausgegeben von dem mazedonischen  
Regierungsvertreter vor dem EGMR

und der  
Deutschen Stiftung für internationale rechtliche  
Zusammenarbeit e.V. (IRZ)

Ausgabe 3/2016 in albanischer Sprache

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Botues:

MAKAVEJ Shkup, viti 2016

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Koço Bendo (faqe 5 - 55)

Behar Dalipi (faqe 56 - 76)

Koordinimi i redaksisë së edicionit në gjuhën shqipe: Dr. Shtefan Pirner, avokat dhe mr. Kostadin Bogdanov, v.d. Drejtor i Entit për përfaqësim të RM-së para GJEDNJ – Agjent i Qeverisë.

Bashkëpunimi i redaksisë së edicionit në gjuhën shqipe: Dragana Radisavlleviq, jurist i diplomuar me provimin e dhënë të judikaturës dhe Dana Trajçev – Bozhiq, V.A., studime për media dhe komunikime.

Përkthimi i këtij Buletini në gjuhën shqipe, si dhe botimi i këtij publikimi u mundësua nga ana e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ndërkombëtarë juridik, shoqatë e regjistruar (IRZ).

## Përmbajtja

### I. AKTGJYKIMET MË TË REJA TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

<b>Haász dhe Szabó v. Hungarisë</b> - 11327/14 dhe 11613/14 Vendimi 13.10.2015 (Seksioni II) .....	5
<b>M. Özel dhe të tjerë kundër Turqisë</b> - 14350/05, 15245/05 dhe 16051/05 Vendimi 17.11.2015 (Seksioni II) .....	7
<b>Bouyid kundër Belgjikës</b> - 23380/09 Vendimi 28.9.2015 (GC) .....	8
<b>Lykova kundër Rusisë</b> - 68736/11 Vendimi 22.12.2015 (Seksioni III) .....	10
<b>Cingilli Holding A.Ş. dhe Cingilloğlu kundër Turqisë</b> - 31833/06 dhe 37538/06 Vendimi 21.7.2015 (Seksioni II) .....	12
<b>Dvorski kundër Kroacisë</b> - 25703/11 Vendimi 20.10.2015 (GC) .....	13
<b>Turbylev kundër Rusisë</b> - 4722/09 Vendimi 6.10.2015 (Seksioni I).....	15
<b>Sakit Zahidov kundër Azerbaxhanit</b> - 51164/07 Vendimi 12.11.2015 (Seksioni I) .....	16
<b>Mikhaylova kundër Rusisë</b> - 46998/08 Vendimi 19.11.2015 (Seksioni I) .....	17
<b>Kristiansen kundër Norvegjisë</b> - 1176/10 Vendimi 17.12.2015 (Seksioni V).....	19
<b>Schatschaschwili kundër Gjermanisë</b> - 9154/10 Vendimi 15.12.2015 (GC) .....	20
<b>Oliari dhe të tjerë kundër Italisë</b> - 18766/11 dhe 36030/11 Vendimi 21.7.2015 (Seksioni IV) .....	22
<b>Nazarenko kundër Rusisë</b> - 39438/13 Vendimi 16.7.2015 (Seksioni I) .....	24
<b>M. dhe M. kundër Kroacisë</b> - 10161/13 Vendimi 3.9.2015 (Seksioni I) .....	25
<b>Sérvulo &amp; Associados - Sociedade de Advogados, RL, dhe të tjerë kundër Portugalisë</b> - 27013/10 Vendimi 3.9.2015 (Seksioni I)] .....	27
<b>Khan kundër Gjermanisë</b> - 38030/12 Vendimi 23.4.2015 (Seksioni V) .....	30
<b>S.H. kundër Italisë</b> - 52557/14 Vendimi 13.10.2015 (Seksioni IV) .....	31
<b>Roman Zakharov kundër Rusisë</b> - 47143/06 Vendimi 4.12.2015 (GC).....	32

<b>Szafrański kundër Polonisë</b> - 17249/12 Vendimi 15.12.2015 (Seksioni IV) .....	37
<b>Ebrahimian kundër Francës</b> - 64846/11 Vendim 26.11.2015 (Seksion V) .....	38
<b>Langner kundër Gjermanisë</b> - 14464/11 Vendim 17.9.2015 (Seksioni V) .....	40
<b>Pentikäinen kundër Finlandës</b> - 11882/10 Vendim 20.10.2015 (GC).....	42
<b>Annen kundër Gjermanisë</b> - 3690/10 Vendim 26.11.2015 (Seksioni V).....	44
<b>Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés kundër Francës</b> - 40454/07 Vendimi 10.11.2015 (GC) .....	46
<b>Kudrevičius dhe të Tjerë kundër Lituaniës</b> - 37553/05 Vendimi 15.10.2015 (GC).....	49
<b>Konstantin Stefanov kundër Bullgarisë</b> - 35399/05 Vendimi 27.10.2015 (Seksioni IV).....	52
<b>Ünsped Paket Servisi SaN. Ve TiC. A.Ş. kundër Bullgarisë</b> - 3503/08 Vendimi 13.10.2015 (Seksioni IV) .....	53
<b>Gahramanli dhe të Tjerë kundër Azerbajxhanit</b> - 36503/11 Vendimi 8.10.2015 (Seksioni I) .....	54

## II. AKTGJYKIME KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

<b>Gerovska – Popçevska kundër Republikës së Maqedonisë</b> , A numër. Ankesa nr. 48783/07, aktgjykimi i datës 07.01.2016 .....	56
<b>Jakshovski dhe Trifunovski kundër Republikës së Maqedonisë</b> , ankesa numër 56381/09 dhe numër 58738/09, aktgjykimi i datës 07.01.2016 .....	58
<b>Poposki dhe Duma kundër Republikës së Maqedonisë</b> , ankesat me numër 69916/10 dhe 36531/11, lidhur me aktgjykimin e datës 07.01.2016.....	61
<b>Neshkoska kundër Republikës së Maqedonisë</b> , A.nr. Ankesa numër 60333/13, aktgjykimi i datës 21.01.2016.....	65
<b>Ivanovski kundër Republikës së Maqedonisë</b> , A. numër 29908/11, aktgjykimi i datës 21.01.2016 .....	68
<b>Mitrova dhe Savia kundër Republikës së Maqedonisë</b> , A. numër 42534/09 , aktgjykimi i datës 11.02.2016.....	73

## I. AKTGJYKIME MË TË REJA TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

### Neni 2

Përdorimi i pajustificuar i forcës potencialisht vdekje-prurëse nga një punonjës policie jashtë detyre: Neni 2 i zbatueshëm; shkelje

**Haász dhe Szabó v. Hungarisë** - 11327/14 dhe 11613/14 Vendimi 13.10.2015 (Seksioni II)

**Faktet** – Kërkueset janë dy gra, Zj Haász (kërkuesja e parë) dhe Zj Szabó (kërkuesja e dytë). Pas kthimit nga një ekskursion tek një liqen, ato vendosën të kalonin natën në makinë. Gjatë natës një nëpunës vullnetar i zbatimit të ligjit u vu në dijeni që ishte parë një makinë e dyshimtë. Ai njoftoi një nëpunës policie që nuk ishte me shërbim dhe të dy ata shkuan të kërkonin makinën. Me të vënë re makinën e kërkueseve, ata e parkuan makinën në mënyrë të tërthorte para saj, dhe dolën nga makina dhe filluan të vraponin drejt saj. Kërkuesja e parë, e trembur nga pamja e dy njerëzve me veshje civile që vraponin drejt saj, tentoi t'u ikte me makinë. Nëpunësi i policisë i bëri shenjë makinës duke thirrur “Policia! Ndal!” dhe shtiu në ajër. Pastaj ai shtiu dy herë të tjera drejt makinës, ku e shtëna e dytë ishte shumë afër kokës së kërkueses së dytë. Nëpunësi e uli armën dhe paraqiti ID-në e tij të policisë dhe në këtë moment u bë e qartë që incidenti ishte shkaktuar nga një keqkuptim. Eprori i nëpunësit të policisë, i cili hetoi përdorimin e armës nga nëpunësi, nxori përfundimin që, ndërsa ai nuk kishte qëllim për të rrezikuar jetën e tyre, verimet e tij ishin joprofesionale. Zyra e prokurorisë e ndërpreu hetimin penal duke konstatuar që përdorimi i armës nga nëpunësi i policisë ishte i ligjshëm për shkak të rrezikut që kishte makina duke iu afruar atij dhe duke pranuar deklarimin e nëpunësit që ai kishte shtënë pasi ai besoi që jeta e kolegut të tij ishte në rrezik. Në kërkesën e tyre në Gjykatën Evropiane, kërkueset u ankuan për shkelje komponentëve lëndorë edhe proceduralë të Nenit 2 të Konventës. Kërkesa e kërkuesit të dytë u deklarua e papranueshme pasi u paraqit jashtë afatit.

**Ligji** - Neni 2

(a) *Zbatueshmëria* - Fakti që forca e përdorur ndaj kërkueses së parë nuk ishte vdekjeprurëse nuk përjashton shqyrtimin e ankimeve të saj sipas Neni 2. Megjithatë nëpunësi i policisë nuk kishte ndërmend ta vriste atë, përdorimi i një arme zjarri duke shtënë drejt saj dhe duke i kaluar plumbi afër kokës së kërkueses së dytë kishte gjeneruar rrezikun e dëmtimit të rëndë ose humbjen e jetës. Kështu, ajo ishte viktimë e sjelljes që, sipas natyrës së saj, e vuri jetën e saj në rrezik dhe këtu zbatohet Neni 2.

(b) *Komponenti lëndor* - Megjithëse aktiviteti policor nuk ishte i para-planifikuar, ky nuk ishte një rast në të cilin nëpunësit e zbatimit të ligjit ishin thirrur për të reaguar në rrethana të paparashikuara të urgjencës, meqenëse i gjithë incidenti kishte ndodhur kryesisht për shkak të sjelljes së vetë nëpunësit të policisë. Në këto rrethana, ndërsa nevoja për të përdorur forcë potencialisht vdekje-prurëse erdhi si rezultat i një serie vendimesh dhe masash të marra nga një nëpunës policie, ato vendime do të rrezikonin përgjegjshmërinë e shtetit në të njëjtën masë si dhe planifikimi dhe kontrolli i operacioneve policore. Nëpunësi i policisë kishte ndërhyrë për të ndaluar makinën e kërkueseve, pasi ai besonte që kishte rrezik që ajo të shtypte kolegun e tij. Megjithatë, pas zbulimit të automjetit, nëpunësit kishin konstatuar që nuk kishte ndonjë shenjë të ndonjë veprimi kriminal. Nuk kishte nevojë për veprim të menjëhershëm, qoftë për të kryer një arrest, apo për të parandaluar kryerjen e një krimi. Duke iu afuar kërkueseve dhe duke bllokuar rrugën e makinës së tyre, nëpunësit nuk i kushtuan vëmendje faktit që asnjë nga personat në makinë nuk kërkohet nga policia apo të përbënte ndonjë rrezik të njohur. Kërkueset nuk mund ta dinin që personat që po i afroreshin makinës së tyre ishin nëpunës të zbatimit të ligjit, meqenëse nëpunësit ishin veshur me rroba civile, nuk kishin distinktiv dhe ishin me një makinë civile. Afrimi tek makina pa ndonjë identifikim të dukshëm dhe krijimi i një mjedisi rreziku duke bllokuar rrugën e makinës kishte sjellë si rezultat kundërveprimin e paparashikueshëm nga ata që ishin brenda makinës. Përveç kësaj, sjellja e të dy nëpunësve të policisë ishte pa asnjë udhëzim apo mbikëqyrje nga ndonjë nëpunës epror. Përfundimisht, sjelljet e nëpunësve të policisë para të shtënave nuk ishin të arsyeshme në dritën e informacionit të marrë në lidhje me natyrën e kërcënimit faktik dhe nuk ishin kryer në një mënyrë të tillë që të minimizohet rreziku i ngjarjeve që sollën një situatë të kërcënimit të jetës, e cila kulmoi me përdorimin e armëve të zjarrit.

**Përfundim:** shkelje (unanimisht).

(c) *Komponenti procedural* - Vlerësimi i ngjarjeve nga autoritetet e brendshme - i cili nuk përfshin ndonjë konstatim gjyqësor - ishte kufizuar në shqyrtimin nëse nëpunësit e policisë kishin kryer ndonjë vepër penale nëpërmjet të shtënave të kritikuara, pa e shqyrtuar këtë në një kontekst më të gjerë të incidentit apo të ngjarjeve që sollën atë. Veçanërisht, nuk ka patur shqyrtim të mënyrës në të cilën ishte kryer operacioni për të gjurmuar dhe ndaluar kërkueset dhe të efektit që ai kishte për domosdoshmërinë e përdorimit të një arme zjarri. Kështu ka patur mungesë të hetimit të plotë dhe të efektshëm në lidhje me nevojën e përdorimit të forcës potencialisht vdekje-prurëse.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: 15 000 EURO për kërkuesen e parë në lidhje me dëmin jo-financiar; pretendimi në lidhje me dëmin financiar rrëzohet.

Dështimi i shtetit në konstatimin e përgjegjësive për vdekjen e viktimave të tërmetit: shkelje

**M. Özel dhe të tjerë kundër Turqisë** - 14350/05, 15245/05 dhe 16051/05 Vendimi 17.11.2015 (Seksioni II)

**Faktet** - Të afërmit e kërkueseve ishin viktimat e një tërmeti i cili në vitin 1999 shkaktoi rrëzimin e godinave në të cilat ata banonin në qytetin Çirnacik. Para Gjykatës Evropiane, kërkuesit u ankuan në lidhje me shkeljen e të drejtës së jetës së të afërmeve të tyre, që mbrohet nga Neni 2. Veçanërisht, ata akuzuan autoritetet bashkiake që kishin autorizuar ndërtesat të ndërtonin blloqe pallatesh ose kate të tjera në zonën ku ka aktivitet sizmik dhe që nuk kishin bërë inspektimet e nevojshme për të garantuar përputhshmërinë e ndërtesave ose për të parandaluar ndërtimin e tyre. Ata u ankuan gjithashtu në lidhje me zhvillimin e procedimeve penale dhe në lidhje me paaftësinë e tyre për të garantuar ndjekjen penale të nëpunësve të shërbimit civil që ata konsideronin përgjegjës.

**Ligji** - Neni 2

(a) *Komponenti lëndor* - Detyrimi i Shtetit për parandalimin në lidhje me dëmet nga tërmetet, sipas komponentit lëndor të Nenit 2, konsistonte kryesisht në marrjen e masave për të ulur efektet e tij për të kufizuar masën e katastrofës me sa të jetë e mundur, veçanërisht nëpërmjet planifikimit urban dhe kontrollit mbi zhvillimin urban. Gjykata vuri re që autoritetet kishin qenë të ndërgjegjshëm për rrezikun e tërmeteve në zonat e dëmtuara. Megjithatë, tërmeti në fjalë kishte pasojë katastrofike në kuptimin e jetës njerëzore duke patur parasysh rrëzimin e ndërtesave që nuk përmbushnin standardet e sigurisë dhe ndërtimit që zbatohen në zonat përkatëse. Në këtë kontekst, doli e qartë që autoritetet lokale, roli i të cilave ishte monitorimi dhe inspektimi i ndërtimeve, nuk i kishin përmbushur detyrat e tij në këtë mënyrë. Megjithatë, Gjykata konstatoi që kjo pjesë e ankesës ishte jashtë afatit, pasi kërkesat ishin paraqitur më vonë se gjashtë muaj pas vendimeve të autoriteteve të brendshme në lidhje me ankimin sipas komponentit lëndor të Nenit 2, dhe në këtë mënyrë e rrëzon atë.

**Përfundimi:** i papranueshëm (jashtë afatit)

(b) Kundër ndërtesave të ndërtesave që ishin rrëzuar dhe individëve të përfshirë drejtpërdrejt në ndërtimin e tyre kishte filluar procedimi penal dhe kërkuesit kishin ndërhyrë në procedim si palë të treta. Duke njohur që çështja ishte komplekse duke patur parasysh numrin e viktimave, Gjykata vuri re që vetëm pesë individë ishin ndjekur penalisht dhe raportet e ekspertëve që përcakttonin defektet dhe rrethanat që kishin shkaktuar rrëzimin e ndërtesave dhe përgjegjësitë e ndryshme të përfshira ishin ofruar në një fazë të hershme. Rëndësia e hetimit duhet ti kishte bërë autoritetet që ta trajtonin atë shpejt me qëllim që të evitonin çdo shfaqje tolerimi të veprimeve të paligjshme ose fshehjen e këtyre veprimeve. Kohëzgjatja e procedimit nuk përmbushte kërkesën e një hetimit të menjëhershëm të çështjes pa vonesë të panevojshme. Vetëm dy të pandehur ishin konstatuar përgjegjës, ndërsa procedimi



ishite parashkruar në lidhje me tre të tjerët. Përveç kësaj, përpjekjet nga disa prej kërkuesve për të detyruar autoritetet të fillonin hetimin penal në lidhje me punonjësit e shërbimit civil nuk patën sukses për shkak të mungesës së autorizimit paraprak administrativ. Së fundmi, kërkuesit që kishin ngritur padi civile për kompensim duhej të prisnin ndërmjet tetë dhe dymbëdhjetë vjet para se gjykatat civile të jepnin vendimet e tyre dhe shumat e dhëna atyre për dëmin jo-financiar si rezultat i vdekjes së të afërmeve të tyre ishin minimale. Gjykata në këtë mënyrë çmoi që padia civile për kompensim, në rrethanat e çështjes, nuk ishte një mjet i cili mund të konsiderohej si efektiv.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: 30 000 EURO i jepet çdo kërkuesi ose çifti kërkuesish në lidhje me dëmin jo-financiar; pretendimi në lidhje me dëmin financiar rrëzohet.

### Neni 3

Trajtim degradues Pretendimi i goditjes më shpullë nga nëpunësit e policisë gjatë intervistimit nga policia: *shkelje*

***Bouyid kundër Belgjikës*** - 23380/09 Vendimi 28.9.2015 (GC)

**Fakte** - Kërkuesit, dy vëllezër, një prej të cilëve ishte i mitur në momentin përkatës, u morën në pyetje veçmas nga policia në lidhje me incidente të veçantë. Secili prej tyre pretendoi që ata ishin rrahur me shpulla në fytyrë nga punonjësit e policisë. Ata bënë ankesë dhe kërkuan të ndërhynin si palë civile, por paditë e tyre ishin të pasuksesshme.

Me Vendimin e datës 21 nëntor 2013 (Shih Shënimin Informativ 168), një Dhomë e Gjykatës ishte e mendimit unanimisht që nuk ka patur shkelje të nenit 3.

**Ligji** - Neni 3 (Aspekti lëndor)

(a) *Konstatimi i fakteve* - Me qëllim që të përfitohet nga prezumimet e fakteve, individët që pretendojnë të jenë viktima të një shkeljeje të Nenit 3 të Konventës duhet të demonstrojnë që ata shfaqin shenjat e keqtrajtimit të shkaktuara kur ata ishin nën kontrollin e policisë ose të një autoriteti të ngjashëm. Vërtetimet mjekësore të dhëna nga kërkuesit, që ishin përpiluar në ditën në fjalë menjëherë pas largimit të kërkuesve nga rajoni i policisë, përmendin skuqje dhe enjtje që mund të jenë shkaktuar nga shpullat në fytyrë. Për më tepër, nuk diskutohej që kërkuesit nuk kishin demonstruar shenja të tilla kur ata ishin futur në rajonin e policisë. Së fundmi, punonjësit përkatës të policisë, gjatë gjithë procedimit të brendshëm refuzuan prerë goditjen me shpullë të kërkuesve, ndërsa të fundit deklaruan prerë të kundërtën. Për më tepër, duke patur parasysh mangësitë e mëdha në procedimin penal të zhvilluar, vërtetësia e deklarimeve të punonjësve të policisë nuk mund të nxirret vetëm nga fakti që hetimet nuk dhanë informacion të kundërt. As nuk ka ndonjë provë për të mbështetur teorinë

e paraqitur nga Qeveria në seancë (por jo para gjykatave të brendshme) që kërkuesit mund të ishin goditur vetë me shpullë për të patur një çështje kundër policisë. Gjykata e konsideroi të provuar në masë të mjaftueshme që shenjat e përshkruara nga certifikatat e dhëna nga kërkuesit ishin shkaktuar kur ata ishin nën kontrollin e punonjësve të rajonit të policisë.

- (b) *Klasifikimi i trajtimit të dhënë kërkuesve* - Qeveria thjesht refuzoi që të ishin dhënë shpulla. Dukej nga dosja e çështjes që çdo shpullë ishte një veprim impulsiv në përgjigje të një sjelljeje të perceptuar si pa respekt, që ishte natyrisht e pamjaftueshme për të vërtetuar domosdoshmërinë e përdorimit të kësaj force fizike. Për pasojë, dinjiteti i kërkuesve ishte minuar dhe ka patur një shkelje të Nenit 3 të Konventës. Gjykata theksoi që administrimi i një shpulle nga punonjësi i policisë ndaj një personi i cili është tërësisht nën kontrollin e tij është shkelje e rëndë e dinjitetit të këtij të fundit. Një shpullë në fytyrë ka një ndikim të konsiderueshëm tek personi që e pëson atë, për shkak se kjo prek atë pjesë të trupit të njeriut që shpreh individualitetin e tij, manifeston identitetin e tij social dhe qendrën e shqisave të tij - të parët, të folurën dhe të dëgjuarën - që përdoren për komunikimin me të tjerët. Duke ditur që është e mjaftueshme që viktima të jetë përlulur në sytë e veta për të patur një trajtim poshtëruar në kuptimin e Nenit 3, një shpullë - edhe nëse është e izoluar, e paparamenduar dhe pa efekte të rënda ose në vazhdim mbi personin që e pëson atë - mund të perceptohet si poshtërim nga personi që e pëson atë. Kur shpulla jepet nga punonjësit e policisë individëve që janë nën kontrollin e tyre, kjo thekson raportin e superioritetit/inferioritetit. Fakti që viktimat e dinë që një veprim i tillë është i paligjshëm, përbën një shkelje të etikës morale dhe profesionale nga punonjësit dhe është e papranueshme, mund të nxisë tek ta ndjenjën e trajtimit arbitrar, padrejtësisë dhe pafuqisë. Për më tepër, Personat që mbahen në ndalin policore ose që thjesht shoqërohen apo thirren në një rajon policie për një kontroll identiteti ose intervistim - siç ishte rasti i kërkuesve - dhe më gjerë të gjithë personat nën kontrollin e policisë ose autoritetit të ngjashëm, janë në një situatë vulnerabiliteti. Autoritetet që kanë detyrën ti mbrojnë ata e shpërfillin detyrën duke i poshtëruar nëpërmjet një shpulle. Fakti që shpulla mund të jetë administruar pa u menduar nga një punonjës policie i cili shtyhej nga sjellja pa respekt dhe provokuese e viktimsë është irrelevante. Dhoma e Madhe ndahej nga qëndrimi i Dhomës në këtë pikë. Konventa e ndalon me terma absolute torturën dhe trajtimin dhe dënimin çnjerëzor dhe poshtëruar, pavarësisht sjelljes së personit në fjalë. Në një shoqëri demokratike, keqtrajtimi nuk është asnjë herë përgjigje e përshtatshme për problemet që hasen nga autoritetet. Veçanërisht policia nuk duhet të "shkaktojë, nxisë apo tolerojë asnjë veprim dhune ose trajtimi apo dënimi çnjerëzor ose degradues në asnjë rrethanë" (Kodi Europian i Etikës Policore). Për më tepër, Neni 3 i Konventës i cakton Shtetit detyrimin pozitiv të trajtojë punonjësit e zbatimit të ligjit në mënyrë të tillë që të garantojë nivelin e lartë të tyre në sjelljen profesionale kështu që askush të mos i nënshtrohet torturës ose trajtimit që është në kundërshtim me këtë dispozitë. Së fundmi, kërkuesi i parë ka qenë i mitur në momentin përkatës. Është thelbësore që nëpunësit e zbatimit të ligjit të cilët janë në kontakt me të miturit në ushtrim të detyrave të tyre të marrin parasysh si duhet

vulnerabilitetin karakteristik për moshën e tyre të re. Sjellja e policisë ndaj të miturve mund të jetë në papajtueshmëri me kërkesat e Nenit 3 të Konventës thjesht sepse ata janë të mitur, ndërsa kjo mund të konsiderohet e pranueshme në rastet e madhorëve. Kështu, nëpunësit e zbatimit të ligjit duhet të tregojnë vigjilencë më të madhe dhe vetë-kontroll në trajtimin e të miturve. Si përfundim, shpulla e administruar tek secili prej kërkuesve nga punonjësit e policisë ndërsa ata ishin në kontrollin e tyre në rajonin e policisë nuk përputhej me aplikimin e forcës që ishte e domosdoshme në sjelljen e tyre dhe në këtë mënyrë kishte prekur dinjitetin e tyre. Duke ditur që kërkuesit iu referuan vetëm dëmtimeve të lehta trupore dhe nuk demonstuan që ata kishin pësuar ndonjë vuajtje të rëndë fizike dhe mendore, trajtimi në fjalë nuk mund të përshkruhej, *a fortiori*, si torturë çnjerëzore. Kështu, Gjykata konstatoi që kjo çështje përfshinte trajtim poshtëruës.

**Përfundim:** shkelje (katërmbëdhjetë vota me tre).

*Neni 3 (aspekti procedural):* Autoritetet hetuese nuk u kishin kushtuar vëmendjen e duhur pretendimeve të kërkuesve, megjithë vërtetimit nëpërmjet vërtetimeve mjekësore që ata kishin paraqitur për t'u përfshirë në dosjen e çështjes, ose në natyrën e veprimit, që përfshin një nëpunës të zbatimit të ligjit në dhënien e një shpulle një individi që ishte tërësisht nën kontrollin e tij. Për më tepër, Gjykata vëren kohëzgjatjen e pazakontë të hetimit. Pothuaj pesë vjet kaluan nga ankimi i parë i kërkuesve dhe vendimi i Gjykatës së Kasacionit i cili shënon mbylljen e gjykimit dhe një periudhë prej më shumë se katër vjet dhe tetë muaj kishte kaluar në çështjen e kërkuesit të dytë. Kështu, kërkuesit nuk kishin përfutur nga një hetim i efektshëm

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: 5 000 Euro secili në lidhje me dëmin jo-financiar.

Trajtimi poshtëruës dhe intensiv i shkaktuar për marrjen e një deponimi gjatë ndalimit të paregjistruar: shkelje

**Lykova kundër Rusisë** - 68736/11 Vendimi 22.12.2015 (Seksioni III)

**Fakte** - I biri i kërkuesit ("viktima") dhe një shok i tij u shoqëruan në një rajon policie të dyshuar për një vjedhje. Disa orë më vonë viktima u hodh nga dritarja në katin e pestë. Ai vdiq në spital ditën tjetër. E afërmja i viktimës, pasi nuk ishte dëgjuar gjë prej tij, e gjeti trupin e tij në morg. Duke parë disa dëmtime trupore, ajo kërkoi hapjen e hetimit, por nuk pati sukses. Hetuesi i rrethit konstatoi që vdekja dhe dëmtimet trupore ishin shkaktuar nga rënia. Një hetues tjetër nga i njëjti departament refuzoi të hapte hetimin penal ndaj nëpunësit të policisë në fjalë. Kërkuesi e ankimoi vendimin por pa sukses. Ndërkohë, ishte hapur një hetim penal në lidhje me shokun e viktimë ("dëshmitari"). Ai tregoi gjatë intervistës që ai kishte qenë i pranishëm gjatë keqtrajtimit të viktimës dhe akuzoi si përgjegjës veçanërisht një nga punonjësit e policisë.

**Ligi - Neni 3 (aspekti lëndor):** Në mbështetje të deklarimeve të dëshmitarit, kërkuesi paraqiti një ndodhi të qartë dhe të prerë për trajtimin që i biri i tij kishte marrë nga policia. Përveç kësaj, raporti i autopsisë tregoi dëmtime të shumta që nuk ekzistonin kur ai mbërriti në rajonin e policisë. Qeveria e interpretoi raportimin e mjekut sikur i lidhte të gjitha dëmtimet me rënien nga kati i pestë dhe në këtë mënyrë i kundërshtoi pretendimet e keqtrajtit. Raporti tregoi që dëmtimet në fjalë nuk kishin të bënin fare me rënien. Për më tepër, Gjykata nuk shihte asnjë shkak të vinte në dyshim dëshminë e dëshmitarit, që përputhej me natyrën dhe pozicionin e dëmtimeve të identifikuar në trupin e viktimës. Përveç kësaj, dëshmitari u kishte dhënë autoriteteve kompetentë të brendshme, para paraqitjes së raportit të autopsisë, disa mundësi për verifikimin e akuzave të saj. Por ankimet e saj dhe ofertat për dëshmi ishin injoruar nga autoritetet. Së fundmi, versioni i kërkuesit ishte akoma më i besueshëm pasi autoritetet nuk kishin shpjeguar asnjëherë shkakun e dëmtimeve të viktimës, përveç se ato të rënies. Për më tepër, vendimi në lidhje me mbylljen e hetimeve bazohej në deklarime që përmbanin mospërputhje të dukshme, veçanërisht në lidhje me kronologjinë e ngjarjeve. Në këto rrethana, shpjegimet e Qeverisë nuk ishin të mjaftueshme në sugjerimin që dëmtimet që nuk lidheshin me rënien kishin një shkak tjetër nga keqtrajtimi i shkaktuar në rajonin e policisë. Për pasojë, gjykata e konstatoi të vërtetuar që viktima i ishte nënshtruar një trajtimi në shkelje me Nenin 3 të Konventës. Në lidhje me intensitetin e veprimeve të dhunës, sipas versionit të dëshmitarit, policia kishte rrahur viktimën duke përpjasur kokën në sipërfaqe të forta disa herë. Kjo ishte shoqëruar me periudha asfiksie, duke shkaktuar dhimbje dhe vuajtje të forta. Viktima së fundmi ishte poshtëruar duke e marrë këtë trajtim në gjendje të zhveshur dhe me këmbë dhe duar të lidhura. Trajtimi për të cilin ishte bërë ankesë kishte ndodhur gjatë një periudhe ndalimi të paregjistruar, që mund të kishte përkeqësuar vulnerabilitetin e viktimës, që mbahej në rajonin e policisë dhe i privuar për shumë orë nga garancitë procedurale që i ofroheshin personit të ndaluar. Përveç kësaj, keqtrajtimi ishte bërë me synimin e detyrimit për të pranuar fajin. Duke ditur sa më sipër, Gjykata ishte e bindur që veprimet e dhunës të ushtruar mbi viktimën, të marra si një e tërë, kishin provokuar dhimbje dhe vuajtje ‘të fortë’ dhe ishin tepër të rënda dhe të egra në natyrë. Këto veprime duhej të konsideroheshin si akte dhune në kuptimin e Nenit 3 të Konventës.

**Neni 2 (aspekti lëndor):** Kjo çështje nuk përmbante asgjë për të treguar, tej dyshimit të arsyeshëm, që vdekja e viktimës ishte shkaktuar me qëllim nga punonjësit e Shtetit. Ishte vërtetuar që ai ishte hedhur vetë nga dritarja. Mbetej të vërtetohej nëse autoritetet mund të bëheshin përgjegjës për hedhjen e tij. Gjykata pati mendimin që nuk ishte e nevojshme të vërtetohej nëse autoritetet që kishin arrestuar viktimën kishin informacion për ekzistencën e rrethanave personale që mund ta shtynin atë drejt vetëvrasjes - informacion ky që, nëse është i tillë, do ti bënte atë të ndërmerrnin hapa për të parandaluar këtë veprim. Vulnerabiliteti i viktimës në momentin e rënies së tij lidhej para së gjithash me torturën që ushtrohej ndaj tij nga punonjësit e policisë. Gjykata kishte vërtetuar që viktima ishte torturuar në prani të dëshmitarit. Nuk mund të përjashtohet që viktima ishte torturua edhe më vonë, meqenëse dëshmitari deklaroi që ai e dëgjoji atë të bërtiste gjatë orës në vazhdim. Gjatë asaj kohe, viktima kishte pranuar dhe pastaj ishte

hedhur nga dritarja. Viktima kishte hyrë në ndërtesë i gjallë dhe kishte vdekur pas rënies nga kati i pestë i rajonit të policisë. Gjykata konstatoi fillimisht që versioni i Qeverisë i vetëvrasjes për arsye personale nuk ishte bindës, pasi nuk mernte parasysh faktin e vërtetuar që kërkuesi po torturohej ose për ndalimin e pa-protokolluar. Së dyti, Gjykata nuk mund të nxirrte ndonjë përfundim bindës nga hetimi, që ajo e konsideroi si të paefektshëm. Për pasojë, pasi konstatoi që as Qeveria dhe as hetimi i brendshëm nuk kishte dhënë shpjegime bindëse për vdekjen e viktimës, Gjykata pati mendimin që autoritetet ruse ishin përgjegjës për rënien fatale të viktimës. Nuk i takonte Gjykatës që në këtë çështje të diskutonte përgjegjësinë individuale të ndonjë punonjësi të policisë që ishte i pranishëm për neglizhencë duke ditur mbikëqyrjen e tyre të pamjaftueshme për sjelljen e viktimës. Kështu Gjykata ishte e mendimit që autoritetet ruse duhej të bëheshin përgjegjëse, në bazë të Konventës, për vdekjen e viktimës, që ishte torturuar gjatë një kohe ndalimi të pa-protokolluar, kur atij i ishin hequr të gjitha të drejtat që normalisht u jepeshin personave të ndaluar.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Gjykata konstatoi gjithashtu unanimisht që ka patur një shkelje të Neni 5 par 1, të Konventës në lidhje me heqjen e lirisë së viktimës, dhe shkelje të Neneve 2 dhe 3 në aspektin procedural, duke ditur që hetimi penal i zhvilluar pas vdekjes së viktimës dhe akuzave të keqtrajtitimit nuk kishin përmbushur kushtin e domosdoshëm të 'efektshmërisë'.

Neni 41: 45 000 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar; 8 500 Euro në lidhje me dëmin financiar.

## Neni 6

### Neni 6 § 1 (ekzekutimi)

Aksesi në gjykatë Mos-shqyrtimi nga ana e Autoriteteve i zgjidhjeve alternative kur ekzekutimi i një vendimi gjyqësor *restitutio in integrum* ishte e pamundur: *shkelje*

***Cingilli Holding A.Ş. dhe Cingilloğlu kundër Turqisë*** - 31833/06 dhe 37538/06 Vendimi 21.7.2015 (Seksioni II)

**Fakte** - Çështja ka të bëjë me transferimin dhe shitjen pasuese të Demirbank në vitin 2000, banka e pestë private nga madhësia në atë kohë. Kërkuesit ishin aksionarët e saj kryesorë. Në dhjetor 2000, Bordi i Rregullimit dhe Mbikëqyrjes Bankare ("Bordi") ia transferoi menaxhimin dhe kontrollin e Demirbankës Fondit të Sigurimit të Depozitave të Kursimeve ("Fondi") për shkak se sendet pasurore të Demirbankës nuk ishin të mjaftueshme për të mbuluar detyrimet dhe që vazhdimi i aktiviteteve të saj do të kërcënonte sigurinë dhe stabilitetin e sistemit financiar. Në një vendim të datës 5 nëntor 2004, Gjykata e Lartë Administrative anuloi marrjen e bankës nga Fondi duke konstatuar

që marrja ishte e paligjshme për sa kohë nuk ishin hetuar opsione të tjera. Në vitin 2001, ndërsa gjykimi nuk kishte përfunduar, Fondi ia shiti Demirbankën Bankës HSBC. Marrëveshja për shitjen e Demirbankës u anulua nga gjykatat turke në vitin 2004. Kërkesit i kërkuan Agjencisë së Rregullimit dhe Mbikëqyrjes Bankare (“Agjencia”) ekzekutimin e vendimeve gjyqësor dhe kthimin e Demirbankës pronarëve të mëparshëm. Në vitin 2006, Agjencia i informoi ata që kjo do të ishte e pamundur pasi, pas shitjes së saj tek HSBC-ja, Demirbanka ishte ç’regjistruar nga regjistri tregtar.

**Ligji - Neni 6, par 1, i Konventës:** Në raste të veçanta mund të lindë një situatë ku ekzekutimi *restituto in integrum* i një vendimi gjykate, që i deklaron aktet administrative të paligjshëm dhe të pavlefshme, mund të jetë i pamundur për shkak të pengesave të pakapërcyeshme faktike ose ligjore. Megjithatë, në këto situata dhe në pajtim me të drejtën e aksesit në gjykatë, një Shtet Anëtar, në mirëbesim dhe kryesisht, duhet të shqyrtojë zgjidhjet e tjera alternative që mund të korrigojnë efektet e paligjshme të akteve të veta, veçanërisht në dhënien e kompensimit. Qeveria nuk kishte demonstruar që ishin bërë të gjitha përpjekjet nga autoritetet për të korriguar situatën e kërkuar në dritën e vendimeve për anulimin e Demirbankës dhe shitjen e saj tek HSBC-ja. Në gjykime të veçanta, të cilat ishin edhe burimi i një kërkesë përkatëse në Gjykatë (shih Reisner kundër Turqisë, 46815/09, 21 korrik 2015), Gjykata e Lartë Administrative kishte vendosur në një vendim të datës 16 mars 2009 që ekzekutimi i vendimit të datës 5 nëntor 2004 mund të garantohej nëpërmjet kthimit të të drejtave mbikëqyrëse dhe ekzekutive tek aksionarët e Demirbankës, dhe nuk kishte kërkuar kthimin e aksioneve faktike që, në çdo rast do të ishte e pamundur. Mosveprimi absolut i autoriteteve në përgjigje të kërkesës për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Lartë Administrative u kishte hequr të drejtën e kërkuar për aksesin në gjykatë.

**Përfundim:** shkelje (gjashtë vota me një).

**Neni 1 i Protokollit nr 1:** Vendimi i Bordit për marrjen e Demirbankës ishte marrë qartësisht si një masë për të kontrolluar sektorin bankar në vend. Megjithatë ai përfshinte heqje pronësie, në këto rrethana heqja e pronësisë përbënte një element të skemës për kontrollin e industrisë bankare. Ishte paragrafi i dytë i Nenit 1 të Protokollit 1 që zbatohet (kontrolli i përdorimit të pasurisë). Marrja e Demirbankës nga Fondi dhe shitja pasuese tek Banka HSBC ishte anuluar në mënyrë të paligjshme nga gjykatat vendase. Ndërhyrja tek e drejta e kërkuar për të gëzuar sendet në posedim të tyre nuk mund të konsiderohej si e ligjshme në kuptimin e Nenit 1 të Protokollit nr 1.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: i rezervuar.

Të dëgjuarit e ligjshëm Mohimi i aksesit tek avokati i të pandehurit të zgjedhur vetë gjatë marrjes në pyetje nga policia, pa shkaqe përkatëse dhe të mjaftueshme: shkelje

**Dvorski kundër Kroacisë** - 25703/11 Vendimi 20.10.2015 (GC)

**Fakte** - Në vitin 2007, kërkuesi u arrestua në lidhje me një numër krimesh dhe u mor në pyetje si i dyshuar nga policia. Gjatë marrjes në pyetje kërkuesi i pranoi veprat penale për të cilat akuzohej dhe pranimet e tij u pranuan si provë në gjyq. Në vitin 2008, kërkuesi u dënua përfundimisht për një krim të rëndë, vjedhje me armë dhe zjarrvënien dhe u dënua me dyzet vjet burgim. Në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës Evropiane, kërkuesi u ankaua që pas arrestimit të tij, policia i kishte mohuar atij aksesin tek një avokat (G.M.) që prindërit i kishin zgjedhur për ta përfaqësuar atë, dhe ai ishte i detyruar të pranonte shërbimet e një avokati të zgjedhur nga policia (M.R.) dhe që ai ishte detyruar të penalizonte veten pa patur përfitimin e një avokati të zgjedhur prej tij. Në një vendim të datës 28 nëntor 2013, një Dhomë e Gjykatës, ndarë ndërmjet pesë me dy vota, vendosi që nuk ia patur shkelje të Nenit 6, par 1 dhe 3(c) të Konventës. Më 14 prill 2014, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të kërkuesit (shih Shënimin Informativ 173).

**Ligji** - *Neni 6, par 1 dhe 3(c)*: Ndryshe nga pozicioni i Salduz kundër Turqisë, ku kërkuesit i mohua aksesin tek një avokat gjatë marrjes në pyetje nga policia, në këtë rast ishte një situatë kur kërkuesit i ishte dhënë mundësia qysh nga marrja e tij e parë në pyetje, por sipas ankimit të tij - jo tek një avokat sipas zgjedhjes së tij. Ndryshe nga çështjet që kishin të bënin me mohimin e aksesit, ku kërkoheshin 'shkaqe detyruese' për marrjen në pyetje të një të dyshuari pa përfaqësim, kërkesa më e butë e shkaqeve 'përkatëse dhe të plota' aplikohet në situatat që ngrinin çështjen më pak të rëndë të 'mohimit të zgjedhjes'. Ndërsa autoritetet e brendshme duhej të merrnin parasysh dëshirat e të dyshuarit në lidhje me përfaqësimin e tiji ligjor, ato mund ti tejkalonin ato dëshira nëse kishte shkaqe përkatëse dhe të mjaftueshme për të konsideruar që kjo ishte e nevojshme në interes të drejtësisë. Nëse nuk ka shkaqe përkatëse dhe të mjaftueshme, një kufizim për zgjedhjen e lirë të avokatit mbrojtës do të përbente një shkelje të Nenit 6, par 1, në lidhje me par 3(c) nëse kjo ka ndikuar negativisht për zgjedhjen, duke patur parasysh të gjithë procedimin si një i tërë.

- (a) *Nëse kërkuesi është përfaqësuar nga një avokat i zgjedhjes së tij të informuar* - Gjykata e konsideroi të provuar që G.M. ishte përpjekur të shihte kërkuesin në rajonin e policisë para marrjes në pyetje por atij iu tha të largohej, ndërsa kërkuesi nuk u vu në dijeni për praninë e tij. Për pasojë, megjithëse kërkuesi kishte zgjedhur formalisht M.R. për ta përfaqësuar atë gjatë marrjes së tij në pyetje nga policia, zgjedhja e tij (penale) nuk ishte e informuar pasi ai nuk e dinte që prindërit e tij kishin angazhuar G.M.
- (b) *Nëse ka patur shkaqe përkatëse dhe të mjaftueshme për të kufizuar aksesin e kërkuesit tek avokati i zgjedhjes së tij* - I vetmi shkak që përmendet nga Qeveria për moslejimin e aksesit për G.M tek kërkuesi ishte që ai nuk e kishte prokurën e përshtatshme për ta përfaqësuar atë. Megjithatë, provat në dosjen e çështjes treguan që G.M kishte marrë prokurë me shkrim nga prindërit, siç lejohej nga ligji i brendshëm. Policia ishte nën detyrimin që të paktën të njoftonte kërkuesin as G.M ishte në rajonin e policisë, por këtë ata nuk e kishin bërë. Në këto rrethana, Gjykata nuk ishte e bindur që pazotësia e kërkuesit, si rezultat e sjelljes së policisë, për të caktuar G.M si përfaqësues të tij, mbështetej nga shkaqe përkatëse dhe të mjaftueshme.

(c) *Nëse ishte drejtësia e procedimit ishte e paragjykuar tërësisht* - Ndërsa, në këtë rast, pretendohet që caktimi ose zgjedhja e avokatit kishte ndikuar ose kishte për pasojë bërjen e një deklarimi penalizues nga personi i dyshuar qysh në fillim të hetimit penal, kërkohej shqyrtim i kujdesshëm i autoriteteve, që ishin gjykatat e brendshme. Megjithatë, arsyeimi i aplikuar nga gjykatat e brendshme në lidhje me kundërshtimin ligjor të bërë nga kërkuesi në lidhje me mënyrën në të cilën ishte marrë deklarimi i tij nga policia ishte larg nga të qenit i bazuar. Asnjë autoritet i brendshëm nuk kishte marrë masa për të përcaktuar rrethanat përkatëse që kishin të bënin me vizitën e G.M tek rajoni i policisë, në lidhje me marrjen në pyetje të kërkuesit nga policia. Veçanërisht, gjykatat e brendshme nuk kishin bërë asnjë përpjekje të vërtetë për të dhënë arsye në mbështetje ose si bazë për vendimin në kuptimin e vlerave të gjykimit të drejtë penal sipas parashikimit në Nenin 6 të Konventës. Kështu, Gjykata nuk ishte e bindur që kërkuesi kishte një mundësi të efektshme për të kundërshtuar rrethanat në të cilat ishte zgjedhur M.R për ta përfaqësuar atë. Në këtë rast, do të prezumohet që pasoja e sjelljes së policisë ishin që, në vend të rrinte në heshtje në intervistimi e parë nga policia sipas së drejtës që i takonte, kërkuesi kishte bërë një deklarim pranimit që më vonë u pranua si provë kundër tij. Më vonë ai e kishte kundërshtuar mënyrën se si ishte marrë deklarimi i tij nga policia. Megjithëse nuk kishte prova të tjera ndaj tij, ndikimi i mundshëm i konsiderueshëm i deklarimit të tij fillestar mbi zhvillimin e procedimit penal nuk mund të injorohet. Në këto rrethana, pasoja e sjelljes së policisë në parandalimin e aksesit për avokatin e zgjedhur tek kërkuesi kishte minuar drejtësinë e procedimit penal pasues i marrë në tërësi.

**Përfundim:** shkelje (gjashtëmbëdhjetë vota me një).

Neni 41: konstatimi i një shkeljeje përbënte kompensim të mjaftueshëm dhe të drejtë për çdo dëm jo-financiar.

Përdorimi si prova e “deklarimit të dorëzimit dhe pranimit” i marrë si rezultat i keqtrajtimit dhe pa akses tek avokati: shkelje

**Turbylev kundër Rusisë** - 4722/09 Vendimi 6.10.2015 (Seksioni I)

**Fakte** - Në vitin 2005, kërkuesi u arrestua për dyshimin e kryerjes së vjedhjes me dhunë. Gjatë ndalimit të polici, ai pranoi të kishte marrë pjesë në krim dhe nënshkroi një protokoll të “dorëzimit dhe pranimit” që ishte përpiluar nga policia. Gjatë marrjes në pyetje në praninë e një avokati në ditën pasuese, kërkuesi e tërhoqi deklarimin, duke shpjeguar që ai e kishte bërë atë si pasojë e keqtrajtimit nga policia. Në vitin 2005 u hap një hetim penal në keq-trajtimin e pretenduar. Procedimi pastaj u pushua dhe u rihap disa herë para se të pushohet në vitin 2007. Në të njëjtin vit, kërkuesi u fajësua dhe u dënua me gjashtë vjet burgim. Vendimi u la në fuqi në shkallën e apelit dhe Gjykata e Lartë përfundimisht rrëzoi kërkesën për rishikim.



**Ligji - Neni 6, par 1 dhe 3(c):** Në parashtrimet e tyre në gjykatë, Qeveria pranoi që kërkuesi i ishte nënshtruar një keqtrajtimi në duart e policisë në shkelle të Nenit 3 të Konventës dhe nuk e kishte kundërshtuar që deklarimi i tij pranues ishte marrë si rezultat i këtij keqtrajtimi. Megjithatë, jo kishte argumentuar që pranimi nuk ishte prova e vetme ku bazohej dënimi i kërkuesit dhe provat pasuese që ishin shtuar nga prokuroria në çdo rast do të kishin siguruar dënimin e tij. Sipas mendimit të Gjykatës, e drejta për të mos iu nënshtruar torturës ose trajtimit apo dënimit çnjerëzor dhe poshtëruës ishte një e drejtë absolute, që nuk lejoi asnjë përjashtim në asnjë rrethanë. Kështu, përdorimi i provave në procedimin penal që ishin marrë në shkelle të Nenit 3 e bënin gjykimin automatikisht të padrejtë, pavarësisht nga vlera provuese e deklarimeve të pranimit dhe pavarësisht nëse përdorimi i tyre ishte vendimtar në sigurimin e dënimit të personit të pandehur. Përveç kësaj, para dhënies së ‘një deklarimi dorëzimi dhe pranimi’, kërkuesi nuk u informua në lidhje me të drejtën për ndihmë ligjore. Mungesa e kërkesës, sipas ligjit të brendshëm, për akses tek një avokat për dhënien e deklarimit të dorëzimit dhe pranimit u përdor për të anashkaluar de fakto të drejtën si i pandehur për ndihmë ligjore dhe për të siguruar pranimin e deklarimit të tij, të marrë pa ndihmë ligjore, si provë për të provuar fajin e tij. Kjo kishte dëmtuar të drejtën e tij të mbrojtjes në mënyrë të pariparueshme. Edhe nëse prezumojmë që kërkuesi ishte i informuar në lidhje me të drejtën e tij për të mos e penalizuar veten para bërjes së deklarimit, nuk do të mund të thuhej që ai kishte hequr dorë në mënyrë të rregullt nga privilegji i tij ndaj vetë-penalizimit duke ditur konstatimin e Gjykatës që deklarimi ishte bërë si rezultat i keqtrajtimit nga policia. Pasi që përdorimi si provë i deklarimit të dorëzimit dhe pranimit nga gjykatat e brendshme i marrë si rezultat i shkeljes së Nenit 3 dhe në mungesë të aksesit tek një avokat e kishte bërë gjykimin e kërkuesit të padrejtë.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Gjykata konstatoi gjithashtu, unanimisht, një shkelje të nenit 3 në aspektet e tij lëndore dhe procedurale për sa i takon keqtrajtimit që kërkuesi pësoi gjatë ndalimit policor dhe për sa i takon hetimit të paefektshëm në ankimet përkatëse.

Neni 41: 20 000 Euro secili në lidhje me dëmin jo-financiar.

Mostrajtimi nga gjykatat e brendshme i shqetësimeve në lidhje me ‘shpikjen’ e provave: shkelje

**Sakit Zahidov kundër Azerbaxhanit** - 51164/07 Vendimi 12.11.2015 (Seksioni I)

**Fakte** - Kërkuesi u arrestua dhe u shoqërua në mjediset lokale policore ku u krye një kontroll dhe në një nga xhepat e tij u gjet drogë. Më vonë ai u dënua për zotërim të paligjshëm të drogës. Para gjykatave të brendshme kërkuesi pretendoi që droga i ishte futur atij në xhep nga punonjësit e policisë. Ankimet e tij në lidhje me rrethanat në të cilat u zhvillua kërkimi dhe pranueshmërinë e provave nuk u trajtuan nga gjykatat e brendshme.

**Ligji - Neni 6:** Dënimi i kërkuesit ishte bazuar kryesisht në provat fizike, që ishin substancat narkotike që u gjetën gjatë një kontrolli. Gjykata vuri re një numër shqetësimesh në lidhje me rrethanat në të cilat ishin marrë provat fizike. Së pari, kontrolli i kërkuesit nuk u zhvillua menjëherë pas arrestit të tij, por njëzet minuta më vonë, shumë larg vendit të arrestit. Koha që kaloi ndërmjet arrestit dhe kontrollit ngrinte shqetësime legjitime në lidhje me ‘shpikjen’ e mundshme të provave, pasi kërkuesi ishte tërësisht nën kontrollin e policisë gjatë asaj kohe. Nuk kishte asgjë që do të sugjeronte që kishte rrethana të veçantë që e bënin të pamundur kryerjen e kontrollit menjëherë pas arrestit. Së dyti, gjykatat e brendshme nuk e kishin shqyrtuar një kopje të regjistrimit në video të kontrollit dhe Qeveria nuk i kishte dhënë Gjykatës një kopje të regjistrimit kur iu kërkua specifikisht ta bënte këtë. Së treti, arresti i kërkuesit nuk u dokumentua menjëherë nga policia dhe kërkuesi nuk përfaqësohej me avokat gjatë arrestit ose kontrollit. Kështu në tërësi cilësia e provave fizike në të cilat bazohej vendimi i fajësisë së gjykatave ishte e diskutueshme pasi mënyra në të cilën ato ishin marrë hidhnin dyshim mbi përgjegjësinë e saj. Gjykata konstatoi më tej që gjykatat e brendshme nuk i kishin shqyrtuar rregullisht çështjet e autenticitetit të provave fizike dhe përdorimit të tyre ndaj kërkuesit. Veçanërisht, ato nuk kishin shqyrtuar pse kontrolli i tij nuk ishte zhvilluar menjëherë në vendin e arrestit dhe nëse ishte respektuar procedura e duhur. Këta dy faktorë - mënyra në të cilën ishte marrë provat fizike dhe mosshqyrtimi nga gjykatat e brendshme i argumenteve të kërkuesit në lidhje me autenticitetin e saj dhe përdorimi ndaj tij - e kishin bërë procedimin në tërësi të padrejtë.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: 9 000 Euro secili në lidhje me dëmin jo-financiar.

### Mungesa e ndihmës ligjore falas në çështjet administrative: shkelje

**Mikhaylova kundër Rusisë** - 46998/08 Vendimi 19.11.2015 (Seksioni I)

**Fakte** - Në vitin 2007, pas pjesëmarrjes në një demonstratë, kërkuesi u arrestua për shkak të mosbindjes së urdhrit të policisë për shpërndarje. Ndaj saj nisi procedimi administrativ dhe kërkesa e saj për ndihmë ligjore falas u refuzua. Ajo u fajësua për shkelje të Neneve 19.3 dhe 20.2 të Kodit të Kundërvajtjeve Administrative (KKA) dhe u dënua me gjobë. Në ankimet e saj pasuese, duke përfshirë Gjykatën Kushtetuese, kërkesa e saj për ndihmë ligjore falas u refuzua përsëri dhe dënimi u la në fuqi.

**Ligji** - Neni 6, par 1 dhe 3(c):

(a) *Zbatueshmëria* - Në lidhje me akuzat sipas Neneve 20.2 të KKA-së, Gjykata vuri re që disa garanci procedurale që gjendeshin në KKA ishin tregues të natyrës ‘penale’ të procedurës. Për më tepër, dënimi përkatës nuk ishte ai që u vendos, por dënimi që ajo në fakt riskonte ose që mund ti nënshtrohej, dhe që përcaktohej nëpërmjet një reference tek maksimumi i parashikuar për kundërvajtjen. Maksimumi ligjor në rastin

e kërkueses ishte një gjobë e barabartë me 28 Euro. Megjithatë, megjithëse gjoba nuk mund të konvertohej në një dënim me heqje lirie në rastin e mos-pagesës, ajo që kishte rëndësi ishte që ajo nuk synohej si kompensim financiar për dëmin por ishte e një natyre ndëshkuese dhe penguese. Përfundimisht, duke vënë re pranimin e Qeverisë që kërkuesja ishte 'arrestuar', Gjykata prezumoi që ajo i ishte nënstruar arrestit administrativ të parashikuar nga KKA-ja në lidhje me të dy akuzat ndaj saj, një masë që kishte një konotacion më të fortë penal se shoqërimi i individit në rajonin e policisë. Në lidhje me akuzat sipas nenit 19.3 të KKA-së, kjo dispozitë parashikonte një gjobë të barabartë me 29 Euro dhe/ose 15 ditë burgim si dënimet maksimale. Kjo u bë shkas për një prezumim të fuqishëm që akuzat ndaj kërkueses ishin 'penale' në natyrë, një prezumim që mund të prapësohet vetëm në raste të veçanta dhe vetëm nëse heqja e lirisë nuk do të mund të konsiderohej si "dukshëm dëmtuese" duke ditur natyrën, kohëzgjatjen dhe mënyrën e ekzekutimit. Megjithatë, në këtë çështje, Gjykata nuk dalloi ndonjë rrethanë të tillë të veçantë. Doli që të dyja shkeljet për të cilat kërkuesja ishte ndjekur penalisht sipas KKA-së mund të klasifikoheshin si 'penale' në kuptimin e Nenit 6 të Konventës.

(b) *Themeli*

(i) *Akuza sipas Nenit 19.3 të KKA-së* - Sipas ligjit të brendshëm ndalimi administrative zbatohet vetëm në 'rrethana përjashtimore'. Megjithatë, meqenëse kërkuesja nuk përfshihej në kategoritë e njerëzve që përjashtoheshin nga ky ndalim, ishte një sanksion i mundshëm. Sipas mendimit të Gjykatës, ashpërsia e dënimit ishte i mjaftueshëm për të nxjerrë përfundimin që kërkueses duhej ti jepej ndihmë ligjore falas meqenëse këtë e kërkonin 'interesat e drejtësisë', pavarësisht nëse ajo i kishte aftësitë për të paraqitur një mbrojtje të përshtatshme ligjore. Gjykata Kushtetuese Ruse kishte ardhur në përfundime të ngjashme. Përfundimi: shkelje (unanimisht).

(ii) *Akuza sipas Nenit 20.2 të KKA-së* - Megjithëse dënimi sipas ligjit për këtë kundërvajtje ishte relativisht e ulët (një gjobë deri në 28 Euro) dhe çështja kishte të bënte me një ngjarje të vetme, elementët ligjorë të së cilës ishin relativisht të drejtpërdrejtë, përcaktimi i akuzës megjithatë kërkonte që rregullat e zbatueshëm dhe veprimet e dënueshme të përcaktoheshin dhe vlerësoheshin në dritën e legjislacionit tjetër dhe, eventualisht, me referencë tek të drejtat e të pandehurit për lirinë e tubimit dhe / ose lirinë e shprehjes. Diskutohet që kjo detyrë kishte potencialin për të shfaqur një shkallë kompleksiteti pasi kërkuesja nuk kishte arsimim ose njohuri juridike dhe kështu nuk mund të prezumohej që për atë ishte një gjë e vogël. Me qëllim që të respektohet Neni 6 i Konventës, ishte e preferueshme që elementet përkatës faktikë dhe ligjorë (si testi i mjeteve dhe çështja e 'interesit të drejtësisë') të vlerësoheshin fillimisht në nivel të brendshëm kur vendosej çështja për ndihmën juridike, veçanërisht kur, si në këtë çështje, bëhet fjalë për një liri themelore ose lirinë e mbrojtur nga Konventë. Megjithatë, nuk është bërë asnjë vlerësim i tillë kë çështjen në fjalë.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: 1 500 EURO në lidhje me dëmin jo-financiar; pretendimi në lidhje me dëmin financiar rrëzohet.

### Gjykata e paanshme

Prania në juri e anëtarit që njihje viktimën dhe komentoi për karakterin e saj: shkelje

**Kristiansen kundër Norvegjisë** - 1176/10 Vendimi 17.12.2015 (Seksioni V)

**Fakte** - Në kërkesën e tij në Gjykatën Evropiane, kërkuesi u ankua sipas Nenit 6, par 1, të Konventës që në gjykimin penal në të cilin ai u dënua për përdhunim në tentativë, një prej anëtarëve të jurisë nuk ishte i paanshëm. Gjatë gjykimit, anëtari i jurisë në fjalë informoi gjyqtarin kryesues që aji e njihje më parë viktimën. Megjithëse vërejtje që ajo 'kishte krijuar një ide (bilde) për viktimën qysh disa vjet më parë kur ajo e kishte njohur atë si një person të qetë', Gjykata e Lartë konsideroi që kjo nuk mund ta ndikonte atë në vlerësimin e çështjes së fajit.

**Ligji** - *Neni 6, par1*: Gjykata mbështeti këndvështrimin e gjykatave të brendshme që kontakti i mëparshëm sporadik ndërmjet viktimës dhe anëtarit të jurisë, në vetvete, nuk e skualifikojnë anëtarin e jurisë, pasi ai nuk përfshinte njohuri personale dhe kishte ndodhur disa vjet më parë. Megjithëse rëndësia përkatëse e përshtimit të viktimës nga anëtari i jurisë si 'person i qetë' ishte bërë shkak për interpretime të ndryshme në nivelin e brendshëm, gjykata nuk e pa të arsyeshme të përcaktonte kuptimin e saj të saktë. Megjithatë, ajo vuri re që deklarimi ishte qartësisht jo-negativ dhe mund të transmetonte një portret pozitiv të viktimës, duke ndikuar kështu eventualisht në vlerësimin e anëtarit të jurisë dhe të anëtarëve të tjerë të jurisë në disavantazh të personit të pandehur. Mundësia përforcohej nga fakti që gjykimi i vlerësimit të anëtarit të jurisë ishte shprehur në një moment kur ai mund të perceptohej si një koment ose reagim ndaj provave gojore të dhëna nga viktimat dhe kërkuesi përkatësisht. Në këto rrethana, kërkuesi kishte shkak legjitim të shqetësohej që anëtari i jurisë mund të kishte ide të paracaktuara që kishin rëndësi për pafajësinë ose fajësinë e tij. Për më tepër, avokati i kërkuetit kishte kërkuar që anëtari i jurisë të skualifikohej për shkak të mungesës së paanshësisë, ndihmës-avokati i viktimës e kishte mbështetur kërkesën dhe prokurori publik kishte shprehur pëlqimin për këtë, megjithëse nuk mori qëndrim. Ndërsa asnjë nga këta objekte ose komente nuk ishte vendimtar, nëse merrin në tërësi ata japin një tregues të fortë për rëndësinë e paraqitjeve në këtë çështje. Megjithatë, megjithëse këta tregues që anëtari i jurisë mund të mos jetë i paanshëm, gjykatat e brendshme nuk e kishin larguar atë dhe as kishin kërkuar të riorientonin jurinë, për shembull duke ftuar anëtarët e jurisë të mbështeteshin në provat e dhëna në gjykatë dhe duke theksuar që ata nuk duhet të lejonin faktorë të tjerë të ndikonin në vendimin e tyre. Duke patur parasysh efektin kumulativ të këtyre rrethanave, ka patur shkaqe të justifikueshme për të dyshuar paanshësinë e gjykatës së faktit.

**Përfundim:** shkelje (unanimisht).

Pazotësia për të marrë në pyetje dëshmitarët që mungojnë, deponimet e të cilëve kanë peshë për dënimin e kërkuesit: *shkelje*

**Schtschaschwili kundër Gjermanisë** - 9154/10 Vendimi 15.12.2015 (GC)

**Fakte** - Kërkuesi ishte fajësuar për vjedhje të rëndë me dhunë në lidhje me shantazh të rëndë dhe ishte dënuar me nëntë vjet e gjysmë burgim. Në lidhje me një nga këto vepra penale, gjykata e faktit u mbështet veçanërisht në deklaratimet e dëshmitarëve të bërë nga dy viktimat e krimit në polici në fazën paragykimore. Deklarimet u lexuan në gjyq pasi të dy dëshmitarët ishin kthyer në Letoni dhe refuzuan të dëshmonin pasi ishin të traumatizuar nga krimi. Në një vendim të datës 17 prill 2014, një Dhomë e Gjykatës, ndarë ndërmjet pesë me dy vota, vendosi që nuk ka patur shkelje të Nenit 6, par 1 të Konventës të lexuar në lidhje me Nenin 6, par 3 (d) të Konventës. Më 8 shtator 2014, çështja u referua Dhomës së Madhe me kërkesë të kërkuesit (shih Shënimin Informativ 177).

**Ligji** - *Neni 6, par 1, në lidhje me Nenin 6, par 3(d)*: Me qëllim që të vlerësohet nëse drejtësia e përgjithshme në gjykimin e kërkuesit ishte ndikuar nga përdorimi i deklarimeve të bëra më parë nga dëshmitarët që nuk ishin të pranishëm në gjyq, Gjykata aplikoi dhe sqaroi më tej testin e përcaktuar në vendimin e Dhomës së Madhe tek Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar ((GC), 26766/05 dhe 22228/06, 15 dhjetor 2011, Shënimi informativ 147). Ndërsa ishte e qartë që secili prej të tre hapave të testit duhej të shqyrtohej, nëse çështjet në hapat një (nëse ka patur shkak të arsyeshëm për mospraninë e dëshmitarit) dhe dy (nëse provat e dëshmitarëve që mungojnë ishin bazë kryesore ose vendimtare për dënimin e të pandehurit) morën përgjigje pozitive, mbeti e pasaktë nëse të tre hapat e testit duhej të shqyrtoheshin në rastet në të cilat çështja në hapin e parë ose ajo e hapit të dytë do të merrnin përgjigje negative, si dhe në cilën renditje duhej të shqyrtoheshin hapat. Gjykata konsideroi që:

- (i) Mungesa e një shkakut të arsyeshëm për mospraninë e një dëshmitari, ndërsa kjo në vetvete mund të mos jetë përcaktuese në padrejtësinë e gjykimit, ishte sidoqoftë një faktor tepër i rëndësishëm që duhet të peshohet në balancë kur bëhet vlerësimi i drejtësisë së gjykimit, dhe e tillë që mund të kalojë balancën drejt konstatimit të një shkeljeje të nenit 6, par 1 dhe 3(d).
- (ii) Ekzistenca e faktorëve të mjaftueshëm kundërbalancues duhej të rishikohej jo vetëm në çështjet në të cilat dëshmia që jepet nga një dëshmitar që mungon ka rëndësi vendimtare për fajësimin, por edhe në ato raste kur ajo kishte një rëndësi të konsiderueshme dhe pranimi i saj mund të dëmtojë mbrojtjen. Masa e faktorëve kundërbalancues e nevojshme me qëllim që gjykimi të konsiderohet i drejtë varet nga pesha e provave të dëshmitarëve që mungojnë.
- (iii) Si rregull, do të ishte me vend të shqyrtoheshin të tre hapat e testit Al-Khawaja në renditjen e përcaktuar në atë vendim. Megjithatë, të tre hapat janë të ndërlidhur dhe, të marrë së bashku, shërbejnë për të përcaktuar nëse gjykimet penalë në fjalë kanë qenë të drejta në tërësi. Mund të jetë më vend në një rast të caktuar që hapat të

shqyrtohen në një rend të ndryshëm, veçanërisht nëse një prej hapave duket se është përcaktues në lidhje me drejtësinë ose padrejtësinë e procedimit.

Gjykata vazhdoi me aplikimin e testit Al-Khawaja për faktet e çështjes së kërkuarit:

- (a) *Nëse ka shkak të arsyeshëm për mospraninë e dëshmitarit në gjyq* - Gjykata vuri re qysh në fillim që gjykata e faktit kishte konsideruar që dëshmitari nuk e kishin bazuar në masë të mjaftueshme refuzimin e tyre për të dëshmuar dhe nuk e kishin pranuar gjendjen e tyre shëndetësore ose frikën si justifikim për mungesën në gjyq. Pas kontaktimit të dëshmitarëve individualisht dhe propozimit të zgjidhjeve të ndryshme, gjykata e faktit u kishte kërkuar në mënyrë të përsëritur gjykatave letoneze që të vizitohej gjendja shëndetësore dhe aftësia e dëshmitarëve nga një mjek publik ose ti detyronin ata të ishin të pranishëm në një seancë në Letoni. Meqenëse këto përpjekje nuk patën sukses, gjykata e faktit pranoi protokollet e marrjes në pyetje të dëshmitarëve në fazën e hetimit si provë në gjykim. Kështu, mungesa e dëshmitarëve nuk ishte për faj të gjykatës së faktit. Për pasojë ka patur shkak të arsyeshëm, nga këndvështrimi i gjykatës së faktit, për mospraninë e dëshmitarëve në gjyq dhe për ta pranuar deklarimet që ata kishin bërë në fazën paragykimore si prova.
- (b) *Nëse provat e dëshmitarëve që mungonin ishte e baza e vetme ose kryesore për dënimin e kërkuarit* - Gjykatat e brendshme nuk sqaruan qartë nëse ato i konsideronin deklarimet në fjalë të dëshmitarëve si prova 'vendimtare', d.m.th., sikur janë të një rëndësie të tillë që të jenë përcaktuese për përfundimin e çështjes. Pas vlerësimit të të gjitha provave që ishin para gjykatave të brendshme, Gjykata vuri re që të dy viktimat e krimit ishin të vetmit dëshmitarë okularë të veprës penale në fjalë. Prova e vetme tjetër e disponueshme ishte ajo nëpërmjet të treguarit ose teknike rrethore që nuk ishte konkludente. Në këto rrethana, provat e dëshmitarëve që mungonin ishte 'vendimtare', d.m.th., përcaktuese për dënimin e kërkuarit.
- (c) *Nëse ka patur faktorë kundërbalancues të mjaftueshëm për të kompensuar mangësinë në të cilën ka punuar mbrojtja* - Në arsyetimin e saj, gjykata e faktit e kishte bërë të qartë që ajo ishte në dijeni të vlerës provuese të ulur të deklarimeve të patestuara të dëshmitarëve. Ajo e kishte krahasuar përmbajtjen e deklarimeve të bëra nga viktimat në fazën e hetimit dhe kishte konstatuar që ato përmbanin përshkrime të hollësishme dhe koherente të rrethanave të veprës penale. Ajo kishte vëzhguar më tej që pazotësia e dëshmitarëve për të identifikuar kërkuarin tregonte që ata nuk kishin dëshmuar me synim penalizimin e tij. Për më tepër, në vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarëve, gjykata e faktit kishte trajtuar aspekte të ndryshme të sjelljes së tyre në lidhje me deklarimet e tyre. Gjykata e faktit kishte shqyrtuar kredibilitetin e dëshmitarëve dhe besueshmërinë e deklarimeve të tyre në një mënyrë të kujdesshme. Për më tepër, ajo kishte prova shtesë penalizuese nëpërmjet të treguarit ose rrethore në mbështetje të deklarimeve të dëshmitarëve. Përveç kësaj, gjatë gjykimit kërkuari kishte mundësi të jepte versionin e tij të ngjarjeve dhe të hidhte dyshim në kredibilitetin e dëshmitarëve duke marrë në pyetje të dyfishtë dëshmitarët që kishin dhënë prova nga sa kishin dëgjuar. Megjithatë, ai nuk e kishte mundësinë për të marrë në pyetje dy viktimat në mënyrë jo të drejtpërdrejtë ose në fazën e

hetimit. Në fakt, megjithëse autoritetet e ndjekjes penale mund të kishin caktuar një avokat për të ndjekur seancën e dëshmitarëve para gjyqtarit hetues, këto garanci procedurale nuk u përdorën në rastin e kërkuarit. Në këtë kontekst Gjykata ra dakord me kërkuarin që dëshmitarët u morën në pyetje nga gjyqtari hetues, pasi, duke patur parasysh kthimin e menjëhershëm të tyre në Letoni, autoritetet e prokurorisë ishin të mendimit që kishte rrezik për humbjen e provave. Në këtë kontekst dhe duke patur parasysh që sipas ligjit të brendshëm protokollet me shkrim të një intervistimi të mëparshëm të dëshmitarit nga një gjyqtar hetues mund të lexohen në gjyq në kushte më pak rigorozë se protokollimi i një intervistimi të një dëshmitari nga policia, autoritete kishin marrë riskun e parashikueshëm, që u materializua në vazhdim, që as i akuzuari dhe as avokati i tij nuk ishin në gjendje ti pyesnin ata asnjë fazë të procedimit. Duke patur parasysh rëndësinë e deklarimeve të të vetmëve dëshmitarë okularë të veprës penale për të cilën u dënua kërkuari, masat kundërbalancuese të marra nga gjykata e brendshme nuk ishin të mjaftueshme për të lejuar një vlerësim të drejtë dhe të duhur të besueshmërisë së provave të patestuara. Kështu, mungesa e mundësisë për kërkuarin të pyesë ose të porosisë pyetjen e dy dëshmitarëve në çdo fazë të procedimit e kishte bërë gjykimin të padrejtë në tërësinë e tij.

**Përfundim:** shkelje (nëntë vota me tetë).

## Neni 8

Respektimi i jetës private dhe familjare

Detyrimet pozitive Mosnjohja e partneriteteve të partneriteteve të të njëjtit seks: shkelje

**Oliari dhe të Tjerë kundër Italisë** - 18766/11 dhe 36030/11 Vendimi 21.7.2015 (Seksioni IV)

**Fakte** - Kërkuarit janë tre çifte që jetojnë në marrëdhënie të qëndrueshme të të njëjtit seks dhe nuk u lejuan të publikonin shpalljet e martesës pasi Kodi Civil italian parashikonte që bashkëshortët duhej të ishin të seksit të kundërt. Pas një ankimi nga çifti i parë, gjykata e apelit ia referoi çështjen Gjykatës Kushtetuese në lidhje me kushtetueshmërinë e legjislacionit. Në prill të vitit 2010, Gjykata Kushtetuese e deklaroi ankimin kushtetues të kërkuarëve të papranueshëm pas konstatimit që e drejta për martesë, e garantuar nga Kushtetuta italiane, nuk shtrihet mbi bashkimet homoseksuale dhe i referohej martesës në kuptimin e saj tradicional. Në të njëjtën kohë, Gjykata Kushtetuese u shpreh që i takonte Parlamentit të bënte rregullimin, në afatin dhe me mjetet dhe kufijtë e caktuar nga ligji, njohjen gjyqësore të të drejtave dhe detyrimeve që u takonin çifteve të njëjtit seks. Për pasojë ankimi u rrëzua.

**Ligji** - Neni 8: Gjykata në rastet e mëparshme ishte shprehur që marrëdhëniet e çifteve bashkëjetuese të të njëjtit seks që jetojnë në partneritet de fakto të qëndrueshëm përfshihej në konceptin e “jetës familjare” brenda kuptimit të Nenit 8. Ajo njohu

gjithashtu që çiftet e të njëjtit seks e kishin të nevojshme njohjen dhe mbrojtjen e marrëdhënies së tyre, si dhe Asambleja Parlamentare dhe Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës kishte nënvizuar më tej. Gjykata konsideroi që mbrojtja ligjore që ofrohet tashmë në Itali për çiftet e të njëjtit seks nuk parashikonte nevojat thelbësore që ishin relevante për një çift në një marrëdhënie të përkushtuar dhe të qëndrueshme. Ndërsa regjistrimi i bashkimeve të të njëjtit seks tek autoritetet ishte e mundur në 2% ë baskive, kjo kishte vetëm një vlerë simbolike dhe nuk jepte ndonjë të drejtë për çiftet e të njëjtit seks. Qysh nga dhjetori i vitit 2013, çiftet e të njëjtit seks kishin patur mundësinë të lidhnin 'marrëveshje bashkëjetese', që ishin tepër të kufizuara në objekt. Ato nuk parashikonin disa nevoja thelbësore që ishin themelore për rregullimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme brenda një çifti, si mbështetja materiale e ndërsjellë, detyrimi ushqimor dhe të drejtat e trashëgimisë. Për më tepër, këto marrëveshje ishin të hapura për çdo person që bashkëjeton, që do të thotë që ato nuk kishte si synim kryesor mbrojtjen e çifteve. Për më tepër, ato kërkonin që çiftet përkatëse të ishin duke bashkëjetuar, ndërsa Gjykata kishte pranuar tashmë që bashkëjetesa nuk ishte një parakusht për ekzistencën e një bashkimi të qëndrueshëm ndërmjet partnerëve duke ditur që shumë çifte - qofshin të martuar ose në një partneritet të regjistruar - kishin periudha në të cilat ato i mbanin marrëdhëniet në distancë, për shembull për arsye profesionale. Kështu ekzistonte një konflikt ndërmjet realiteteve sociale të kërkuesve që jetonin hapur si çifte dhe pazotësisë së tyre ligjore për të marrë njohjen zyrtare në marrëdhënies së tyre. Gjykata nuk e konsideroi tepër të rëndë për Italinë të parashikonte njohjen dhe mbrojtjen e bashkimeve të të njëjtit seks dhe konsideroi që një formë e bashkimit civil ose partneriteteve të regjistruara do ti lejonte ato që marrëdhënia e tyre të njihej ligjërisht që do të ishte një vlerë e brendshme për personat e përfshirë. Gjykata më tej vuri re një tendencë ndërmjet Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës drejt njohjes ligjore të çifteve të të njëjtit seks, ku 24 nga 47 Shtete Anëtare ishin në favor të kësaj njohjeje. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese italiane tregoi nevojën për legjislaçion për të njohur dhe mbrojtur marrëdhëniet e të njëjtit seks, por legjislatura italiane për një kohë të gjatë nuk e kishte marrë parasysh këtë duke minuar autoritetin e gjyqësorit dhe duke i lënë individët përkatës në një situatë të pasigurisë ligjore. Thirrje të tilla nga gjykatat italiane reflektonin ndjenjat e një shumice të popullatës italiane e cila, sipas sondazheve të fundit, mbështeste njohjen ligjore të çifteve homoseksuale. Qeveria italiane nuk e kishte mohuar nevojën për mbrojtje ligjore të këtyre çifteve dhe nuk kishte mundur të tregonte ndonjë interes komunitar që justifikon situatën e tashme. Duke ditur sa më sipër, Gjykata konstatoi që Italia nuk i kishte përmbushur detyrimet e saj për të siguruar që kërkuesit të kishin në dispozicion një kuadër specifik ligjor që parashikon njohjen dhe mbrojtjen e bashkimit të tyre. Të konstatonte ndryshe, do të thoshte që Gjykata të mos kishte vullnetin të vinte re kushtet në ndryshim në Itali dhe të mos donte të zbatonte Konventën në një mënyrë praktike dhe të efektshme.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: 5 000 EURO në lidhje me dëmin jo-financiar; pretendimi në lidhje me dëmin financiar rrëzohet.



## Respekti për jetën familjare

### Detyrimet pozitive

Përjashtimi i plotë dhe i menjëhershëm i kërkuesit nga jeta e fëmijës pasi u vërtetua që ai nuk ishte babai biologjik: *shkelje*

**Nazarenko kundër Ruisë** - 39438/13 Vendimi 16.7.2015 (Seksioni I)

**Fakte** - Gjatë martesës së tyre, kërkuesi dhe bashkëshortja e tij kishin një vajzë A. Çifti më vonë u divorcua dhe kërkuesi përfitoi kujdestarinë e përbashkët të fëmijës. Pas një kundërshtimi të atësisë së kërkuesit, u konstatua që ai nuk ishte babai biologjik i fëmijës. Si rezultat, dhe megjithëse autoritetet e brendshme e pranuan që ai e kishte rritur dhe ishte kujdesur për fëmijën gjatë një periudhe prej pesë vjetësh, ai i humbi të gjitha të drejtat prindërore në lidhje me fëmijën, duke përfshirë të drejtën e ruajtjes së kontaktit me të. Emri i tij u hoq nga certifikata e lindjes së fëmijës dhe mbiemri i fëmijës duhej të ndryshohej. Ligji i brendshëm nuk parashikonte ndonjë përjashtim që do ti kishte mundësuar kërkuesit, në mungesë të një lidhje je biologjike me fëmijën, ta mbante ndonjë formë marrëdhënieje me të.

**Ligji** - Neni 8: A. lindi gjatë martesës së kërkuesit dhe u regjistrua si e bija e tij. Duke mos patur dyshime në lidhje me atësinë e A., kërkuesi e rriti dhe u kujdes për të për më shumë se pesë vjet. Siç u konstatua nga një autoritet i kujdesit të fëmijës dhe provat psikologjike të ekspertit, ka patur një lidhje të ngushtë emocionale ndërmjet kërkuesit dhe A. Marrëdhënia e tyre përbënte jetë familjare në kuptimin e Nenit 8, par 1. Mungesa e lidhjeve biologjike me një fëmijë nuk mohonte ekzistencën e fetës familjare për qëllimet e asaj dispozite (shih, në lidhje me prindërit rritës, Kopf dhe Liberda kundër Austrisë, 1598/06, 17 janar 2012). Gjykata ishte e shqetësuar në lidhje me mungesën e fleksibilitetit të dispozitave ligjore ruse që rregullonin të drejtën e vizitës. Qeveria nuk kishte dhënë asnjë shkak pse duhej të ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike" të përpilohej një listë jo-fleksible e personave me të drejtë për të ruajtur marrëdhënie me një fëmijë dhe për të mos bërë asnjë përjashtim për të marrë parasysh larminë e situatave familjare dhe interesit më të lartë të fëmijës. Si rezultat, një person i cili, si kërkuesi, nuk ishte i afërm i fëmijës por ishte kujdesur për të për një periudhë të gjatë dhe kishte krijuar një lidhje të ngushtë personale me të nuk mund të kishte të drejtën e vizitës në asnjë rrethanë, pavarësisht nga interesat e lartë të fëmijës. Gjykata nuk ishte e bindur që interesat më të lartë të fëmijës në sferën e të drejtave të vizitës mund të përcaktoheshin me një prezumim të përgjithshëm ligjor. Një balancim i drejtë i të drejtave të të gjithë personave përfshinin dhe bënë të domosdoshëm një shqyrtim të rrethanave të veçanta të çështjes. Për pasojë, Neni 8 mund të interpretohej si caktim për Shtetet Anëtare të një detyrimi për të shqyrtuar rast pas rasti nëse ishte në interesin e lartë të fëmijës për të ruajtur kontakte me personin, qoftë me lidhje biologjike apo jo, i cili ishte kujdesur për të për një periudhë të konsiderueshme kohore. Duke i mohuar kërkuesit të drejtën për të ruajtur kontakte me A pa shqyrtuar fare çështjen nëse ky kontakt do të ishte në interesin e lartë të A-së, Rusia nuk e kishte përmbushur këtë detyrim. Një person i cili kishte rritur një fëmijë për një

kohë të caktuar si të tijin nuk duhet të përjashtohet tërësisht nga jeta e fëmijës pasi të dalë që ai nuk ka qenë babai biologjik i fëmijës, përveç kur ka shkaqe relevante në lidhje me interesat e lartë të fëmijës për një përjashtim të tillë. Në këtë rast nuk ishin paraqitur shkaqe të tilla. Nuk ishte sugjeruar asnjëherë që kontakti me kërkuesin do të ishte i dëmshëm për zhvillimin e e A-së. Përkundrazi, siç u përcaktua nga autoriteti i kujdesit të fëmijës dhe psikologët ekspertë, ka ekzistuar një lidhje e fortë e ndërsjellë ndërmjet kërkuesit dhe A-së, dhe kërkuesi ishte kujdesur shumë për fëmijën. Në tërësi, autoritetet nuk e kishin përmbushur detyrimin e tyre për ti dhënë mundësi ruajtjes së lidhjeve familjare ndërmjet kërkuesit dhe A-së. Përjashtimi i plotë dhe automatik i kërkuesit nga jeta e A-së pas përfundimit të atësisë së tij për shkak të mungesës së fleksibilitetit të dispozitave të brendshme ligjore - veçanërisht mohimin e të drejtave të kontaktit pa marrë si duhet në konsideratë interesat e lartë të A-së - kishte sjellë si rezultat mosrespektimin e jetës familjare të kërkuesit.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: Nuk u ngrit pretendim në lidhje me dëmin

### **Respektimi i jetës private dhe familjare**

Mosmarrja parasysh e mendimeve të fëmijës gjatë procedurës së zgjatur të kujdestarisë: shkelje

**M. dhe M. kundër Kroacisë** - 10161/13 Vendimi 3.9.2015 (Seksioni I)

**Fakte** - Në gjykimin sipas Konventës, një nënë (kërkuesja e dytë) dhe i bija e saj, lindur në vitin 2001 (kërkuesja e parë) u ankuan që autoritetet e brendshme nuk kishin ndërmarrë masa për të mbrojtur kërkuesen e parë nga keqtrajtimi fizik dhe psikologjik që ajo i ishte nënshtruar nga babai i saj. Babai kishte kujdestari për kërkuesen e parë qysh nga viti 2007, ndërsa ai dhe kërkuesja e dytë u divorcuan. Ndërsa ishte në kujdestarinë e tij, kërkuesja e parë thuhet se iu nënshtrua episodeve të shpeshta të abuzimit verbal dhe kërcënimeve të dhunës fizike nga babai. Kjo arriti kulmin në një incident të datës 1 shkurt 2011, kur ai e qëlloi atë me shpullë në fytyrë dhe e kapi për fyti duke e abuzuar atë verbalisht. Ditën pasuese kërkueset e raportuan çështjen në polici dhe i vunë ata në dijeni për incidente të mëparshme të abuzimit verbal dhe fizik. Pasi procedimi penal ndaj babait të saj, por ishte akoma në shkallë të parë në kohën e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Evropiane, për më shumë se katër vjet e gjysmë pas fillimit. Paralelisht, kërkuesja e dytë nisi çështjen civile ndaj babait duke i kërkuar kujdestarinë mbi kërkuesen e parë. Kërkesa e saj për kujdestari të përkohshme u rrëzua në vitin 2011 pasi gjykatat e brendshme konstatuan duke u mbështetur në mendimet e ekspertëve mjekësorë dhe punonjësve socialë që kërkuesja e parë nuk ishte nën kërcënimin e keqtrajtit të mëtejshëm në banesën e babait. Gjykimi i themelit për çështjen e kujdestarisë nuk kishin përfunduar akoma në datën e vendimit të Gjykatës Evropiane. Kërkuesja e parë, e cila kishte shprehur dëshirë të madhe për të

jetuar me nënën e saj dhe kishte filluar të përjetonte probleme në sjellje, duke përfshirë vetë-dëmtimin, vazhdoi të jetonte me babain kundër dëshirave të saj.

### **Ligji**

Neni 3: Duke patur parasysh moshën e re të kërkueses, veprimet e dhunshme që ajo mendohet të ketë pësuar në duart e babait të saj mund të konsideroheshin si trajtim poshtërues në kuptimin e nenit 3. Kërkuësit raportuan ngjarjen në datën 1 shkurt 2011 tek autoritetet e policisë ditën tjetër dhe dëmtimet e pretenduara të kërkueses së parë u dokumentuan nga mjeku. Kjo provë sipas mendimit të Gjykatës ishte e mjaftueshme për ta paraqitur ankimin e kërkueses tek autoritetet e brendshme dhe për pasojë të bëhet shkak për detyrimin procedural të Shtetit për të hetuar pretendimet e saj dhe detyrimin pozitiv të shtetit për të mbrojtur atë nga dhuna e mëtejshme.

(a) *Detyrime Procedurale* - Në lidhje me detyrimin për të hetuar, autoritetet e brendshme vendosën të ndiqnin penalisht vetëm atë që dukej më serioze në një seri aktesh dhune kundër kërkueses së parë dhe jo në akuzimin e babait të saj me një ose më shumë vepra penale që mund të mbulonin të gjithë keqtrajtimin e pretenduar që do t'u kishte dhënë mundësi autoriteteve për të trajtuar situatën në tërësinë e saj. Për më tepër, procedimi penal në ngarkim të babait të saj zgjati pothuaj katër vjet e gjysmë në momentin e vendimit të Gjykatës, me vonesa thelbësore që u visheshin autoriteteve të brendshme. Si rezultat, hetimi nuk kishte përmbushur kërkesat e fillimit të menjëhershëm dhe shpejtësisë së arsyeshme që përfshihet në konceptin e efektivitetit.

**Përfundim:** shkelje (pesë vota me dy).

(b) *Detyrimi për të mbrojtur* - Kërkuëset u ankuan më tej që pas incidentit të datës 1 shkurt 2011, autoritetet e brendshme e lanë kërkuësin në kujdestarinë e babait duke cenuar kështu detyrimin e tyre pozitiv për të parandaluar përsëritjen e dhunës në familje ndaj saj. Megjithatë, Gjykata konstatoi që gjatë periudhës në fjalë, autoritetet e brendshme kishin marrë hapa të arsyeshëm për të vlerësuar dhe peshuar riskun e keqtrajtimin të mëtejshëm. Duket që situata e kërkueses së parë ishte ndjekur nga afër nga autoritetet sociale nëpërmjet masave për mbrojtjen e fëmijëve, që ishin në fuqi ndërmjet shtatorit 2011 dhe marsit 2014. Për më tepër, si rekomandimi i qendrës lokale për mirëqenie sociale dhe mendimi i kombinuar i ekspertëve mjekësorë kishin konstatuar që kërkuësi i parë nuk ishte nën riskun e keqtrajtimin në banesën e babait. Vendimi i gjykatës në qershor 2011 për refuzimin e kujdestarisë së përkohshme nënës për të bijën e saj bazohej në rekomandimin përkatës të qendrës së mirëqenies sociale dhe prova të tjera dhe në faktin që procedimi penal ndaj babait nuk kishte përfunduar akoma. Ai ishte marrë pas shqyrtimit të kujdesshëm të të gjithë materialeve përkatëse.

**Përfundimi:** nuk ka shkelje (unanimisht).

Duke patur konstatimin e mësipërm sipas nenit 3 në lidhje me kërkuësin e parë, Gjykata ishte e mendimit që nuk ka patur shkelje të nenit 8 në lidhje me kërkuësen e dytë dhe detyrën e Shtetit për të mbrojtur të bijën e saj nga keqtrajtimi.

**Neni 8:** Gjykata ishte e mendimit që ankimet e kërkuesve që autoritetet e brendshme kishin injoruar dëshirën e kërkueses për të jetuar me nënën e saj dhe që ajo nuk ishte dëgjuar në gjykimin për kujdestarinë ngrinin çështje për sa i takon të drejtës së saj për jetën private dhe familjare të dalluara nga ato të analizuar në kontekstin e Nenit 3 dhe në këtë mënyrë kërkoni shqyrtim të veçantë. Vetë fakti që gjykimi për kujdestarinë deri tani ka zgjatur për më shumë se katër vjet dhe tre muaj ishte i mjaftueshëm për të nxjerrë përfundimin që Shteti i paditur nuk kishte përmbushur detyrimet e tij pozitive sipas Nenit 8 të Konventës. Përveç kësaj, kërkohet kujdes më i madh në këtë çështje pasi ajo kishte të bënte me një fëmijë të traumatizuar, i cili, nëse nuk ishte për ndonjë shkak tjetër përveç marrëdhënies konfliktuale të prindërve, kishte pësuar vuajtje mendore që kishte kulmuar në sjellje vetë-dëmtuese. Megjithatë, dukej që gjykatat e brendshme nuk e njohën seriozitetin dhe urgjencën e situatës dhe karakteri i zgjatur i gjykimit shërbeu vetëm për të përkeqësuar vuajtjen e kërkueses së parë. Gjykata ishte e shokuar veçanërisht nga fakti që pas katër vjet dhe tre muaj kërkuesja e parë nuk ishte dëgjuar akoma në gjykim dhe në këtë mënyrë nuk i ishte dhënë shansi për të shprehur mendimet e saj në lidhje me cilin prind donte të jetonte. Duke patur parasysh Nenin 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, në çdo procedim gjyqësor ose administrativ që prek të drejtat e fëmijës sipas nenit 8 të Konventës europiane, nuk mund të thuhet që familjarët që janë në gjendje të shprehin mendimet e tyre janë përfshirë në masë të mjaftueshme në procesin e vendim-marrjes nëse atyre nuk u jepet mundësia të dëgjojnë për të shprehur mendimet e tyre. Do të ishte e vështirë të argumentohej që, duke patur parasysh moshën dhe maturinë e kërkueses së parë, ajo nuk është në gjendje të formojë mendimet e saj dhe ti shprehë ato lirish. Në këtë rast, ekspertët mjekësorë kishin konstatuar së pari që të dy prindërit ishin në të njëjtën masë të (pa)aftë për tu kujdesur për kërkuesen e parë dhe, së dyti, që ajo donte të jetonte me nënën e saj. Të dy prindërit jetonin në të njëjtin qytet dhe anulimi i urdhrit të kujdestarisë nuk do të do ta bënte atë të ndërronte shkollë ose ta largohej nga mjedisi social i zakonshëm i saj. Për pasojë, mosrespektimi i dëshirave të kërkueses së parë në lidhje me cilin prind do të jetonte, në rrethanat specifike të çështjes, shkelte të drejtat e saj për jetë private dhe familjare. Përveç kësaj, karakteri i zgjatur i gjykimit të kujdestarisë kishte shkelur të drejtat e kërkueses së dytë të parashikuara në Nenin 8.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: 19 500 Euro për kërkuesen e parë dhe 2 500 Euro për kërkuesen e dytë në lidhje me dëmin jo-financiar.

Sekustrimi në masë të gjerë i dosjeve në zyrën e avokatëve: nuk ka shkelje

**Sérvulo & Associados - Sociedade de Advogados, RL, dhe të tjerë kundër Portugalisë -** 27013/10 Vendimi 3.9.2015 (Seksioni I)

Në vitin 2006, filloi procedimi ndaj disa shtetasve portugezë dhe gjermanë për akuzat e korrupsionit, përfutimit të interesave të ndaluara dhe pastrim parash në lidhje me blerjen nga Qeveria portugeze të dy nëndetëseve nga një konsorcium gjerman. Procedimi solli dy

hetime penale, i pari për blerjen faktike të nëndetëseve dhe i dyti për pagesat që pretendohen se janë bërë nga konsorciumi gjerman për shoqëri të caktuara portugeze. Punonjësit e shtetit akuzoheshin për përfitim të avantazheve financiare në vazhden e këtyre negociatave në dëm të shtetit. Të dy hetimet u zhvilluan nën mbikëqyrjen e gjyqarit hetues, i cili në atë kohë, ishte i vetmi gjyqtar në Gjykatën Qendrore të Hetimit Penal. Në shtator 2009, gjyqtari hetues nxori dy urdhër kontrolli në lidhje me mjediset e punës së firmës kërkuese. Ai deklaroi që operacionet e kontrollit duhet të mbikëqreshin nga gjyqtari hetimor. Për shkak të një angazhimi tjetër, ai kërkoi të zëvendësohej në ditën e operacioneve nga dy gjyqtarë hetues të Gjykatës së Hetimit Penal të Lisbonës. Urdhrat e kontrollit autorizonin aksesin tek zyrat e firmës kërkuese që ishte angazhuar ose ishte përdorur nga avokatët e përfshirë në negociata në lidhje me blerjen e nëndetëseve dhe pagesat, dhe urdhëroi:

- sekuestrimin e çdo dokumenti, objekti ose prove tjetër, veçanërisht në format elektronik, në lidhje me krimet nën hetim;
- heqja dorë nga kërkesa për ruajtjen e konfidencialitetit të korrespondencës, duke u shprehur që aksesit në dosjet e kompjuterit duhet të bazohet në tridhjetë e pesë fjalë kyçe;
- kopjimin e dosjeve të mbuluara nga privilegji profesional në formë digjitale të pavarur për t'iu paraqitur gjyqarit hetues.

Së fundmi, gjyqtari hetues kërkoi që një përfaqësues i Shoqatë së Avokatisë të ishte i pranishëm gjatë operacioneve. Meqenëse kërkuesit bënë një kundërshtim ndaj operacionit të kërkimit, dokumentet që ishin sekuestruar u vulosën, pa u inspektuar, dhe iu dërguan Kryetarit të Gjykatës së Apelit. Në tetor 2009, Zëvendëskryetari i gjykatës së Apelit vendosi që sekuestrimi i dokumenteve dhe dosjeve kompjuterike kishin qenë proporcionale me qëllimin e ndjekur, që ishte administrimi i drejtësisë në çështje tepër komplekse, dhe nuk ka patur shkelje të parimit kushtetues të respektimit të privatësisë. Ai urdhëroi që dokumentet të vuloseshin dhe të dërgoheshin në Gjykatën Qendrore të Hetimit Penal. Në vitin 2011, procedimi u nda në dy hetime të veçanta. Të gjitha dokumentet e sekuestruara u kthyen, me përjashtim të dy hard-disqeve që iu kthyen firmës kërkuese me përfundimin e hetimit të dytë. Kompletet i parë i procedimit u ndërpre, ndërsa kompletet i dytë u dha pafajësi të gjithëve. Në gjykimin në Strasburg, kërkuesit u ankuan në lidhje me kërkimin e kryer në sistemin kompjuterik dhe sekuestrimin e dosjeve kompjuterikeve dhe e-mail-eve.

**Ligji** - Neni 8: Operacionet e kontrollit dhe sekuestrimit në fjalë përbënin ndërhyrje në të drejtën e kërkuesve për respektimin e korrespondencës së tyre. Ndërhyrja ishte në pajtim me ligjin dhe ndiqte një qëllim legjitim të parandalimit të krimit. Nëse ai ishte i nevojshëm në një shoqëri demokratike, duhet të merren parasysh disa pika:

- (a) *Nëse shkaqet ishin relevante dhe të mjaftueshme* - Duke patur parasysh hetimet dhe gjykimin në vazhdim, urdhrat e kontrollit ishin bazuar në shkaqe të arsyeshme dyshimi.

(b) *Përmbajtja dhe objekti i urdhrave të kontrollit dhe sekuestrimit* - Kontrollat e kryera në sistemin kompjuterik të firmës bazohej në tridhjetë e pesë fjalë kyçe që kishin të bënin me hetimin. Këto përfshinin disa fjalë të përdorimit të përgjithshëm, si “pagesa”, “financimi”, dhe fjalë që përdoren normalisht në një firmë avokatësh të specializuar në ligjin financiar, si “këmbim” dhe “shtrirje”. Për pasojë, në shikim të parë, objekti i urdhrave të kontrollit dhe sekuestrimit dukeshin të gjera. Pas rishikimit nga gjyqtari hetues i Gjykatës Qendrore të Hetimit Penal, pas të cilit ishin fshirë 850 dosje, 89000 dosje kompjuterike dhe 29 000 e-maile ishin sekuestruar dhe analizuar.

(c) *Nëse garancitë ndaj abuzimit ishin të përshtatshme dhe efektive* - Në pajtim me statutet e Shoqatës së Avokatëve, dokumentet e mbuluara nga privilegji profesional ligjor nuk mund të sekuestrohenin, përveç kur avokati në fjalë është nën një hetim formal. Kodi i Procedurës Penal dhe statutet e Shoqatës së Avokatëve parashikonin gjithashtu një numër garancish procedurale në lidhje me operacionet e kërkimit dhe sekuestrimit në firmat ligjore. Në këtë rast, një avokat i cili kishte punuar më parë për firmën kërkuese ishte vendosur nën hetim formal për abuzim me detyrën në kontekstin e hetimit penal në zhvillim e sipër. Në lidhje me zhvillimi e operacioneve, Gjykata vuri re që:

- disa prej kërkuesve ishin të pranishëm gjatë operacioneve;
- një përfaqësues i Shoqatës së Avokatëve ishte gjithashtu i pranishëm;
- një gjyqtar hetimor kishte mbikëqyrur operacionet;
- kërkuesit kishin bërë menjëherë një ankim tek Kryetari i Gjykatës së Apelit, me rezultatin që dokumentet e sekuestruar u vulosën, dhe gjyqtari hetimor nuk i këqyri ato para se ti dërgoheshin Kryetarit të Gjyqtarit të Apelit dhe para se ky i fundit të merrte vendimin e tij;
- një protokoll i operacioneve ishte përpiluar duke treguar artikujt që ishin sekuestruar;
- Zëvendëskryetari i Gjykatës së Apelit shqyrtoi kërkesën e kërkuesve dhe konstatoi që nuk kishte shkelje flagrante të privilegjit profesional ligjor në këtë çështje;
- gjyqtari hetues i Gjykatës Qendrore të Hetimit Penal kishte rishikuar artikujt e sekuestruar dhe urdhëroi asgjësimin e rreth 850 dosjeve me shkak se ato përmbanin informacione që ishte personal, i mbuluar nga privilegji profesional ose kishte të bënte me persona të ndryshëm nga ata nën hetim.

Në lidhje me gjyqtarin hetues të Gjykatës Qendrore të Hetimit penal, nuk kishte shkak për të vënë në pikëpyetje vlerësimin e tij. Ishte e vërtetë që në atë moment ai ishte vetëm gjyqtari hetues i ngarkuar me çështjet me komplekse në Portugal. Megjithatë, ai kishte ndërhyrë në këtë çështje në cilësinë e tij si gjyqtar hetues për të rishikuar ligjshmërinë e operacioneve të kontrollit dhe sekuestrimit dhe veçanërisht për të mbrojtur privilegjin profesional ligjor. Për më tepër, ai nuk kishte kompetencën për të filluar hetim. Pretendimet ndaj tij nuk ishin të bazuara plotësisht për të hedhur dyshim për rishikimin që ai ka kryer. Për më tepër, shqyrtimi nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Apelit përbënte një garanci tjetër përveç rishikimit nga gjyqtari hetues dhe vendimi i tij kishte shkaqe të mjaftueshme për këtë pikë. Për pasojë, ankesa drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Apelit,

përveç rishikimit nga gjyqtari hetues, kishte përbërë një mjet të përshtatshëm dhe të efektshëm, të tillë që kompenson objektin e urdhrave të kontrollit. Në lidhje me faktin që dosjet e kompjuterit dhe e-mailit nuk ishin kthyer, dhe përdorimi i tyre, legjislacioni nuk kërkon që ato të kthehen menjëherë. Sipas ligjit të brendshëm, dosja në lidhje me një çështje penale në të cilën hetimi ndërpritet mund të mbahet për periudhën e parashikimit për krimet në fjalë. Pas hapjes së një hetimit të dytë dhe të veçantë, gjyqtari i Gjykatës Qendrore të hetimit Penal autorizoi kopjimin e dosjeve të hetimit penal dhe shumë shtojcave për përfshirje në dosjen e re penale. Qëllimi i përdorimit të provave ishte vazhdimi i kërkimit për informacion në lidhje me dyshimet e mbetura dhe ngjarjeve, ku vazhdimi i hetimit të mos ndikojë negativisht tek personat që ishin objekt i hetimit të parë. Shkaqet e dhëna ishin legjitime. Në këtë çështje, kopjet e kërkuara kishin të bënin me një hetim të lidhur ngushtë me hetimin që shkaktoi operacionin e sekuestrimit. Për pasojë, pavarësisht objektit të urdhrave të kontrollit dhe sekuestrimit, garancitë e ofruara kërkesve ndaj abuzimit, arbitraritetit dhe shkeljeve të privilegjit ligjor profesional dhe veçanërisht rishikimi i kryer nga gjyqtari hetimor kombinuar me ndërhyrjen e Kryetarit të Gjyqtarit të Apelit, ishin të përshtatshme dhe të mjaftueshme. Kontrolli dhe sekuestrimi i dosjeve kompjuterike dhe e-maileve për të cilat u bë ankimi në këtë çështje nuk kishin sjellë për pasojë një ndërhyrje joproporcionale për qëllimin legjitim që ndiqej.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (gjashtë vota me një).

## Deportim

Largim i propozuar për një person të sëmurë mendërisht që kishte jetuar dhe punuar në vendin pritës për më shumë se njëzet vjet: çështja iu referua Dhomës së Madhe

### ***Khan kundër Gjermanisë*** - 38030/12 Vendimi 23.4.2015 (Seksioni V)

Në vitin 2005, kërkuesja, e cila kishte arritur në Gjermani nga Pakistani 14 vjet më parë, bëri vrasje në një gjendje të psikozës akute. Ajo u diagnostikua me skizofreni dhe u sistemua në një spital psikiatrik. Në vitin 2009, u urdhërua deportimi i saj pasi ajo u konstatua se përbënte rrezik për sigurinë publike. Në gjykimin sipas konventës, kërkuesi u ankua që deportimi i saj do të ndërhynte tek e drejta e saj e respektimit të jetës familjare me të birin e saj dhe që nuk ishin marrë parasysh në masë të mjaftueshme rrethana specifike. Në një vendim të datës 23 prill 2015, një Dhomë e Gjykatës konstatoi, bazuar në gjashtë vota me një, që deportimi i kërkueses nuk do të përbënte një shkelje të nenit 8 të Konventës (shih Shënimin Informativ 184). Veçanërisht, Gjykata nuk konstatoi që autoritetet gjermane e kishin tejkaluar marzhin e vlerësimit kur peshuan ndikimin mbi jetën private të kërkueses kundrejt rrezikut që ajo kishte për sigurinë publike. Më 14 shtator 2015, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të kërkuesit.

Urdhri i vendosjes së birësimit duke prerë kontaktet e fëmijëve me nënën e tyre dhe në kundërshtim me përfundimet e ekspertit të caktuar nga gjykata: *shkelje*

**S.H. kundër Italisë** - 52557/14 Vendimi 13.10.2015 (Seksioni IV)

**Fakte** - Kërkuësja, nëna e tre fëmijëve, vuante nga depresionin. Në gusht të vitit 2009, shërbime sociale informuan Gjykatën për të Miturit që, në një numër rastesh, fëmijët ishin shtruar në spital pas marrjes aksidentale të ilaçeve. Në gjykatën ku nisi menjëherë gjykimi, urdhëroi sistemimin e tyre në një institucion. Prindërit pranuan që për shkak të depresionit të kërkuëses, ata ishin vështirësi, por thanë që ata mund të kujdeseshin për fëmijët me ndihmën e shërbimeve sociale. Shërbimet sociale propozuan një plan mbështetjeje për familjen dhe fëmijët u kthyen tek prindërit e tyre në janar 2010. Babai u largua nga banesa familjare dhe kërkuësja u shtrua në spital pasi shëndeti i saj u përkeqësua. Në dritën e këtyre zhvillimeve, gjykata urdhëroi vendosjen e fëmijëve në një institucion dhe u dha prindërve të drejtën e aksesit. Në mars 2010, në gjykatë nisi një procedurë me synim birësimin e fëmijëve. Kërkuësja e kundërshtoi këtë, duke insistuar që në fakt nuk ekzistonte një situatë braktisjeje. Ekspertët e emëruar nga gjykata për të vlerësuar situatën e familjes dhe aftësinë e prindërve për të përbushur rolin e tyre konsideruan një sërë masash mbështetëse për u mundësuar fëmijëve kthimin në familje, me një vlerësim të ri të aftësive të prindërve pas gjashtë muajsh. Raporti i ekspertëve u depozitua në regjistrin e gjykatës në janar 2011. Në mars të vitit 2011, gjykata deklaroi fëmijët të birësueshëm, megjithë indiciet e ekspertëve dhe pa lënë mundësi për masa mbështetëse që ato të merreshin dhe të jepnin rezultat. Ai vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Kasacionit. Në shkurt 2014, kërkuësja u ankua ndaj vendimit të birësueshmërisë tek Gjykata e të Miturve. Në mbështetje të kërkesës së saj, ajo paraqiti dokumentacion mjekësor që vërtetonte që shëndeti i saj ishte përmirësuar, duke tentuar të provonte që kushtet që mbështesnin deklarimin e birësueshmërisë nuk përbusheshin.

**Ligji** - Neni 8: Ndryshe nga çështjet e tjera që Gjykata kishte patur për shqyrtim, fëmijët në këtë çështje nuk ishin ekspozuar karshi situatave të dhunës ose keqtrajtimit fizik ose psikologjik\* ose abuzimit seksual. Procedura për deklarimin e fëmijëve të birësueshëm ishte hapur për llogari të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore të kërkuëses, që ishte pasuar me shtrimin e saj në spital dhe rënien e gjendjes familjare pas ndarjes së prindërve. Gjykata nuk kishte dyshim që, në këto rrethana, ishte e nevojshme një ndërhyrje e autoriteteve kompetente për të mbrojtur interesin e fëmijës. Ajo kishte disa dyshime në lidhje me përshtatshmërinë e ndërhyrjes së vendosur dhe mendoj që autoritetet nuk kishin bërë përpjekje të mjaftueshme për të mbrojtur marrëdhënien nënë-fëmijë. Kishte edhe zgjidhje të tjera praktike, si ato që parashikoheshin nga ekspertët dhe veçanërisht prezantimi i asistencës social specifike për mundësuar kalimin e vështirësive në lidhje me shëndetin e kërkuëses, duke ruajtur kështu marrëdhënien familjare dhe duke mbrojtur interesat e larta të fëmijës. Në një numër çështjesh, kërkuësja kishte kërkuar ndërhyrjen e shërbimeve sociale për të marrë mbështetje për tu kujdesur për fëmijët. Kërkesat e saj nuk reflektoni mungesë kapaciteti për të ushtruar



rolin e saj si prind dhe nuk justifikonin vendimin gjykatës për të deklaruar fëmijët të birësueshëm. Një përgjigje nga autoritetet ndaj kërkesave të kërkuases për ndihmë mund të kishte mbrojtur interesin e fëmijës dhe lidhjen me nënën. Do të ishte gjithashtu në pajtim me rekomandimet e raporteve të ekspertëve dhe dispozitave të ligjit, ndërsa një ndarje e përhershme e lidhjes familjare duhet të mbetet mjeti i fundit. Megjithëse ka zgjidhje më pak radikale, gjykatat e brendshme i kishin deklaruar fëmijët të birësueshëm, megjithë rekomandimin e ekspertëve duke sjellë largimin përfundimtar dhe të pakthyeshëm të nënës së tyre. Përveç kësaj, të tre fëmijët ishin vendosur në tre familje të ndryshme, duke bërë jo vetëm të ndaheshin nga familja por edhe ndërmjet tyre. Domosdoshmëria e ruajtjes sa më shumë të jetë e mundur lidhjen ndërmjet kërkuases, e cila ishte tepër e rëndësishme, - e cila ishte në një situatë vulnerabiliteti - dhe bijve të saj nuk ishte marrë parasysh si duhet. Autoritetet gjyqësore shqyrtuan vetëm vështirësitë familjare, të cilat mund të ishin kaluar me asistencën specifike sociale, siç tregohet në raportin e ekspertëve. Ndërsa ishte e vërtetë që një raport fillestar për masat mbështetëse kishte dalë në vitin 2009 dhe nuk kishte marrë parasysh sëmundjen e kërkuases dhe ndarjen e saj nga bashkëshorti, këto rrethana nuk mjaftonin të justifikonin largimin e çdo mundësie për kërkuesen të rivendosë marrëdhënien me fëmijët e saj. Duke patur parasysh këto konsiderata dhe megjithë marzhin e vlerësimit të Shtetit në këto çështje, autoritetet italiane, duke parashikuar vetëm ndarjen përfundimtare dhe të pakthyeshme të marrëdhënies familjare, ku do të ishin praktike zgjidhje të tjera për të garantuar interesat e fëmijës dhe lidhjen familjare, nuk kishin bërë përpjekje të përshtatshme dhe të duhura në lidhje me të drejtën e kërkuases për të jetuar me fëmijët e saj, duke shpërfillur kështu të drejtën e saj për të respektuar jetën e saj, sipas garantimit nga Neni 8 i Konventës.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: 32 000 Euro për dëmin jo-financiar.

\* (Shih, për shembull, Y.C. Kundër Mbretërisë së Bashkuar, 4547/10, 13 mars 2012, Shënim Informativ 150).

Mangësi në kuadrin ligjor që rregullon përgjimin e fshehtë të komunikimeve me telefona celularë: shkelje

**Roman Zakharov kundër Rusisë** - 47143/06 Vendimi 4.12.2015 (GC)

**Fakte** – Kërkuesi, i cili ishte kryeredaktor i një shoqërie publikimesh nisi çështje gjyqësore kundër tre operatorëve të rrjetit celular, duke u ankuar për ndërhyrje në të drejtën e tij të privatësisë së komunikimeve të tij telefonike. Ai pretendoi që në pajtim me ligjin përkatës të brendshëm, operatorët e rrjetit celular kishin instaluar pajisje që lejonin Shërbimin Federal të Sigurisë (SFS) të përgjonin të gjitha komunikimet telefonike pa autorizim

paraprak. Ai kërkoi një masë të përkohshme duke urdhëruar heqjen e pajisjes dhe garantimin e aksesit në telekomunikim tu jepej vetëm personave të autorizuar. Gjykata e brendshme refuzuan pretendimin e kërkuesit, duke konstatuar që ai nuk kishte vërtetuar që bisedat e tij telefonike ishin përgjuar dhe që operatorët celularë kishin transmetuar informacion të mbrojtur tek personat e paautorizuar. Instalimi i pajisjes që ai i referohej nuk e cenonte vetë privatësinë e komunikimeve të tij. Në gjykimin në bazë të Konventës, kërkuesi u ankuar që sistemi i përgjimit të fshehtë të komunikimeve telefonike në rusi nuk përputheshin me kërkesat e Neni 8 të Konventës. Më 11 mars 2014, një Dhomë e gjykatës ia kaloi juridiksionit Dhomës së Madhe.

### **Ligji – Neni 8**

(a) *Statusi i viktimës* – Qëndrimi i gjykatës në çështjen Kennedy kundër Mbretërisë së Bashkuar ishte më i përshtatshëm për nevojën e garantimit që fshehtësia e masave të përgjimit të mos rezultojë në masa që efektisht janë të pakundërshtueshme dhe jashtë mbikëqyrjes së autoriteteve të brendshme gjyqësore dhe Gjykatës. Po ashtu, një kërkues mund të pretendojë të jetë viktima e një shkeljeje të shkaktuar nga thjesht ekzistenca e masave përgjuese të fshehta ose legjislacioni që lejon këto masa, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

(i) *Objekti i legjislacionit* – Gjykata do të marrë parasysh objektin e legjislacionit që lejon masat e përgjimit të fshehtë duke shqyrtuar nëse kërkuesi mund të ndikohet eventualisht prej tij, qoftë për shkak se ai ose ajo i përket një grupi personash që synohet nga legjislacioni i kundërshtuar ose për shkak se legjislacioni prek drejtpërdrejt të gjithë përdoruesit e shërbimeve të komunikimit duke filluar një sistem ku çdo personi mund ti përgjohet komunikimi i tij.

(ii) *Disponibiliteti i mjeteve të mbrojtjes në nivel të brendshëm* – Gjykata do të marrë parasysh disponibilitetin e mjeteve në nivel të brendshëm dhe do të përshtatë shkallën e shqyrtimit në varësi të efektivitetit të këtyre mjeteve. Nëse sistemi i brendshëm nuk ofron një mjet të efektshëm mbrojtjeje, dyshimi dhe shqetësimi i përhapur në publikun e gjerë që kompetencat e përgjimit të fshehtë po abuzohen nuk mund të konsiderohet i pajustificuar. Në këto rrethana, rreziku i përgjimit mund të pretendohet që ai kufizon komunikimin e lirë nëpërmjet shërbimeve postare dhe të telekomunikimeve, duke përbërë për të gjithë përdoruesit ose përdoruesit potencialë një ndërhyrje e drejtpërdrejtë në të drejtën e garantuar nga Neni 8. Kështu, ka një nevojë më të madhe për shqyrtim nga Gjykata dhe justifikohet përjashtimi nga rregulli që u mohon individëve të drejtën për të kundërshtuar një ligj *in abstracto*. Në këto raste, individit nuk duhet të demonstrojë ekzistencën e një risku që masat e përgjimit të fshehtë janë zbatuar për të. Nga ana tjetër, nëse sistemi i brendshëm parashikon mjete të efektshme, është më e vështirë të justifikohet një dyshim i gjerë për abuzim. Në këto raste, individit mund të pretendojë se është viktimë e një shkeljeje të shkaktuar nga thjesht ekzistenca e masave të fshehta ose e legjislacionit që lejon masat e fshehta, vetëm nëse ai është në gjendje të tregojë që, për shkak të situatës së tij personale, ai është potencialisht i rrezikuar tu nënshtrohet këtyre masave. Në këtë rast, legjislacioni i kundërshtuar ka ndikuar drejtpërdrejt të gjithë përdoruesit e

shërbimeve të telefonisë celulare, meqenëse ai ka vendosur një sistem mbikëqyrjeje të fshehtë nën të cilin çdo personi që përdor shërbimet e telefonisë celulare të ofruesve vendorë mund të përgjohet komunikimet në telefoninë celulare, edhe pa u njoftuar asnjëherë për përgjimin. Për më tepër, ligji i brendshëm nuk parashikon mjete mbrojtje të efektshme për personat që dyshojnë se i janë nënshkruar përgjimit të fshehtë. Një shqyrtim i legjislacionit përkatës *in abstracto* është i justifikuar. Kërkuesit nuk i duhej të demonstronte që për shkak të situatës së tij personale ai kishte qenë në rrezik të nënshtrimit ndaj masës së përgjimit të fshehtë. Në këtë mënyrë ai kishte të drejtë të pretendonte të ishte viktimë e shkeljes së Konventës.

**Përfundim:** kundërshtimi paraprak rrëzohet (unanimisht).

(b) *Themeli* – Thjesht ekzistenca e legjislacionit të kundërshtuar sillte si rezultat një ndërhyrje në ushtrimin e së drejtave të kërkuesit sipas nenit 8. Përgjimi i komunikimeve në telefoninë celulare kishte bazë në ligjin e brendshëm dhe ndiqte qëllimin e ligjshëm të mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe sigurisë publike, parandalimit të kimit dhe mbrojtjes së mirëqenies ekonomike të vendit. Mbetej të konfirmohet nëse ligji i brendshëm ishte i aksesueshëm dhe përmbante garanci të përshtatshme dhe efektive dhe garantonte përmbushjen e kërkesave të “parashikueshmërisë” dhe “domosdoshmërisë në një shoqëri demokratike”. (i) *Aksesibiliteti* – Ishte e përbashkët që pothuaj të gjitha dispozitat ligjore të brendshme që rregullonin përgjimin e fshehtë ishin publikuar zyrtarisht dhe ishin të aksesueshme nga publiku. Megjithëse ka patur mosmarrëveshje në lidhje me aksesibilitetin e dispozitave të tjera, Gjykata vuri re që ato ishin publikuar në një revistë zyrtare ministeriale dhe mund të aksesoheshin nëpërmjet një baze të dhënash ligjore në internet, dhe në këtë mënyrë nuk e pa të arsyeshme të ndiqte më tej këtë çështje.

(ii) *Objekti i zbatimit të masave të mbikëqyrjes së fshehtë* – Natyra e veprave penale që mund të bëhet shkak për një urdhër përgjimi ishte e qartë në masë të mjaftueshme. Megjithatë, ishte një çështje shqetësimi që ligji i brendshëm lejonte përgjimin e fshehtë të komunikimit në lidhje me një gamë të gjerë veprash penale. Për më tepër, përgjimi mund të urdhërohej jo vetëm në lidhje me një të dyshuar apo të akuzuar, por edhe në lidhje me personat që mund të kenë dijeni në lidhje me një vepër penale. Ndërsa Gjykata ka vënë re në një çështje të mëparshme që masat e përgjimit në lidhje me një person as ka informacion për një vepër penale mund të justifikohet sipas Nenit 8, ajo vuri re që në këtë rast ligji i brendshëm nuk sqaronte se kush mund të përfshihet në këtë kategori në praktikë. Ligji nuk jepte as ndonjë indicie për rrethanat në të cilat mund të përgjohet komunikimi për shkak të ngjarjeve ose aktiviteteve që rrezikonin sigurinë kombëtare, ushtarake, ekonomike ose ekologjike të Rusisë. Në vend të kësaj, ai u linte autoriteteve një diskrecion pothuaj të pakufizuar për të përcaktuar cilat ngjarje apo veprime përbënin një kërcënim të tillë dhe nëse kërcënimin ishte mjaft serioz për të justifikuar përgjimin. Kjo krijonte mundësi për abuzime.

(iii) *Kohëzgjatja e masave të mbikëqyrjes së fshehtë* – Ndërsa ligji i brendshëm përmbante rregulla të qarta për kohëzgjatjen dhe rinovimin e përgjimeve duke parashikuar garanci të përshtatshme kundër abuzimit, dispozitat përkatëse për

ndërprerjen e masave të përgjimit nuk jepnin garanci të mjaftueshme ndaj ndërhyrjes arbitrare.

(iv) *Procedurat, ndërmjet të tjerash, për ruajtjen dhe asgjësimin e të dhënave të përgjuara* – Ligji i brendshëm përmbante rregulla të qarta që rregullon ruajtjen, përdorimin dhe komunikimin e të dhënave të përgjuara, duke e bërë të mundur minimizimin e riskut të aksesit ose deklarimit të paautorizuar. Megjithatë, megjithëse gjykata e konsideroi të arsyeshme afatin kohor gjashtë-mujor të zbatueshëm për ruajtjen e materialit të përgjuar, nëse personi përkatës nuk akuzohet për një vepër penale, ajo ndjeu keqardhje për mungesën e një kërkesë për asgjësimin e menjëhershëm të çdo të dhëne që nuk janë relevante për qëllimin për të cilin janë marrë (1. lordachi dhe Të tjerë kundër Moldavisë, 25198/02, 10 shkurt 2009, Shënim Informativ 116. Ruajtja automatike për gjashtë muaj e të dhënave qartësisht jo-relevante nuk mund të konsiderohet e justifikuar sipas Nenit 8. Për më tepër, në rastet kur personi nën përgjim akuzohej për një vepër penale, gjyqtari i çështjes kishte diskrecion të pakufizuar sipas ligjit të brendshëm për të vendosur nëse duhet të urdhërohet ruajtja e mëtejshme apo asgjësimi i materialit të përgjuar të përdorur si provë. Qytetarët e zakonshëm nuk kishin asnjë indici në lidhje me rrethanat në të cilat mund të ruhej materiali i përgjuar. Ligji i brendshëm nuk ishte i qartë në këtë pikë.

(v) *Autorizimi i përgjimeve* – Në lidhje me procedurat e autorizimit, çdo përgjim i telefonit ose një komunikimi tjetër duhej të autorizohet nga gjykata. Megjithatë, shqyrtimi gjyqësor ishte i kufizuar në objekt. Veçanërisht, materialet që përmbanin informacione në lidhje me agjentet e fshehtë ose informatorët e policisë ose në lidhje me organizimin e taktikave të masave të kërkimeve operacionale nuk mund ti paraqiteshin gjyqtarit dhe përjashtoheshin nga objekti i rishikimit të gjykatës. Kështu, mosdeklarimi i informacionit përkatës gjykatave u hiqte atyre kompetencën për të vlerësuar nëse ka patur bazë faktike të mjaftueshme për të dyshuar personat në lidhje me të cilët janë kërkuar masat e kërkimit operacionel të një natyre penale ose të aktiviteteve që rrezikojnë sigurinë kombëtare, ushtarake, ekonomike ose ekologjike. Vërtet që gjyqtarët rusë nuk ishin udhëzuar të verifikonin ekzistencën e ‘dyshimit të arsyeshëm’ ndaj një personi përkatës ose të zbatimin testet e ‘domosdoshmërisë’ ose të ‘proporcionalitetit’. Përveç kësaj, ligji i brendshëm përkatës nuk përmbante kërkesa në lidhje me përmbajtjen e kërkesave ose autorizimeve të përgjimeve. Si rezultat, gjykatat ndonjëherë autorizonin përgjimin e të gjitha komunikimeve telefonike në një zonë ku ishte kryer një vepër penale, pa përmendur ndonjë person ose numër telefoni specifik. Disa autorizime nuk përmendnin kohëzgjatjen për të cilën ishte autorizuar përgjimi. Këto autorizime jepnin një diskrecion tepër të gjerë për autoritetet ligj-zbatuese se cilat komunikime duheshin përgjuar dhe për sa kohë. Për më tepër, në raste urgjente, ishte e mundur të përgjoheshin komunikimet pa autorizime paraprake gjyqësore për deri në 48 orë. Megjithatë, procedura urgjente nuk parashikonte garanci të mjaftueshme për të garantuar që ajo përdorej me kursim dhe vetëm në rastet vërtet të justifikuara. Ligji i brendshëm nuk e kufizonte përdorimin e procedurës urgjente në rastet që përfshinin rrezik serioz të menjëhershëm dhe në këtë mënyrë u jepte autoriteteve diskrecion të pakufizuar për

të përcaktuar situatat në të cilët përdorej, duke krijuar kështu mundësi për abuzime. Për më tepër, megjithëse sipas ligjit të brendshëm një gjyqtar duhej të informohej menjëherë në lidhje me çdo rast përgjimi urgjent, kompetenca e gjyqtarit ishte e kufizuar në autorizimin e zgjatjes së masës së përgjimit tej 48 orëve. Ligji rus nuk parashikonte një rishikim gjyqësor të efektshëm të procedurës urgjente. Përfundimisht, procedurat e autorizimit të parashikuara nga ligji rus nuk ishin në gjendje të garantonin që masat e përgjimit të fshehtë nuk ishin urdhëruar në mënyrë të parregullt dhe duke mos u dhënë konsideratën e duhur. Një vështirësi tjetër ishte që autoritetet ligj-zbatuese përgjithësisht nuk kishin ndonjë detyrim sipas ligjit të brendshëm për të treguar autorizimin gjyqësor tek ofruesi i shërbimeve të komunikimit para aksesimit të komunikimeve, ndërsa për pjesën e tyre ofruesit e shërbimeve duhej të instalonin pajisjet që u jepnin autoriteteve akses të drejtpërdrejtë tek të gjitha komunikimet e përdoruesve të telefonisë celulare. Sistemi, në këtë mënyrë, ishte i lehtë për tu abuzuar.

(vi) *Mbikëqyrja* – Ndalimi i caktuar në ligjin e brendshëm për hedhjen ose regjistrimin e përgjimeve e bënte të pamundur për autoritetin mbikëqyrës të zbulonte përgjimet e kryera pa autorizim përkatës gjyqësor. Kombinuar me aftësinë teknike të autoriteteve për të përgjuar komunikimet drejtpërdrejt, kjo dispozitë e bënte çdo masë mbikëqyrëse të papërshtatshme për zbulimin e ndërhyrjeve të paligjshme dhe në këtë mënyrë ishte e paefektshme. Kur përgjimet bëheshin mbi bazën e autorizimit përkatës gjyqësor, mbikëqyrja gjyqësore ishte e kufizuar në fazën fillestare të autorizimit. Mbikëqyrja e mëvonshme i besohej Presidentit, Parlamentit, Qeverisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe prokurorëve kompetentë të nivelit më të ulët. Ligji i brendshëm nuk parashikonte mënyrën në të cilën mund të parashikonte përgjimet Presidenti, Parlamenti dhe Qeveria. Nuk ka rregullore apo udhëzime praktike që përshkruajnë objektin e rishikimit të tyre, kushtet në të cilat mund të kryhen ose procedurat për rishikimin e masave të mbikëqyrjes ose ndreqjen e shkeljeve. Ndërsa një kuadër ligjor parashikonte, të paktën në teori, mbikëqyrje nga prokurorët, në praktikë nuk ishte në gjendje të parashikonte garanci të përshtatshme dhe efektive ndaj abuzuesit. Veçanërisht:

- ka patur dyshime në lidhje me pavarësinë e prokurorëve pasi ata emëroheshin dhe largoheshin nga detyra nga Prokurori i Përgjithshëm pas konsultimit me autoritetet ekzekutive rajonale dhe kishin funksione të mbivendosura pasi ata aprovonin kërkesat për përgjim dhe mbikëqyrnin zbatimin e tyre;
- kishte kufij në objektin e përgjimit (prokurorët nuk kishin informacion në lidhje me punën e agjentëve të fshehtë dhe masat e përgjimit në lidhje me kundër-zbulimin nuk ishin nën mbikëqyrjen e tyre pasi personat përkatës nuk do të ishin në dijeni që po i nënshtroheshin përgjimit dhe në këtë mënyrë nuk ishin në gjendje të bënin ankim);
- ka patur kufij për kompetencat e tyre, për shembull, edhe nëse ata mund të merrnin masa për të ndaluar ose korigjuar shkeljet dhe për t'u kërkuar llogari personave përgjegjës, nuk ka patur dispozitë specifike që të kërkojë asgjësimin e materialit të përfutur në mënyrë të paligjshme;

- mbikëqyrja e tyre nuk ishte e hapur për kontrollin dhe informimin e publikut pasi raportet e tyre nuk publikoheshin dhe nuk ishin të aksesueshme për publikun;
- Qeveria nuk kishte paraqitur asnjë raport inspektimi apo vendime nga prokurorët që urdhëronin marrjen e masave për të ndaluar ose korrigjuar një shkelje të zbuluar të ligjit.

(vii) *Njoftimi i përgjimit dhe mjetet mbrojtëse të disponueshme* – Personat të cilëve u përgjoheshin komunikimet nuk njoftoheshin. Përveç kur niste çështja penale ndaj personit të përgjuar dhe të dhënat e përgjuara përdroreshin si prova, personi përkatës nuk dot ë vinte në dijeni të faktit që komunikimet e tij ose të saj ishin përgjuar. Personat që në një farë mënyrë mund ta konstatonin mund të kërkonin informacion në lidhje me të dhënat përkatëse. Megjithatë, me qëllim që të bëhej një kërkesë e tillë ata duhej të ishin në zotërim të fakteve të masave të kërkimeve operacionale të cilave ata u ishin nënshtruar. Aksesi në informacion varej nga aftësia e personit për të provuar një komunikim e tiji ose të saj ishin përgjuar. Për më tepër, subjektet e përgjuara nuk kishin të drejtë të aksesonin dokumente në lidhje me përgjimin e komunikimeve të tyre: ata në rastin më të mirë mund të kishin të drejtën të kërkonin ‘informacion’ në lidhje me të dhënat e mbledhura. Ky informacion jepej vetëm në rrethana të kufizuara, d.m.th., nëse faji i personit nuk ishte provuar në pajtim me ligjin dhe informacioni nuk përmbante sekrete shtetërore. Meqenëse sipas ligjit rus informacioni në lidhje me mjetet e përdorura në këto aktivitete të kërkimit operacional, metodat e zbatuara, nëpunësit e përfshirë dhe të dhënat e mbledhura përbënin sekret shtetëror, mundësia e marrjes së informacionit në lidhje me përgjimet dukej pa efekt. Mjetet gjyqësore që përmendeshin nga Qeveria u ofroheshin vetëm personave në zotërim të informacionit në lidhje me përgjimin e komunikimeve të tyre. Efektiviteti i tyre minohej nga mungesa e një kërkesë për të njoftuar subjektin e përgjimit ose e një mundësie të përshtatshme për të kërkuar informacion në lidhje me përgjimet nga autoritetet. Për pasojë, ligji rus nuk parashikon ndonjë mjet të efektshëm gjyqësor ndaj masave të përgjimit të fshehtë në rastet kur nuk fillon çështja penale ndaj subjektit të përgjuar. Si përfundim, dispozitat ligjore të brendshme që rregullojnë përgjimin e komunikimeve nuk parashikonin garanci të efektshme dhe të përshtatshme ndaj arbitraritetit dhe riskut ë abuzimit. Ligji i brendshëm nuk përmbushte kërkesën e “cilësisë ligjore” dhe nuk ishte në gjendje për të mbajtur ‘ndërhyrjen’ vetëm për atë që është ‘e nevojshme në një shoqëri demokratike’.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: Konstatimi i një shkeljeje përbënte përbushje të drejtë dhe të mjaftueshme për çdo dëm jo-financiar

Ndarje e pamjaftueshme e mjediseve sanitare nga pjesa tjetër e qelisë së burgut: shkelje

**Szafrański kundër Polonisë** - 17249/12 Vendimi 15.12.2015 (Seksioni IV)

**Fakte** – Në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës Evropiane, kërkuesi u ankua që kushtet e ndalimit të tij në Burgun Wronki ishin të papërshtatshme. Veçanërisht, ai u ankua që në shtatë nga dhjetë qelitë në të cilat ai ishte ndaluar, mjediset sanitare ishin të ndara nga pjesa tjetër e qelisë me vetëm një ndarje kartonxhese të lartë 1.20 metra dhe nuk ishte dyer.

**Ligji** - Neni 3 (aspekti lëndor): Në çështjet e mëparshme, kur nuk ka patur ndarje të mjaftueshme ndërmjet mjediseve sanitare dhe pjesës tjetër të qelisë, Gjykata ka konstatuar një shkelje të Neni 3 vetëm nëse kanë qenë të pranishme faktorë të tjerë rëndues dhesi rezultat i efektit të tyre të mbledhur. Megjithatë, në këtë çështje e vetmja vështirësi që duhej të duronte kërkuesi ishte ndarja e pamjaftueshme e mjediseve sanitare nga pjesa tjetër e qelisë. Përveç kësaj, qelitë ishin me dritë, ngrohje dhe ventilim të mjaftueshëm, dhe ai kishte akses tek aktivitetet e ndryshme jashtë qelive. Kështu, rrethanat e ndalimit në tërësi nuk mund të konsideroheshin se kishin shkaktuar shqetësim dhe vështirësi që kalonin nivelin e paevitueshëm të vuajtjes që është karakteristike për ndalimin apo që kishin kaluar tej pragut të ashpërsisë sipas neni 3.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (unanimisht)

Neni 8: Në praktikën gjyqësore të Gjykatës, autoritetet kanë një detyrim pozitiv për të siguruar akses tek mjediset sanitare të ndara nga pjesa tjetër e qelisë së burgut në një mënyrë të tillë që të sigurohet minimumi i privatësisë. Sipas Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin dhe Dënimin Çnjerëzor dhe Poshtëruet (CPT), një aneks sanitar që ishte vetëm pjesërisht i ndarë nuk ishte e pranueshme në një qeli ku ishin sistemuar më shumë se një i ndaluar. Përveç kësaj, CPT-ja kishte rekomanduar që të instalohesh një ndarje e plotë e të gjitha anekseve sanitare në qeli. Përveç kësaj, kërkuesi ishte vendosur në qeli në të cilat mjediset sanitare nuk ishin plotësisht të ndara dhe duhej të përdorte tualetin në prani të të burgosurve të tjerë. Autoritetet e brendshme në këtë mënyrë nuk e kishin përmbushur detyrimin e tyre pozitiv për të siguruar një nivel minimal privatësie për kërkuesin.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: 1,800 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

## Neni 9

Mos-rinovimi i kontratës së punësimit nga spitali për shkak të refuzimit të heqjes së shamisë së kokës: nuk ka shkelje

**Ebrahimian kundër Francës** - 64846/11 Vendim 26.11.2015 (Sekstion V)

**Fakte** – Në vitin 1999 kërkuesja u punësua me një kontratë me afat në shërbimin e spitalit publik si punonjëse sociale në departamentin psikiatrik të një spitali publik. Në vitin 2000 ajo u informua që kontrata e saj nuk do të rinovohej. Ky vendim bazohej në

refuzimin e saj për të hequr perçen dhe ankesat e bëra nga një numër pacientësh në qendër. Para kësaj ishte bërë një internistë gjatë së cilës kërkuesja nuk ishte kritikuar për përkatësinë e saj fetare por thjesht i ishin kujtuar të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të shërbimit publik, që është ndalimi i shfaqjes së përkatësisë fetare. Mos-rinovimi i kontratës bazohej në një mendim të Këshillit të Shtetit që tregonte që parimi i natyrës sekulare të shtetit dhe ajo e neutralitetit të shërbimeve publike zbatoheshin për të gjitha shërbimet publike. Ai vërente që punonjësit e shërbimit publik duhej të gëzonin lirinë e ndërgjegjes por kjo liri, përsa i takon shprehjes, duhej të silllej në pajtim me parimin e neutralitetit të shërbimit publik, gjë që përjashtonte veshjen e një simboli që tregonte përkatësinë fetare. Për më tepër, në rastin e shkeljes së këtij detyrimi të neutralitetit, ai tregonte që pasojat në kuptimin e procedimeve disiplinore duhej të vlerësoheshin rast pas rasti sipas rrethanave përkatëse. Ankimet e bëra nga kërkuesja ishin rrëzuar. Në vitin 2001, kërkuesja ishte regjistruar nga subjekti që e kishte punësuar atë në një garë për të punësuar asistentë socialë. Ajo nuk mori pjesë në garë.

**Ligji** – Neni 9: Mos-rinovimi i kontratës së kërkuesit solli ndërhyrjen tek e drejta e saj për të manifestuar fenë e saj. Kjo ndërhyrje ishte e parashikuar me ligj dhe ndiqte qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Qëllimi i kësaj çështjeje ishte të ruhej respekti për të gjitha besimet fetare dhe orientimet shpirtërore të pacientëve, të cilët merrnin shërbimet publike dhe përfitonin nga kërkesa e neutralitetit që vendosej mbi kërkuesen, duke siguruar barazi rigoroze ndërmjet tyre. Objektivi ishte gjithashtu sigurimi që përdoruesit të gëzonin barazinë e trajtimit pa asnjë dallim për shkaqe fetare. Për pasojë, kufizimi ndiqte qëllimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe nuk duhej të motivohej më tej nëpërmjet kufizimeve të sigurisë publike ose të ruajtjes së rendit publik. Në lidhje me dosmosdoshmërinë e masave në fjalë, duhet të vihet re që autoritetet kishin informuar kërkuesin për shkaqet se pse ky parim justifikonte aplikimin specifik për një punonjës social në një pavijon psikiatrik të spitalit. Autoritetet kishin identifikuar problemet e krijuara nga qëndrimi i saj brenda pavijonit në fjalë dhe ishin përpjekur ta detyronin atë të kufizohej nga shfaqja e besimeve të saj fetare. Për më tepër, gjykatat e ulëta kishin konsideruar që kërkesa e neutralitetit e imponuar mbi kërkuesen ishte më rigoroze pasi ajo ishte në kontakt me pacientë në një gjendje delikate dhe të varur. Dukej nga dosja që ishte kërkesa e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve, që është, respekti i lirisë së fesë për gjithkënd, dhe jo besimet e saj fetare, që ishte baza për vendimin në fjalë. Nga ky këndvështrim, neutraliteti i shërbimit të spitalit publik mund të konsiderohej i lidhur me qëndrimin e personelit duke kërkuar që pacientët të mos kishin asnjë dyshim në lidhje me paanësinë e tyre. Në Francë, punonjësit e shërbimit publik gëzonin të drejtën e lirisë së tyre të ndërgjegjes e cila ndalonte, ndërmjet të tjerash, çdo diskriminim bazuar në fe përsa i takon funksioneve dhe ecjes në karrierë. Megjithatë, atyre u ndalohej të manifestonin besimet e tyre fetare në përmbushjen e detyrave të tyre. Fakti që gjykatat e brendshme i kishin dhënë peshë më të madhe parimit të secularizmit dhe neutralitetit dhe interesit të shtetit krahasuar me interesin e kërkueses për të mos shprehur besimin e saj fetar, nuk krijonte ndonjë problem me Konventën. Ky ishte një detyrim rigoroz që i kishte rrënjët në raportet tradicionale ndërmjet natyrës sekulare të shtetit dhe lirisë së ndërgjegjes, sipas parashikimit në Nenin 1 të Kushtetutës. Sipas



modelit francez, në të cilin nuk ishte detyra e Gjykatës të vendosë, neutraliteti i Shtetit ishte detyrues për nëpunësit që e përfaqësojnë atë. Megjithatë, detyra e gjykatave administrative ishte të garantonin që autoritetet nuk ndërhyjnë në mënyrë disproporcionale tek e drejta e ndërgjegjes së punonjësve të shërbimit civil kur bëhet fjalë për neutralitetin e shtetit. Kërkesja, për të cilën ishte e rëndësishme të manifestonte fenë e saj duke veshur në mënyrë të dukshme një shami koke për shkaqe të besimit të saj fetar, ishte ekspozuar në pasojën e procedimit disiplinor. Megjithatë, nuk kishte dyshim që, sipas opinionit të datës 3 maj 200, ajo ishte në dijeni që ajo duhej të respektonte një kod veshjeje neutrale në përmbushjen e funksioneve të saj. Ishte për shkak të refuzimit të saj për të përmbushur këtë detyrim, pavarësisht cilësive të saj profesionale, që procedimi disiplinor filloi ndaj saj. Në këtë moment ajo kishte përfitimin e garancive në lidhje me procedimin disiplinor dhe mjeteve të mbrojtjes para gjykatave administrative. Për më tepër, ajo kishte zgjedhur për të mos marrë pjesë në garën e punësimit të asistentëve socialë megjithëse ishte regjistruar në listën e kandidatëve që institucioni kishte përpiluar duke qenë në dijeni të plotë të fakteve. Në këto rrethana, autoritetet e brendshme nuk e kishin tejkaluar marzhin e vlerësimit duke konstatuar që nuk kishte mundësi që bindja fetare e kërkuësës të ishte në një linjë me detyrimin për të mos i manifestuar ato dhe duke vendosur ti jepnin prioritet kërkesës së neutralitetit dhe paanësisë së Shtetit. Për më tepër, mund të shihej nga një raport i Observatory of Secularism që mosmarrëveshjet që lindnin nga manifestimi i besimeve fetare të personave që punojnë në shërbimet spitalore vlerësoheshin në bazë rast pas rasti me interesat konkurruese që balancoheshin nga autoritetet në përpjekje për të gjetur zgjidhje me pajtim. Vullneti për të balancuar interesat konkurruese u confirmua nga numri i ulët i çështjeve të këtij lloji që shkonin në gjykatë. Së fundmi, spitalet ishin një vend ku përdoruesve, të cilët me gjithë të drejtën e tyre të lirisë së shprehjes së besimeve fetare, u kërkohej të kontribuonin në zbatimin e parimit të sekularizmit duke u kufizuar në çdo veprim anësie dhe të respektonin organizimin e shërbimit dhe veçanërisht kërkesat e shëndetit dhe higjienës. Me fjalë të tjera, rregullimet e shtetit i kishin dhënë prioritet të drejtave të të tjerëve, barazisë së trajtimit të pacientëve dhe funksionimit të shërbimit kundrejt manifestimeve të besimeve fetare.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (gjashtë vota me një)

## Neni 10

Largimi nga puna e punonjësit të bashkisë për shkak të akuzimit të zëvendëskryetarit të bashkisë për “shtrembërim të drejtësisë”: nuk ka shkelje

**Langner kundër Gjermanisë** - 14464/11 Vendim 17.9.2015 (Seksioni V)

**Fakte** – Kërkuesi u largua nga puna e tij nga një zyrë strehimi në bashki pas akuzimit të zëvendëskryetarit të bashkisë për “shtrembërim të drejtësisë” gojarisht në një mbledhje

të personelit dhe në komentet pasuese me shkrim tek eprori hierarkik i kërkuesit. Akuza lidhej me një urdhër prishjeje të dhënë nga zëvendëskryetari i bashkisë dy vjet më parë. Kërkuesi pretendoi gjithashtu që zëvendëskryetari i bashkisë ishte përpjekur në mënyrë të paligjshme të shkrinte nën-seksionin që kryesonte kërkuesi. Kërkuesi e kundërshtoi largimin e tij në gjykatat gjermane, që përfundimisht e gjetën largimin e tij të bazuar. Në procedimin sipas Konventës, kërkuesi u ankua për shkeljen e së drejtës së tij të lirisë së shprehjes.

**Ligji** – Neni 10: Largimi i kërkuesit, që bazohej kryesisht në deklaratimet që ai kishte bërë gjatë një mbledhjeje të personelit, kishte ndërhyrë në të drejtën e tij të lirisë së shprehjes. Kjo ndërhyrje ishte e parashikuar me ligj (Seksioni 53 i Marrëveshjes Kolektive për Punonjësit e Shërbimit Publik në lidhje me Seksionin 1 të Aktit të Pushimit të Padrejtë) dhe ndiqte qëllimin legjitim të mbrojtjes së reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve. Gjykatës i duhej të përcaktonte nëse, duke marrë parasysh çështjen në tërësi, sanksioni i vendosur mbi kërkuesin ishte proporcional me qëllimin legjitim që ndiqej dhe nëse shkaqet e dhëna nga autoritetet e brendshme në mbështetje të tij ishin relevante dhe të mjaftueshme. Për këtë vendimmarrje, ajo duhej të merrte parasysh rrethanat e çështjes, duke përfshirë motivimin për deklaratimet e kërkuesit, bazën faktike dhe ligjore, tekstin faktik të përdorur dhe interpretimet e mundshme, ndikimin e saj mbi punëdhënësin dhe sanksionin e caktuar kërkuesit. Në lidhje me motivimin e deklaratimit, Gjykata vuri re që në vend të ngritjes së shqetësimeve të tij në lidhje me vendimin e zëvendëskryetarit të bashkisë tek kryetari bashkisë ose autoriteti i ndjekjes penale, kërkuesi i kishte ngritur ato në një mbledhjeje personeli dy vjet më vonë. Gjykata Federale e Punës kishte konstatuar që deklaratimet e kërkuesit nuk kishin si synim zbulimin e një situatë të papranueshme brenda Zyrës së Strehimit, por ishte motivuar nga konsiderata personale që ai kishte për zëvendëskryetarin në lidhje me suprimimin e pritshëm të nën-seksionit të kërkuesit. Kështu Gjykata konsideroi që çështja e kërkuesit nuk ishte një ‘sinjalizim’ që kërkonte mbrojtje sipas Neni 10. Pas zhvillimit të një shqyrtimi të hollësishtëm të situatës faktike dhe ligjore, Gjykata e Punës e Apelit kishte nxjerrë përfundimin që vendimi i zëvendëskryetarit në nxjerrjen e lejes së prishjes ishte i ligjshëm. Pas një eksperience të gjatë si shef i nën-seksionit për sanksionimin e keqpërdorimit të pasurive të strehimit, kërkuesi duhej të ishte i mirë-informuar me kuadrin ligjor. Për pasojë, Gjykata nuk ishte e bindur që ai kishte përmbytur detyrimin e tij për të verifikuar me kujdes saktësinë e akuzave të tij. Po ashtu, në lidhje me pozicionin e tij, kërkuesi mund të prezumohet të ketë qenë në dijeni që “shtrembërimi i drejtësisë” ishte një krim i rëndë (Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut / Shënim Informativ 188 – Gusht – Shtator 2015 22 Neni 10 – Neni 35 § 1) sipas ligjit të brendshëm. Sipas mendimit të Gjykatës, përdorimi i kësaj shprehjeje përbënte një akuzë fyese – që kërkuesi nuk e kishte tërhequr – dhe jo një kritikë në interesin publik. Në lidhje me ndikimin e akuzave për punëdhënësin, gjykatat e brendshme kishin konstatuar që ato nuk mund të prishnin reputacionin e zëvendëskryetarit të bashkisë, por ndërhyenin seriozisht në atmosferën e punës brenda Zyrës së Punësimit. Ekzistonte po ashtu një risk që kjo të bëhej e ditur për një publik më të gjerë, pasi jo të gjithë ata që ishin të pranishëm në mbledhje ishin anëtarë të personelit. Së fundmi, megjithëse largimi i kërkuesit ishte sanksioni më i rëndë i mundshëm për,

Gjykata e Punës së Apelit mendonte që bashkia me të drejtë mund të shqetësohej që kërkuesi do ti kthehej sjelljes së tij të mëparshme nëse rikthehej, sipas mendimit të Gjykatës, nuk ishte e paarsyeshme. Duke patur parasysh konsideratat e mësipërme, dhe veçanërisht faktin që Gjykata Federale e Punës dhe Gjykata e Punës e Apelit e kishin shqyrtuar me kujdes çështjen në dritën e së drejtës së kërkuetit për lirinë e shprehjes, Gjykata e konsideroi arsyetimin e gjykatave të brendshme për të vendosur që e drejta e kërkuetit për lirinë e shprehjes nuk mbizotëronte mbi interesin e punëdhënësit publik në largimin e tij nga puna. Kështu, nuk ka patur ndonjë ndërhyrje tek e drejta e kërkuetit për lirinë e shprehjes.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (unanimisht).

Arrestimi dhe dënimi i gazetarit për shkak të mosbindjes së urdhrave gjatë një demonstrate: nuk ka shkelje

#### ***Pentikäinen kundër Finlandës*** - 11882/10 Vendim 20.10.2015 (GC)

**Fakte** – Në vitin 2006 kërkuesi u dërgua të raportonte për një demonstratë në cilësinë e tij si gazetar dhe fotograf. Pasi demonstrata u bë e dhunshme, policia vendosi ti pengonte demonstruesit në marshimin e tyre dhe të lejonte një demonstratë paqësore të zhvillohej në një vend. Pastaj ata e izoluan zonën dhe urdhëruan protestuesit të shpërndaheshin. Megjithatë atyre iu kërkua disa herë të largoheshin nga vendi, kërkuesi vendosi të qëndronte me demonstruesit. Menjëherë pas kësaj ai u arrestua së bashku me një numër demonstruesish dhe u mbajtën të ndaluar për 17 orë. Pastaj ai u fajësua për mosbindje të urdhrave të policisë por nuk iu caktua masë dënimi. Ky vendim u la në fuqi nga apeli dhe ankesat pasuese të kërkuetit në Gjykatën e Lartë u rrëzuan. Në një vendim të datës 4 shkurt 2014, një Dhomë e Gjykatës, në një votim pesë me dy, që nuk ka patur shkelje të Neni 10 (shih Shënimin Informativ 171). Më 2 qershor 2014, çështja iu referua dhomës së Madhe me kërkesë të kërkuetit.

**Ligji** – Neni 10: Gjatë vlerësimit të domosdoshmërisë së ndërhyrjes tek liria e shprehjes së kërkuetit, gjykata duhet të peshonte dy interesa konkurrues: interesi i publikut për marrjen e informacionit për një çështje me interes të përgjithshëm dhe asaj të policisë në ruajtjen e rendit publik në kontekstin e një demonstrate të dhunshme. Në këtë kontekst, Gjykata theksoi rolin e “rojës” së medias në dhënien e informacionit mbi trajtimin nga ana e autoriteteve të demonstratave publike dhe kufizimin e parregullsive. Çdo përpjekje për të larguar gazetarët nga vendi i një demonstrate i është nënshtruar shqyrtimit të rreptë. Nga ana tjetër, mbrojtja e dhënë nga neni 10 për gazetarët iu nënshtrua kushtit që ata të veprojnë në pajtim me parimet e gazetarisë së përgjegjshme. Për pasojë, gazetarët në ushtrimin e lirisë së tyre të shprehjes merrnin përsipër “detyra dhe përgjegjësi” që do të thotë që ata nuk mund të pretendonin imunitet ndaj përgjegjësisë penale thjesht për shkak se vepra penale në fjalë është kryer gjatë përbushjes së funksioneve të tyre

gazetareske. Në lidhje me arrestimin e gazetarit, dosja e çështjes nuk nxori asnjë shkak për të dyshuar që urdhrat e policisë për të shpërndarë demonstratën nuk bazoheshin në një vlerësim të arsyeshëm të fakteve. Për më tepër, masat parandaluese të ndërmarra për mundësinë e eskalimit të ngjarjeve dukeshin të justifikuar. Ato orientoheshin jo vetëm nga mbrojtja 'abstrakte' e rendit publik, por edhe nga siguria e individëve në demonstratë ose afër saj, duke përfshirë anëtarët e medias dhe, në këtë mënyrë, kërkuesin vetë. Në lidhje me sjelljen e kërkuesit, Gjykata së pari vuri re që shfaqja e tij fizike gjatë demonstratës nuk e dallonte atë qartë nga demonstruesit e tjerë, pasi ai nuk ishte ndonjë veshje të dallueshme ose ndonjë shenjë që ta identifikonte atë si gazetar. Kështu ishte e mundur që ai të mos ishte i identifikueshëm para arrestit të tij. Nëse ai donte të dallohej si gazetar nga policia, ai duhej të kishte bërë përpjekje të dukshme për t'u identifikuar si i tillë duke veshur veshje të dallueshme, të mbante kartën e identitetit të shtypit ose nëpërmjet një mjeti tjetër të përshtatshëm. Si gazetar që raporton mbi veprimet e policisë, ai duhej të ishte në dijeni për pasojat ligjore të mosbindjes së urdhrave të policisë dhe duke mos e bërë këtë, ai kishte marrë përsipër riskun e arrestit duke qenë i vetëdijshëm. Për më tepër asnjë në dosje nuk tregon që kërkuesi nuk do të kishte qenë në gjendje të përmbushte detyrën e tij profesionale në afërsi fizike nëse do ti ishte bindur urdhrat për tu larguar nga zona e rrethuar me kordon policie. Për sa i takon ndalimit të kërkuesit, megjithëse ai ishte ndaluar në rajonin e policisë për shtatëmbëdhjetë orë e gjysmë, për shkak të statusit të tij si gazetar, ai ishte një nga të parët që ishte marrë në pyetje dhe lënë i lirë. Për më tepër, megjithëse nuk ishte tërësisht e qartë se si kamera e tij dhe karta e memorjes ishin trajtuar pas arrestit të tij, nuk doli që kjo pajisje të ishte konfiskuar në ndonjë moment dhe ai ishte lejuar të mbajte të gjitha fotografitë që ai kishte bërë pa asnjë kufizim në përdorimin e tyre. Në lidhje me dënimin, megjithëse kërkuesi përfundimisht u konstatua me faj për mosbindje ndaj policisë, atij nuk iu caktua ndonjë masë dënimi. Çdo ndërhyrje në lirinë e tij gazetareske kishte qenë në një masë të kufizuar, duke patur parasysh mundësitë që ai kishte për të mbuluar ngjarjen në mënyrë të arsyeshme. Gjykata theksoi që sjellja e sanksionuar nga dënimi penal nuk ishte aktiviteti gazetaresk i kërkuesit si i tillë, por refuzimi i tij për të përmbushur urdhrin e policisë në fund të një demonstrate që ishte gjykuar nga policia se do të shndërrohej në rrëmujë. Në këtë aspekt, fakti që kërkuesi ishte gazetar nuk i jepte atij të drejtën e një trajtimi preferencial ose të ndryshëm krahasuar me të tjerët në atë vend. Vërtet që legjislacioni i shumicës së Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës nuk jepte ndonjë status të veçantë për gazetarët kur ata nuk përmbushnin urdhrat e policisë për t'u larguar nga një vend ku zhvillohet demonstratë. Për më tepër, koncepti i gazetarisë së përgjegjshme kërkonte që kurdoherë që gazetarët duhej të zgjidhnin ndërmjet detyrës së përgjithshme për t'u ligjit të zakonshëm penal dhe detyrës së tyre profesionale për të marrë dhe shpërndarë informacion, dhe kanë zgjedhur opsionin e dytë, ata duhej të ishin të ndërgjegjshëm që ata merrnin riskun e marrjes në ngarkim të sanksioneve ligjore, duke përfshirë atë të një karakteri penal. Së fundmi, asnjë dënim nuk i është dhënë kërkuesit për shkak se veprimi i tij u konsiderua 'i justifikueshëm': si gazetar, ai kishte hasura pritshmëri kontradiktore që rridhnin nga detyrimet e vendosura mbi të nga policia, nga ana tjetër, nga punëdhënësi i tij. Dënimi i tij ishte thjesht një konstatim formal që ai kishte

kryer një vepër penale dhe si e tillë ajo nuk mund të ketë ndonjë ‘efekt pengues’ për personat që marrin pjesë në demonstrime. Dënimi i kërkuesit mund të konsiderohet si proporcional me qëllimin legjitim të ndjekur.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (trembëdhjetë vota me katër)

Urdhër gjykatë që ndalon shpërndarjen e fletëpalosjeve që barazojnë abortin me Holokaustin dhe publikimin e të dhënave të kontaktit online për mjekët që kryenin aborte: *shkelje*

**Annen kundër Gjermanisë** - 3690/10 Vendim 26.11.2015 (Seksioni V)

**Fakte** – Në vitin 2005 kërkuesi, një aktivist kundër abortit, shpërndau fletëpalosje në afërsi të një klinike të menaxhuar nga Mjekët M. dhe R. ku kryheshin aborte. Fletëpalosje përmbante tekstin e mëposhtëm me germa të theksuara: “Në klinikën ditore Dr M./ Dr. R. (emrat e plotë dhe adresa) kryhen aborte të paligjshme”. Kjo pasohej me një shpjegim me germa të vogla që, megjithatë, abortet lejohen nga legjislacioni gjerman dhe nuk i nënshtroheshin përgjegjësisë penale. Nga ana e prapme e fletëpalosjes, ishte shkruar që “Vrasja e qenieve njerëzore në Auschwitz ishte e paligjshme, por Shteti (Nazist) i degraduar moralisht e lejonte vrasjen e njerëzve të pafajshëm dhe nuk ia nënshtronte atë përgjegjësisë penale”. Nën këtë fjali fletëpalosja iu referua një faqeje interneti të operuar nga kërkuesi që përmbante një listë adresash të quajtur “mjekët e aborteve”, duke përfshirë klinikën dhe emrat e plotë të mjekëve M. dhe R. Pas një ankimi nga të dy mjekët, gjykatat e brendshme urdhëruan kërkuesin të hiqte dorë nga shpërndarja e mëtejshme e fletëpalosjeve në fjalë dhe nga përmendja e emrave dhe adresave të mjekëve në faqen e internetit. Ankimi pasues i kërkuesit u rrëzua. Në procedimin sipas Konventës, kërkuesi u ankua për shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes.

**Ligji** – Neni 10

(a) *Një urdhër për të hequr dorë nga shpërndarja e fletëpalosjeve në afërsi të klinikës* – Gjykatat e brendshme kishin njohur që fletëpalosjet trajtonin çështje me interes publik dhe që kërkuesi lejohej të ndiqte qëllimet e tij politike edhe duke përdorur kritika të ekzagjeruara dhe polemike. Megjithatë, ato konstatuan që kërkuesi kishte krijuar përshtypjen e gabuar që abortet ishin kryer në mënyrë të paligjshme, për shkak se i gjithë formati i fletëpalosjes synonte të tërhiqte vëmendjen e lexuesit tek fjalia e parë me germa të theksuara, ndërsa shpjegimet e tjera ishin në germa më të vogla me synimin e fshehjes së përmbajtjes së saj. Për më tepër, ato konstatuan që kërkuesi kishte krijuar një ‘efekt fajësimi’ duke veçuar të dy mjekët, një efekt që përkeqësohej më tej nga referenca tek Holokausti. Në këndvështrimin e Gjykatës, deklarimi i kërkuesit që ishin kryer ‘aborte të paligjshme’ ishte i saktë nga këndvështrimi gjyqësor, pasi ligji i brendshëm bënte vetëm dallimin ndërmjet aborteve që konsideroheshin ‘të paligjshme’, por që përjashtoheshin nga përgjegjësia penale, dhe

aborteve që konsideroheshin të justifikuar dhe në këtë mënyrë “të ligjshme”. Teksti i atij deklarimi ishte gjithashtu i qartë në masë të mjaftueshme dhe i lehtë për tu lexuar nga lexuesi, edhe nga një këndvështrim i një personi të zakonshëm. Kështu, faktet e kësaj çështjeje duhej të dalloheshin nga ato që shërbenin si bazë për kërkesat e mëparshme të kërkuarit në Gjykatë, që kishin të bënin me fletëpalosjet dhe një bandlerolë që përdorte shprehjen “aborte të paligjshme” pa dhënë ndonjë shpjegim tjetër ligjor.\* Për më tepër, zgjedhja e kërkuarit për shpërndarjen e fletëpalosjeve në afërsi të klinikës kishte shtuar efektivitetin e kësaj fushate, që kontribuonte në një debat tepër të gjallë me interes publik. Për më tepër, megjithëse doli që mjekët, si pasojë e vëmendjes publike me efekt negativ, e kishin mbyllur klinikën ditore dhe kishin filluar një praktikë tjetër profesionale, nuk ishte e qartë nëse këtë zhvillimin e kishin shkaktuar aktivitetet e kërkuarit. Në lidhje me referencën tek holokausti, Gjykata nuk mund të binte dakord me interpretimin e gjykatave të brendshme që kërkuari i kishte krahasuar mjekët dhe aktivitetet e tyre profesionale me regjimin nazist. Në fakt, deklarimi i tij që vrasja e qenieve njerëzore në Aushwitz kishte qenë e paligjshme por ishte lejuar dhe nuk i ishte nënshtruar përgjegjësisë penale nën regjimin nazist, mund të kuptohej gjithashtu si një mënyrë e krijimit të një ndërgjegjësimi e nja fakti më të përgjithshëm që ligji mund të divergojë nga moraliteti. Megjithëse, Gjykata ishte në dijeni të nënkuptuar të deklarimit të kërkuarit të kërkuarit, që intensifikohej më tej nëpërmjet referencës në faqen e tij të referuar, ajo vuri re që kërkuari nuk e kishte krahasuar shprehimisht abortin me Holokaustin. Kështu, gjykata nuk ishte e bindur që ndalimi i shpërndarjes së fletëpalosjeve justifikohej me shkeljen e të drejtave të personalitetit të mjekëve vetëm për shkak të referencës tek holokausti.

**Përfundim:** shkelje (pesë me dy).

(b) *Urdhri për të mos përmendur hollësitë e kontaktit të mjekëve në listën online të “mjekëve të aborteve”* – Gjykatat e brendshme kishin konstatuar që fletëpalosja e kërkuarit dhe faqja e internetit i barazonin veprimet e mjekëve me Holokaustin dhe me vrasjet në masë, që nuk mbulohej nga liria e tij e shprehjes. Megjithatë, ato kufizoheshin në konstatimin që të njëjtët parime që ishin shtjelluar në lidhje me fletëpalosjen duhet të zbatohen edhe për faqen e internetit, pa shqyrtime të mëtejshme të rrethanave individuale dhe të kontekstit. Veçanërisht ato nuk bënin dallimin ndërmjet deklarimit të kërkuarit në fletëpalosje, që kishte një ndikim gjeografik të kufizuar, he deklarimeve të tij në internet, që mund të shpërndaheshin në të tërë botën. Po ashtu, ato nuk analizuan përmbajtjen e saktë, kontekstin e përgjithshëm dhe formatin specifik të faqes së internetit të kërkuarit, që rendisnin emrat e mjekëve, nevojën për të mbrojtur të dhënat sensitive, sjelljen e mëparshme të mjekëve, ndikimin e deklarimit të kërkuarit për palët e treta nëse ishte e mundur të nxitej agresion ose dhunën ndaj mjekëve. Doli që gjykatat e brendshme nuk kishin zbatuar standardet në pajtim me parimet procedurale të mishëruara në Nenin 10 të Konventës dhe nuk ishin bazuar në një vlerësim të pranueshëm të fakteve përkatëse.

**Përfundim:** shkelje (pesë me dy).

\* Shih vendimet në çështjet Annen kundër Gjermanisë të datës mars 2010 (2373/07 dhe 2396/07) dhe të datës 12 shkurt 2013 (55558/10).

Konstatimi i përgjegjësisë ndaj botuesve të nenit dhe fotografive që tregojnë ekzistencën e fëmijës së padëklaruar të monarkut: shkelje

**Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés** kundër Francës - 40454/07 Vendimi 10.11.2015 (GC)

**Faktet** – Në datën 3 maj 2005, gazeta britanike Daily Mail botoi një artikull që përmbante deklarime të Zj C. në lidhje me të birin e saj, duke pretenduar që babai i saj ishte princi sundimtar i Monakos. Neni i referohej një publikimi të fundit në Paris Match dhe tregonte elementët thelbësorë, duke përfshirë fotografitë, një prej të cilave tregonte Princin duke mbajtur fëmijën në dorë. Intervista me Ms C. dhe fotografët në fjalë u botuan gjithashtu në revistën javore gjermane Bunte të datës 4 maj 2005. Kërkuesit ishin përkatësisht: drejtori botues i revistës javore Paris Match dhe shoqëria që publikon revistën. Më 6 maj 2005, Paris Match publikoi një artikull në të cilin Ms C dha hollësi në lidhje me rrethanat kur kishte takuar Princin, takimet e tyre, marrëdhënien dhe ndjenjat e tyre intime, mënyrën se si Princi kishte reaguar ndaj lajmit për shtatzëninë e Zj C dhe qëndrimin e tij për takimin me fëmijën. Princi nisi çështje ndaj kërkuesve, duke kërkuar kompensim për shkeljen e privatësisë dhe shkeljen e së drejtës së tij për ruajtjen e imazhit të vet. Gjykatat franceze i pranuan kërkesën e tij duke i dhënë atij 50 000 Euro kompensim dëmi dhe duke urdhëruar që hollësitë e vendimit të publikoheshin në një të tretën e kapakut të parë të revistës. Në një vendim të datës 12 qershor 2014 (shih Shënimin informativ 175), një Dhomë e Gjykatës, duke votuar katër me tre, konkludoi që ka patur një shkelje të nenit 10. Më 13 tetor 2014, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të Qeverisë.

**Ligji** – Neni 10: Vendimi ndaj kërkuesve pati si pasojë ndërhyrjen tek e drejta e tyre për lirinë e shprehjes. Kjo ndërhyrje është parashikuar me ligj dhe kishte ndjekur një qëllim legjitim, që është mbrojtja e reputacionit të së drejtës së të tjerëve. Duhej të vendosej nëse ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

(a) *Kontributi në një debat për një çështje me interes të përgjithshëm* – interesi publik nuk mund të reduktohej në etjen e publikut për informacion në lidhje me jetën private të të tjerëve, ose në dëshirën e lexuesit për sensacion ose, ndonjëherë, për përgjimin e të tjerëve. Megjithatë, intervista me Zj C përmbante shumë hollësi në lidhje me jetën private të Princit dhe ndjenjat e tij të vërteta ose të supozuara që nuk lidheshin drejtpërdrejt me një debat me interes publik. Megjithatë, ishte e nevojshme qysh në fillim që të tregohej që megjithëse lindja është një ngjarje e një natyre intime, ajo nuk futej vetëm në sferën private të personave të përfshirë në të, por përfshihej edhe në

sferën private, meqenëse në parim shoqërohej nga një deklaram publik (dokumenti i gjendjes civile) dhe vendosjen e një marrëdhënieje ligjore prind-fëmijë. Kështu, interesi thjesht familjar dhe privat i përfaqësuar nga prejardhja e një personi plotësohej nga një aspekt publik, e shoqëruar me strukturën sociale dhe ligjore të lidhjes familjare. Një lajm në lidhje me një lindje nuk mund të konsiderohej në vetvete si deklaram ekskluzivisht i hollësive të jetës private të të tjerëve, që synojnë thjesht të kënaqin kuriozitetin e publikut. Përveç kësaj, në momentin real, kjo lindje e fëmijës nuk ka qenë pa implikime dinastike dhe financiare: mund të ngrihej çështja e legjitimitit nëpërmjet martesës, edhe nëse një rezultat i tillë dukej i pamundur. Vërtet që pasojat e lindjes në lidhje me trashëgiminë ishin përmendur në artikull. Informacioni i debatuar nuk ishte pa rëndësi politike dhe mund të kishte zgjuar interesin e publikut në lidhje me rregullat e trashëgimisë që ishin në fuqi në Principatë (që pengonin fëmijët e lindur jashtë martese të trashëgonin fronin). Po ashtu, qëndrimi i Princit, i cili dëshironte të mos e deklaronte atësinë dhe refuzoi ta pranonte atë publikisht, në një monarki të trashëgueshme, e ardhmja e së cilës lidhej së brendshme me ekzistencën e pasardhësve, mund të ishte një çështje me interes për publikun. Kjo ishte po ashtu e vërtetë në lidhje me sjelljen e tij kundrejt nënës së fëmijës dhe fëmijës vetë: ky informacion mund të hidhte dritë mbi personalitetin e Princit, veçanërisht në lidhje me mënyrën në të cilën ai i shihte dhe përmbushte detyrimet. Në këtë kontekst, ishte e rëndësishme të përsëritej roli simbolik i monarkisë së trashëgueshme, në të cilën personi i Princit dhe linja e tij e drejtpërdrejtë ishin gjithashtu përfaqësues të vazhdimësisë së Shtetit. Po ashtu, kontributi i shtypit në një debat me interes publik nuk mund të kufizohej thjesht në ngjarjet e tashme ose debatet e shkuara. Dihet që shtypi është një instrument i cili e shpërndan debatin tek çështjet me interes publik, por ka gjithashtu edhe rolin e tregimit dhe sjelljen e informacionit në vëmendje të publikut që është në gjendje të ngjallë një interes të tillë dhe fillimin e një debati brenda shoqërisë. Kështu, gjykatat e brendshme duhej ta kishin vlerësuar publikimin si një të tërë, me qëllim që të përcaktonin përmbajtjen e tij saktë, dhe jo të shqyrtonin konsideratat në lidhje me jetën private të Princit jashtë kontekstit. Megjithatë, ato kishin refuzuar të merrnin parasysh interesin që mund të kishte për publikun mesazhi qendror i atij artikulli dhe në vend të kësaj u përqendruan në hollësitë e marrëdhënies intime të çiftit. Në këtë mënyrë, ato i kishin hequr efektivitetin justifikimit të interesit publik të cilit i referoheshin kërkuesit.

- (b) *Sa i njohur ishte personi i interesuar dhe cili ishte subjekti i raportit?* – Gjykatat e brendshme duhej të kishin marrë parasysh ndikimin e mundshëm të statusit të Princit si Kreu i shtetit, dhe duhej të ishin përpjekur në atë kontekst të përcaktonin se cilët elementë i përkisnin rreptësisht sferës private dhe cilët futeshin në sferën publike. Por, megjithëse ato përsëritën që mund të bëhej një përjashtim për parimin e mbrojtjes së jetës private kurdoherë që faktet e deklaruara mund të ishin shkak për një debat për shkak të ndikimit të tyre duke patur parasysh statusin e funksionit të personit përkatës, ato nuk nxorën asnjë përfundim nga kjo konsideratë. Përveç kësaj, jeta private e Princit nuk ishte objekti i vetëm i artikullit, por ai merrej edhe me jetën



private të Zj C dhe të birit të saj. Zj C natyrisht që nuk ishte detyruar të heshte dhe ishte e lirë për të komunikuar në lidhje me elementet që i përkisnin jetës së saj private. Në këtë kuptim, nuk mund të injorohej që artikulli i debatuar ishte një mjet shprehjeje për të intervistuarën dhe të birin e saj. Kështu, intervista kishte të bënte edhe me interesa private konkurrues. Dihet që e drejta e shprehjes e Zj C për veten e saj dhe të birin nuk lidhej drejtpërdrejt me çështjen në fjalë; megjithatë, kombinimi i elementëve të jetës private të Zj C dhe të asaj të Princit duhej të merreshin parasysht në vlerësimin e mbrojtjes që i takonte atij.

- (c) Sjellja e mëparshme e personit në fjalë – Materiali në dosjen e çështjes nuk ishte i plotë për ti dhënë mundësi gjykatës të shqyrtonte sjelljen e mëparshme të Princit në lidhje me median.
- (d) *Mjetet me të cilat ishte marrë informacioni dhe vërtetësinë e tij* – Me një vendim që duhej të ishte personal, i qëllimshëm dhe i informuar, Zj C kishte kontaktuar vetë Paris Match. Vërtetësia e deklarimeve të saj në lidhje me atësinë e Princit nuk ishin kundërshtuar prej tij, dhe ai vetë e kishte pranuar publikisht menjëherë pas publikimit të artikullit të debatuar. Në lidhje me fotografitë që ilustronin intervistën, ato i ishin dhënë vullnetarisht dhe pa asnjë pagesë Paris Match. Ato nuk ishin bërë pa dijeninë e tij apo në rrethana që e tregonin atë keq.
- (e) *Përmbajtja, forma dhe pasojat e artikullit të debatuar* – Detyrat dhe përgjegjësitë e gazetarëve nënkuptonin që atyre u duhej të merrnin parasysht ndikimin e informacionit që ata synonin të publikonin. Veçanërisht ngjarje të veçanta gëzonin mbrojtje të veçantë sipas nenit 8 të Konventës dhe duhet ti bëjë gazetarët të tregonin maturi dhe kujdes në mbulimin e tyre. Toni i intervistës me Zj C dukej i matur dhe jo-sensacional. Deklarimet e saj ishin të dallueshme si citime dhe motivet e saj ishin të përcaktuara qartë për lexuesit. Po ashtu, lexuesit mund të dallonin qartësisht ndërmjet asaj që ishte faktike dhe ajo që kishte të bënte me perceptimin e ngjarjeve nga e intervistuarja, mendimet e saj ose ndjenjat e saj personale. Dihet që intervista ishte vendosur në një stil tregimtar e shoqëruar me efekte grafike dhe tituj që synonin të tërhiqnin vëmendjen e lexuesit dhe provokonin reagim. Megjithatë, ky prezantim rrëfimtar nuk e deformonte përmbajtjen e informacionit dhe nuk e prishte atë, por duhej të konsiderohej si transpozim apo ilustrim. Revista nuk mund të kritikohet për zmadhimin e përmasave të artikullit apo ta paraqiste atë në mënyrë më tërheqëse, me kusht që ajo nuk deformon informacionin e publikuar dhe në këtë mënyrë nuk mund të keq-orientonte lexuesin. Për më tepër, ndërsa nuk ka dyshime në këtë çështje që fotografitë përfshiheshin në sferën private të princit dhe ai nuk kishte dhënë pëlqimin për publikimin e tyre, lidhja e tyre me artikullin e debatuar ishte e sforcuar, artificiale dhe arbitrare. Publikimi i tyre nuk mund të justifikohet nga fakti që ato i kishin shtuar kredibilitet tregimit të ngjarjeve. Vërtet që Zj C nuk ka në dispozicion të saj asnjë provë tjetër që do ti mundësonte asaj argumentimin e rrëfimit. Për pasojë, megjithëse publikimi i këtyre fotografive kishte efektin e ekspozimit të jetës private të Princit në publik, ato përforconin rrëfimin e treguar në artikull. Së fundmi, në lidhje me pasojat e artikullit të debatuar, menjëherë pas publikimit të artikullit Princi njohu

publikisht atësinë e tij. Këto pasoja duhet të vihen në perspektivë, në dritën e artikujve që kishin dalë më parë në gazetat e huaja. Megjithatë, në këtë rast gjykatat e brendshme nuk dukej se vlerësuan në një kontekst më të gjerë pasojat e mbulimit nga media ndërkombëtare për ngjarjet e përshkruara në artikull. Kështu, ato nuk i kushtuan rëndësi faktit që fshehtësia në lidhje me atësinë e Princit ishte minuar tashmë nga artikujt e mëparshëm në mediat e tjera.

- (f) *Ashpërsia e dënimit* – Dënimi i dhënë për shoqërinë kërkuese, që është 50 000 Euro zhdëmtim dhe urdhërimi për të publikuar një deklaram me hollësitë e vendimit, nuk mund të konsiderohej e parëndësishme. Nën dritën e këtyre konsideratave, argumentet e dhëna në lidhje me mbrojtjen e jetës private të princit dhe të së drejtës së tij për të kontrolluar imazhin e tij, megjithëse me vend, nuk mund të konsiderohen si të rëndësishme për të justifikuar ndërhyrjen në fjalë.

**Përfundim:** shkelje (unanimisht)

Neni 41: pretendim në lidhje me dëmin financiar rrëzohet.

## Neni 11

Sanksionet penale për fermerët që bllokojnë trafikun në rrugët kryesore për dy ditë: *nuk ka shkelje*

***Kudrevičius dhe të Tjerë kundër Lituanisë*** - 37553/05 Vendimi 15.10.2015 (GC)

**Fakte** – Fermerët kërkues morën autorizim për të organizuar një protestë paqësore për të tërhequr vëmendjen për mosveprimin e pretenduar nga ana e Qeverisë në përgjigje të problemeve të sektorit bujqësor. Fillimisht demonstrimet ishin paqësore sipas autorizimeve përkatëse. Megjithatë, negociatat me qeverinë nuk përparuan. Me qëllim që të ushtrohej presion mbi Qeverinë, kërkuesit shkuan tej autorizimeve dhe bllokuan tre autostradat kryesore për dy ditë, duke shkaktuar bllokime të konsiderueshme. Bllokimi përfundoi pasi u përmbushën kërkesat e tyre. Kërkuesit më vonë u dënuan për “prishje qetësie” dhe u dënuan me 60 ditë burgim, pezulluar me kusht me një vit. Ata u urdhëruan gjithashtu të mos largoheshin nga vendbanimi i tyre për më shumë se shtatë ditë pa pëlqimin paraprak të autoriteteve. Në një vendim të datës 26 nëntor 2013, edhe Dhoma e Gjykatës konsideroi, me katër vota kundrejt tre, që ka patur një shkelje të nenit 11 të Konventës (shih Shënimin Informativ 168). Më 14 prill 2014, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesën e Qeverisë.

**Ligji** – Neni 11

- (a) *Zbatueshmëria* – Dënimi i kërkuesve nuk bazohej në ndonjë përfshirje apo nxitje dhune, por në shkeljen e rendit publik që rezultoi nga bllokimi i rrugës. Pengimi i trafikut nuk ishte një efekt anësor i një takimi të zhvilluar në një vend publik, por rezultati i një veprimi të qëllimshëm nga fermerët. Megjithatë, sjellja konkrete që

pengonte qëllimisht trafikun dhe zhvillimin normal të jetës me qëllim që të pengoheshin në masë të konsiderueshme aktivitetet e zhvilluara nga të tjerët nuk ishte në thelbin e lirisë së tubimit të mbrojtur nga neni 11, që mund të ketë implikime për çdo vlerësim të ‘domosdoshmërisë’ që kryhet sipas paragrafit të dytë të asaj dispozite. Në të njëjtën kohë, sjella e kërkuarve nuk ishte e një natyre të tillë dhe e një shkalle të tillë që duhet larguar pjesëmarrja e tyre në demonstratë nga objekti i mbrojtjes së të drejtës së lirisë së tubimit paqësor. Nuk ka patur ndonjë tregues që ata kishin tronditur themelet e një shoqërie demokratike. Kështu Neni 11 është i zbatueshëm.

- (b) *Themeli* – Dënimi i kërkuarve solli për pasojë ndërhyrjen tek e drejta e tyre e lirisë së tubimit paqësor. Ndërhyrja kishte bazë ligjore në të drejtën e brendshme. Interpretimi i gjykatave të brendshme i dispozitave përkatëse të kodit Penal nuk ishte as arbitrar dhe as i paparashikueshëm. Lejet për zhvillimin e tubimeve paqësore kishin një paralajmërim në lidhje me përgjegjësinë e mundshme të organizatorëve. Për më tepër, duhej të ishte e qartë për kërkuarët që shpërfillja e urdhrave të ligjshëm dhe të qartë të policisë për të larguar barrikadat në rrugë mund të ishte shkak për përgjegjshmërinë e tyre. Ndërhyrja e kundërshtuar ishte, pra, ‘e parashikuar me ligj’ dhe ndiqte qëllimet e ligjshme të ‘parandalimit të prishjes së rendit’ dhe të ‘mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve’. Transferimi i demonstrimeve nga zonat e autorizuara tek autostradat ishte një shkelje e qartë e kushteve të parashikuara në leje. Ky veprim ishte ndërmarrë pa njoftuar paraprakisht autoritetet dhe pa u kërkuar atyre të ndryshonin kushtet e lejeve. Kërkuarët nuk mund të mos ishin në padijeni të këtyre kërkesave. Për më tepër, veprimi i tyre nuk justifikohej nga nevoja për një përgjigje të menjëhershme ndaj një ngjarjeje faktike. Gjykata nuk ka shkak për të vënë në diskutim vlerësimin e gjykatave të brendshme që fermerët kanë patur në dispozicionin e tyre mjetet alternative dhe të ligjshme për të mbrojtur interesat e tyre, si mundësia për të paraqitur ankime në gjykatat administrative. Për sa i takon faktit të vendosjes së barrikadave në rrugë për të ushtruar presion mbi qeverinë për të pranuar kërkesat e fermerëve, ky tipar e dallonte çështjen konkrete nga ato në të cilat Gjykata kishte konstatuar që demonstratat mund të kenë shkakuar një nivel të lartë pengimi për jetën e përditshme, duke përfshirë pengimin e trafikut. Në rastet kur demonstruesit u përpoqën të pengonin ose të ndryshonin ushtrimin e një aktiviteti të zhvilluar nga të tjerët, Gjykata nxori përfundimin që caktimi i sanksioneve ishte një reagim proporcional me qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. I njëjti përfundim mund të nxirret edhe në rastin konkret, pasi veprimet e demonstruesve nuk ishin drejtuar drejtpërdrejt tek një aktivitet tjetër i cili nuk kishte lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e protestës së tyre. Siç mund të shihet nga praktika gjyqësore e Gjykatës, pengimi i konsiderueshëm dhe i qëllimshëm nga demonstruesit i jetës së përditshme dhe i aktiviteteve që zhvillohen në mënyrë të ligjshme nga të tjerët, në një shkallë tepër më të lartë nga ai që shkaktohet nga ushtrimi normal i së drejtës së tubimit paqësor në një vend publik, mund të konsiderohet ‘veprim i dënueshëm’ dhe në këtë mënyrë mund të justifikojë caktimin e penaliteteve, edhe të

një natyre penale. Megjithëse kërkuesit nuk kishin kryer veprime dhune ose nuk kishin nxitur të tjerët për tu angazhuar në veprime të tilla, pengimi pothuaj i plotë i tre autostradave kryesore është një shpërfillje e hapur e urdhrave policore dhe e nevojave dhe të drejtave të përdoruesve të rrugës përbënte një sjellje që mund të përshkruhet si ‘e dënueshme’. Duke patur parasysh marzhin e vlerësimit që jepet në këto rrethana, Shteti i paditur kishte qartësisht të drejtë të mendonte që interesat e ruajtjes së rendit publik mbizotëronte mbi ato të kërkuesve të cilët i kthehen bllokimit të rrugës si mjet për fermerët për të arritur një zgjidhje në negociatat e tyre me Qeverinë. Në lidhje me sjelljen e autoriteteve, policia ishte mjaftuar me urdhërimin e kërkesave që të hiqnin barrikadat dhe me paralajmërimin e tyre për përgjegjësi të mundshme. Ajo zgjodhi për të mos e shpërndarë grumbullimin edhe kur kërkuesit refuzuan t’u bindeshin urdhrave të tyre të ligjshëm. Me intensifikimit e tensioneve ndërmjet fermerëve dhe shoferëve të kamionëve, policia nxiti palët në konflikt të qetësoshin me qëllim që të mënjanonin konfrontimet e rënda. Megjithë pengimin e konsiderueshëm të shkaktuar nga sjella e kërkuesve, autoritetet treguan një shkallë tolerance. Ato u përpoqën që të balanconin interesat e demonstruesve me ato të përdoruesve të autostradës, me qëllim që të siguronin sjelljen paqësore të tubimit dhe sigurinë e qytetarëve, duke përmbushur këtu detyrimin pozitiv që ato eventualisht menduan se e kishin. Në lidhje me sanksionet e vendosur mbi kërkuesit, dënimi i dhënë ishte një dënim i butë me 60 ditë burgim, pezullimi i të cilit ishte pezulluar me kusht për një vit. Kërkuesit nuk ishin dënuar me pagesën e gjobave dhe e vetmja pasojë e dënimit të tyre ishte detyrimi, për një vit, për të marrë autorizim nëse ata donin të largoheshin nga vendbanimi i tyre për më shumë se shtatë ditë. Një shqetësim i tillë nuk ishte jo-proporcional nëse krahasohej me prishjen e rëndë të rendit publik të provokuar nga kërkuesit. Së fundmi, meqenëse nuk ka patur qëndrim të unifikuar ndërmjet Shteteve Anëtare në lidhje me kualifikimin ligjor – si kundërvajtje penale apo administrative – në lidhje me pengimin e trafikut në një autostradë publike, autoritetet e brendshme nuk i kishin tejkaluar limitet e marzhit të tyre të gjerë të vlerësimit duke i bërë kërkuesit penalisht përgjegjës për sjelljen e tyre. Fakti që individë të tjerë mund të kenë marrë trajnim më të butë nuk nënkupton domosdoshmërisht që sanksionet e caktuara mbi kërkuesit kishin qenë jo-proporcionale. Në tërësi, autoritetet e brendshme kishin gjetur një balancë të drejtë ndërmjet qëllimeve legjitime të ‘parandalimit të prishjes së qetësisë’ dhe ‘mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve’, nga njëra anë dhe kërkesës së lirisë së tubimit nga ana tjetër, dhe bazuan vendimet e tyre në një vlerësim të pranueshëm të fakteve dhe mbi shkaqe që ishin relevante dhe të mjaftueshëm. Nuk ishte e nevojshme që Gjykata të trajtonte argumentet e ngritura nga palët me qëllim që të përcaktojë nëse masat e vendosura nga autoritetet mund të ishin justifikuar nën dritën e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian (GJDBE). 1 Roli i GJDBE-së ishte të përcaktonte nëse Shtetet Anëtare të BE-së kishin përmbushur detyrimet e tyre për të garantuar lëvizjen e lirë, ndërsa detyra e Gjykatës në këtë rast ishte të përcaktonte nëse ka patur ndonjë shkelje të së drejtës së kërkuesve për lirinë e tubimit.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (unanimisht).

## Neni 1 i Protokollit Nr 1

Gëzimi paqësor i sendeve në zotërim

Avokati gjobitet për shkak se refuzoi të angazhohej si mbrojtës kryesisht: *nuk ka shkelje*

**Konstantin Stefanov kundër Bullgarisë** - 35399/05 Vendimi 27.10.2015 (Seksioni IV)

**Faktet** – Në vitin 2005 kërkuesi, me profesion avokat, u caktua nga një gjykatë rrethi *ex officio* si mbrojtës i një të pandehuri në një gjykim penal. Në seancën e parë kërkuesi deklaroi që ai do ta përfaqësonte të pandehurin vetëm nëse gjykata e brendshme do ta caktonte shpërblimin e tij në nivelin minimal ligjor ose më lart. Ndërsa gjyqtari kryesues e refuzoi, kërkuesi hoqi dorë nga përfaqësimi i të pandehurit dhe u largua nga salla e gjyqit. Si pasojë, ai u dënua me një shumë të barabartë me 260 Euro. Ankimi i tij u rrëzua përfundimisht.

**Ligji** – Neni 1 i Protokollit nr. 1: Gjoha përbënte një ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit për gëzimin paqësor të sendeve në zotërim të tij. Në lidhje me ligshmërinë e ndërhyrjes, dispozitat ligjore të brendshme ishin kontradiktore si në lidhje me momentin kur duhej të caktoheshin tarifat ligjore kryesisht nga gjykatat ashtu edhe në lidhje me shumën e tyre. Megjithatë, Gjykata vuri re që gjykata e brendshme i kishte vënë gjobë kërkuesit mbi bazën e një dispozite të kodit të Procedurës Penale, që në hierarkinë e burimeve ligjore të brendshme mbizotëronte mbi dispozitat e referuara nga kërkuesi. Duke ditur që kërkuesi ishte avokat, ky parim bazë dhe përmbajtja si dhe kuptimi i çdo dispozite të veçantë të kodit duhej të ishte mjaft e qartë për të dhe pasojat e zbatimit të tyre të parashikueshme. Për më tepër, çdo mosmarrëveshje në lidhje me shpërblimin e kërkuesit nuk duhej të kishte përparësi kundrejt zhvillimit të rregullit të procesit gjyqësor, që nga ana tjetër nuk duhej të ishte forumi ku duhej të zgjidhej kjo mosmarrëveshje. Gjykata konstatoi që kërkuesi kishte marrë gjobë mbi bazën e një dispozite të ditur, të qartë dhe të parashikueshme që ndiqte një qëllim të ligjshëm të sigurimit të operimit normal të sistemit të drejtësisë. Nëse u gjet një ‘balancë e drejtë’ ndërmjet interesit të përgjithshëm dhe mbrojtjes së të drejtave të kërkuesit, Gjykata fillimisht vuri re që shtyrja e seancës pa një shkak të vlefshëm përfaqësonte një pengesë për funksionimin normal të sistemit të drejtësisë. Shteti i paditur gëzonte një marzh të gjerë vlerësimi për të vendosur se si mund të dënohej kjo sjellje. Më kryesorja është që kërkuesi kishte në dispozicion të vet një garanci procedurale nëpërmjet ët cilës mund të kundërshtonte dënimin dhe ai e bëri këtë. Nuk ka asgjë që të tregojë që procesi vendimmarrjes që rezultoi në gjobën e ankimuar kishte qenë i padrejtë ose arbitrar. Së fundmi, megjithë se shuma e gjobës ishte maksimumi që mund të vendosej sipas dispozitës ligjore përkatës, ajo nuk ishte ndaluese, represive ose jo-proporcionale. Së fundmi, kjo situatë duhej të dallohej nga rastet që kishin të bënin me të drejtën e avokatëve për tu shprehur lirisht në cilësinë e tyre si avokatë mbrojtës, që janë trajtuar nga këndvështrimi i lirisë së shprehjes. \* Në këto rrethana është vendosur një balancë e drejtë ndërmjet interesit të përgjithshëm dhe respektimit të së drejtës së pronës së kërkuesit. Ndërhyrja nuk kishte vendosur një barrë të tepërt mbi kërkuesin.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (unanimisht).

\* Shih, për shembull, Nikula kundër Finlandës, 31611/96, 21 mars 2002, Shënimi Informativ 40; dhe Morice kundër Francës (GC), 9369/10, 23 prill 2015, Shënimi Informativ 184.

Konfiskimi i mjetit të transportit të përdorur për transportimin e drogës: shkelje

**Ûnsped Paket Servisi SaN. Ve TiC. A.Ş. kundër Bullgarisë** - 3503/08 Vendimi 13.10.2015 (Seksioni IV)

**Fakte** – Në vitin 2007, një kamion që i përkiste kërkuesit, një shoqëri turke që kryente shërbime logjistike, u ndalua për inspektim në një pikë doganore. U zbulua drogë dhe kjo u sekuestrua dhe në ngarkim të shoferit nisi çështja penale. Kamioni u sekuestrua si provë materiale. Shoferi i kamionit më vonë bëri një marrëveshje me prokurorin, që përfshinte një dënim me heqje lirie prej një viti e gjysmë për shoferin dhe humbjen e kamionit. Shoqëria kërkuese nuk ishte në gjendje të merrte pjesë në gjykimin penal ndaj shoferit, por i kërkoi gjykatës penale për të mos konfiskuar kamionin, që ishte me një vlerë tre herë më shumë se vlera e drogës dhe kështu nuk mund të konfiskohej sipas ligjit të brendshëm. Megjithatë, gjykata penale konfirmoi marrëveshjen në procedimin penale në një vendim i cili nuk mund të ankimohej dhe u bë i ekzekutueshëm në të njëjtën ditë. Padia e shoqërisë kërkuese ndaj shoferit për të rikuperuar vlerën e kamionit ishte e pasuksesshme pasi ai nuk kishte sende pasurore.

**Ligji** – Neni 1 i Protokollit nr. 1: Konfiskimi i kamionit përfaqësonte një ndërhyrje në të drejtat pasurore të shoqërisë kërkuese. Ndërhyrja bazohej në dispozitat përkatëse të ligjit të brendshëm, të cilat ishin të njohura, të sakta dhe të parashikueshme në masën e mjaftueshme. Konfiskimi ndiqte qëllimin legjitim të luftës kundër trafikimit të paligjshëm të drogës. Megjithatë, gjykatat e brendshme nuk kishin shqyrtuar ligjshmërinë e konfiskimit sipas ligjit të brendshëm dhe, veçanërisht, nëse vlera e automjetit kalonte në një masë të madhe atë të drogës së trafikuar. Megjithë mungesën e provave të ditur ose që duhej të dihej nga shoqëria kërkuese, ato nuk kishin shqyrtuar sjelljen e saj si pronare të automjetit. Vërtet që nuk kishte mundësi shqyrtimi për çështjen e pronarit sipas ligjit të brendshëm. Por mungesa e një analize të tillë nuk kishte bërë të mundur një balancë të drejtë ndërmjet interesave të ndryshëm të përfshirë. Humbja do të kishte qenë në pajtim me kërkesat e Konventës nëse do të ishte kryer në pajtim me një procedurë që ofronte garanci të përshtatshme kundrejt arbitraritetit. Në këtë çështje, nuk ka patur procedurë të brendshme për shoqërinë kërkuese që kjo ta ngrinte çështjen tek autoritetet përkatëse. Shteti nuk mund të lirohet nga përgjegjësia sipas Konventës për ofrimin e një procedure të tillë duke i kërkuar një personi që nuk është gjykuar për një vepër penale që ka sjellë si rezultat konfiskimin të bënë rikuperimin e pronës së tij nga një palë e tretë. Kështu

shoqëria kërkuese ka marrë një barrë individuale dhe të tepërt që do të ishte e ligjshme vetëm nëse ajo do të kishte mundësinë për të kundërshtuar efektisht humbjen e pronës së saj që ka rrjedhur nga një procedim penal në të cilin ajo nuk ka qenë palë. Megjithatë, ajo nuk e ka patur një mundësi të tillë dhe kështu balanca e drejtë që duhej të gjendej ndërmjet mbrojtjes të së drejtës së kërkuesit për pronën dhe kërkesave të interesit të përgjithshëm ishte prishur.

**Përfundim:** shkelje (unanimisht).

### Neni 3 i Protokollit Nr 1

Mungesa e shqyrtimit të efektshëm të ankesave të kërkuesve në lidhje me parregullsitë në zgjedhje: shkelje

#### **Gahramanli dhe të Tjerë kundër Azerbajxhanit** - 36503/11 Vendimi 8.10.2015 (Seksioni I)

**Fakte** – Kërkuesit ishin kandidatë të palëve opozitare në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010. Ata u ankuan në lidhje me ndërhyrjen e paligjshme në procesin elektoral nga anëtarët e komisionit elektoral, ndikim të parregullt mbi zgjedhjen e votuesve, pengim të vëzhguesve dhe hedhje votash në kutitë e votimit. Ankesat e tyre u rrëzuan nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe gjykatat e brendshme si të pabazuara.

**Ligji** – Neni 3 i Protokollit nr. 1: Kërkuesit kishin ngritur një pretendim të konsiderueshëm dhe të argumentueshëm duke kallëzuar një dështim të dukshëm për të mbajtur zgjedhje të lira dhe të ndershme në zonën e tyre zgjedhore. Kështu, parregullsitë e pretenduara, nëse konfirmohen rregullisht që të kenë ndodhur, ishin potencialisht në gjendje për të prishur natyrën demokratike të zgjedhjeve. Pretendimet e kërkuesve bazoheshin në deklaratimet e vëzhguesve. Raporti Final i Misionit të Vëzhgimit të OSBE/ODHIR\* mbi zgjedhjet Parlamentare të datës 7 nëntor 2010, i cili bënte një përshkrim të përgjithshëm të problemeve më të shpeshta të identifikuara gjatë procesit zgjedhur, në mënyrë të tërthortë përforconte pretendimet e kërkuesve. Shteti i paditur ishte nën detyrimin të miratonte një sistem për të ndërmarrë një shqyrtim të efektshëm të ankimeve të kërkuesve. Megjithatë, vlerësimi i provave të kryer nga KQZ-ja nuk ishte i përshtatshëm apo i plotë. Së pari, megjithë kërkesat e Kodit Elektoral, prania e kërkuesve në seancën e KQZ-së nuk ishte garantuar, duke u hequr atyre mundësinë për të argumentuar pozicionin e tyre. KQZ-ja mund të mos ketë mbajtur një seancë të rregullt, pasi praktikisht miratoi një opinion të një grupi ekspertësh pa e debatuar, pa diskutuar lëndën e ankesave. KQZ-ja nuk kishte shqyrtuar si duhet deklaratimet e vëzhguesve në lidhje me parregullsitë e pretenduara që ishin paraqitur nga kërkuesit si provë në mbështetje të ankesës së tyre. Asnjë nga vëzhguesit nuk ishte thirrur të intervistohet dhe asnjë hetim i mëtejshëm nuk ishte bërë në lidhje me pretendimet e tyre. KQZ-ja, nga ana tjetër, në terma të përgjithshme iu referua deklaratimeve të marra nga disa vëzhgues të tjerë që mohanin çdo parregullsi, pa ua treguar ato kërkuesve dhe pa ndonjë shpjegim bindës në lidhje me

shkaqet pse këto deklarime kishin marrë më shumë peshë nga deklaratimet e vëzhguesve të paraqitura nga kërkuesit. Gjykatat e brendshme nuk i kishin korrigjuar këto mangësi dhe lanë në fuqi konstatimet e KQZ-së, pa zhvilluar një shqyrtim të pavarur të argumenteve të ngritur ose pa trajtuar ankimet e kërkuesve në lidhje me mangësitë në procedurën para KQZ-së. Për më tepër, gjykata Kushtetuese kishte konfirmuar paraprakisht rezultatet e zgjedhjeve në të gjithë vendin si të ligjshme, ndërsa kërkuesit ishin në procesin e kërimit të zgjidhjes për shkeljet e ngritura të të drejtave të tyre zgjedhore në zonën e tyre zgjedhore nëpërmjet sistemit ekzistues të ankimit, dhe ndërsa afati i dhënë me ligj për paraqitjen e ankimit në Gjykatën e Lartë nuk kishte përfunduar akoma. Kështu Gjykata e Lartë nuk ishte në gjendje të merrte ndonjë vendim në lidhje me rezultatet e zgjedhjeve në zonën zgjedhore të kërkuesve. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese kishte përjashtuar mjetet e ankimit në dispozicion të kërkuesve nga çdo mundësi suksesi dhe e kishte bërë të gjithë sistemin e shqyrtimit të ankimeve në lidhje me zgjedhjet individuale të paefektshtë dhe iluzor në rastin e kërkuesve. Sjellja e komisioneve zgjedhore dhe gjykatave dhe vendimet e tyre përkatëse kishin treguar dukshëm mungesë të ndonjë shqetësimi të vërtetë për të luftuar rastet e pretenduara të mashtrimit elektorale dhe mbrojtur të drejtat e kërkuesve për të kandiduar në zgjedhje. Për më tepër, raporti i anëtarëve të partive qeveritare në komisionet elektorale, duke përfshirë KQZ-në, ishte tepër i lartë. Ky ishte një nga faktorët sistemikë që kontribuon në mungesën e efektivitetit të shqyrtimit nga KQZ-ja të ankesës së kërkuesve në lidhje me zgjedhjet. I takonte Komitetit të Ministrave të mbikëqyrte, nën dritën e informacionit të dhënë nga Shteti i paditur, ekzekutimin e vendimit të Gjykatës dhe të ndjekë zbatimin e masave të përgjithshme dhe evoluimin e sistemit të administratës elektorale në pajtim me Konventën. Një përpjekje nga Shteti i paditur duke parashikuar një reformë të përbërjes strukturore të komisioneve elektorale duhet të inkurajohet me synimin e përmirësimit të efektivitetit të shqyrtimit të ankimeve individuale në lidhje me zgjedhjet.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: 10,000 EUR për çdo kërkues në lidhje me dëmin jo-financiar; pretendimet në lidhje me dëmin financiar rrëzohen.

\* Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë / Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut



## II. AKTGJYKIME KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

1. **Gerovska – Popçevska kundër Republikës së Maqedonisë**, A numër. Ankesa nr. 48783/07, aktgjykimi i datës 07.01.2016

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) më datën 07.01.2016 solli aktgjykimin në lidhje me rastin Gerovska – Popçevska kundër Republikës së Maqedonisë.

Aplikuesja është ankuar se ka qenë e shkarkuar nga funksioni i gjykatësit gjatë procedurës gjyqësore e cila nuk i ka përmbushur standardet që pasojnë nga neni 6 i Konventës, përkatësisht ajo ka theksuar se rasti i saj nuk është shqyrtuar nga ana e “tribunalit të pavarur dhe të paanshëm”.

### FAKTET E RASTIT

**Procedura gjyqësore gjatë së cilës ankuesja është shkarkuar për shkak të ushtrimit jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësorë**

Më 3 prill të vitit 2006, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, kryetar i të cilit në atë kohë ka qenë personi M.M., i cili më vonë, përkatësisht gjatë muajit korrik të vitit 2006 është emëruar si ministër i drejtësisë, deri te Këshilli gjyqësorë ka parashtruar propozimin për revidim të lëndës civile e cila ka qenë në lidhje me dëmshpërblimin kundër shtetit, në të cilën procedurë ankuesja ka sjell aktgjykimin e shkallës së parë në veti të kryetarit të këshillit tre antarësh.

Më 19 prill të vitit 2006, Seksioni civil pranë Gjykatës supreme ka mbajtur seancën gjyqësore dhe ka përpiluar mendimin në të cilin ka sjell konkluzionin se ekziston baza për iniciimin e procedurës për ushtrim jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësorë nga ana e ankueses në lidhje me lëndën e lartëpërmendur civile. Në bazë të procesverbalit të seancës gjyqësore, është kërkuar mendimi nga gjykatësi D.I., i cili në atë kohë ka qenë kryetar i Gjykatës supreme.

Më 26 prill të vitit 2006, Këshilli gjyqësorë nga Seanca e përgjithshme e Gjykatës supreme ka kërkuar që të përpilohet raport në lidhje me çështjen se vallë është i arsyeshëm shkarkimi i ankueses nga funksioni i gjykatësit. Po në të njëjtën datë, Këshilli gjyqësorë ka iniciuar procedurën kundër ankueses, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale në lëndën e lartëpërmendur civile. Këshilli gjyqësorë është thirrur në kërkesën e parashtruar nga Komisioni shtetërorë për parandalim të korrupsionit, duke u mbështetur, mes tjerash edhe në mendimin e dhënë nga Seksioni civil pranë Gjykatës supreme.

Më 25 dhjetor të vitit 2006, gjatë seancës së përgjithshme të Gjykatës supreme, me të cilën ka kryesuar gjykatësi D.I., është përpiluar mendimi lidhur me rastin e ankueses. Në këtë mendim ka qëndruar nënshkrimi i gjykatësit D.I., dhe mes tjerash është theksuar se seanca e përgjithshme e Gjykatës supreme njëzëri ka përkrahur mendimin e Seksionit civil dhe ka konstatuar se ekziston baza për shkarkimin e ankueses nga funksioni i gjykatësit.

Më 14 mars të vitit 2007, në seancën e përgjithshme të Këshillit gjyqësorë, në të cilën kanë marrë pjesë tetë nga gjykatësit të cilët kanë qenë të zgjedhur nga kolegët e tyre, si dhe ministri i drejtësisë i asaj periudhe kohore dhe gjykatësi D.I., të cilët sipas funksionit që kanë ushtruar kanë qenë anëtarë të Këshillit gjyqësorë. Lartpërmendurit e kanë shkarkuar ankuesen nga funksioni i gjykatësit për shkak të ushtrimit jo profesional dhe të pa ndërgjegjshëm të funksionit. Këshilli gjyqësorë, ka konstatuar se ankuesja gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale dhe procedurale gjatë lëndës së lartërmendur civile. Vendimi për shkarkim është thirrur në kërkesën e dorëzuar nga ana e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit dhe i njëjti është bazuar edhe në dëshmitë e sajura gjatë debatit para Komisionit, duke i përfshirë edhe mendimet e Seksionit civil dhe mendimet e sajura nga seanca e përgjithshme e Gjykatës supreme.

Ankuesja e ka kontestuar vendimin para instancës së shkallës së dytë, përkatësisht para Këshillit për vendosje në lidhje me ankesat, i cili është formuar në suaza të Gjykatës supreme, por më 8 maj të vitit 2007, kjo ankesë ka qenë e refuzuar dhe në këtë rast është konfirmuar vendimi i sjell nga ana e Këshillit gjyqësorë.

### **Procedura para Gjykatës kushtetuese**

Më 19 dhjetor të vitit 2007, Gjykata kushtetuese e ka refuzuar ankesën kushtetuese në të cilën ankuesja ka theksuar se shkarkimi i saj ka shkelur lirinë e saj të ndërgjegjes, lirinë e mendimit dhe lirinë e shprehjes dhe prononcimit publik. Në lidhje me shkarkimin, Gjykata kushtetuese ka konstatuar se nuk është kompetente që ta rishqyrtoj ligjshmërinë e vendimit të sjell nga Këshilli gjyqësorë. Për sa i përket faktit se vallë shkarkimi i ankueses ka pasur ndikime mbi lirinë e shprehjes së saj, gjykata ka sajuar konkludimin se duhet të bëhen dallime në mes ushtrimit të funksionit të gjykatësit dhe lirisë konkrete. Gjykata kushtetuese ka vendosur se funksioni i gjykatësit përfshfin edhe të drejtën dhe detyrën që të gjykohet në pajtim me ligjin dhe se kjo e drejtë dhe detyrë nuk bën pjesë në të drejtat dhe liritë për të cilat ajo është kompetente që të vendos, sipas Kushtetutës.

### **ARSYETIMI I GJEDNJ**

Sipas Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, paanshmëria nënkupton mungesën e paragjytimeve ose anshmërisë. Duke pasur parasysh faktin e praktikës gjyqësore, GJEDNJ paanshmërinë e përcakton me:

- testin e subjektivitetit, ku duhet të merret parasysh fakti i bindjes personale dhe i sjelljes së një gjykatësi të caktuar, përkatësisht vallë gjykatësi ka manifestuar çfarëdo paragjytime personale ose anshmëri për rastin konkret; dhe

- testin e objektivitetit, përkatësisht me përcaktimin se vallë vetë tribunali dhe përbërja e tij, kanë ofruar garanca të mjaftueshme që të përjashtohet çfarëdo dyshim i arsyeshëm në lidhje me paanshmërinë e tij.

Siç u theksua më lartë, Seksioni civil pranë Gjykatës supreme ka konstatuar se ekzistojnë baza për përcaktimin e ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësorë nga ana e ankueses, dhe në ndërkohë gjykatësi D.I. ka qenë anëtarë i Seksionit civil i cili ka miratuar këtë mendim. Më pas, gjatë seancës së përgjithshme të Gjykatës supreme, është votuar për mendimin me të cilin është konstatuar se ekzistojnë baza për shkarkimin e ankueses, për shkak të ushtrimit jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjykatësit, kurse gjykatësi D.I. ka kryesuar me seancën e përgjithshme të kësaj gjykate dhe e ka nënshkruar këtë mendim.

Në rrethana të tilla, GJEDNJ ka konstatuar se ankuesja ka pasur baza legjitime të frikës se gjykatësi D.I., tani më ka qenë personalisht i bindur se ajo duhet të shkarkohet nga funksioni gjyqësorë dhe ka sajuar konkluzionin se pjesëmarrja e mëtutjeshme e tij në procedurën e kontestuar për përcaktim të ushtrimit jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësorë, sipas Këshillit gjyqësorë nuk është në pajtim me kërkesën e paanshmërisë, në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 të Konventës. Njëkohësisht GJEDNJ konsideron se pjesëmarrja e ministrit të drejtësisë në suaza të Këshillit gjyqësorë, si anëtarë i pushtetit ekzekutiv, ka cenuar pavarësinë e tij në rastin konkret të shqyrtuar.

*Duke i pasur parasysh faktet e lartëpërmendura, GJEDNJ ka sajuar konkludimin se Këshilli gjyqësor i cili ka gjykuar në rastin e ankueses “nuk ka qenë tribinal i pavarur dhe i paanshëm” në pajtim me nenin 6, paragrafi 1 të Konventës dhe për këtë arsye gjykata ka konstatuar se ekzistojnë shkelje të këtij neni.*

## **DËMSPËRBLIMI JURIDIK OSE KOMPENSIMI I DËMIT**

GJEDNJ ka vendosur se shteti duhet ti paguaj aplikueses shumën prej 4.000 euro si dëmshpërblim jo material dhe shumën prej 900 euro për shpenzimet për përfaqësim para GJEDNJ.

### **2. *Jakshovski dhe Trifunovski kundër Republikës së Maqedonisë*, ankesa numër 56381/09 dhe numër 58738/09, aktgjykimi i datës 07.01.2016**

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) më datën 07.01.2016 solli aktgjykimin në lidhje me rastin Jakshovski dhe Trifunovski kundër Republikës së Maqedonisë.

Ankuesit mes tjerave, janë ankuar se kanë qenë të shkarkuar nga funksioni gjyqësorë në procedurën e cila nuk i ka përmbushur standardet e nenit 6 të Konventës. Më saktë, ata kanë pohuar se rastet e tyre nuk janë shqyrtuar nga ana e “tribunalit të pavarur dhe të paanshëm”.

## **FAKTET E RASTIT**

### **Shkarkimi i ankuesit të parë nga funksioni gjyqësorë (ankesa numër 56381/09)**

Sipas fakteve të shpalosura nga juristi, të cilat më vonë të njëjtat i ka tërhequr edhe nga hetimi i zbatuar preliminarë, V.V., i cili ka qenë anëtarë i Këshillit gjyqësorë, ka kërkuar nga Këshilli gjyqësor që të inicioj procedurën gjyqësore në lidhje me ankuesin e parë për ushtrim jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësorë.

Më 4 qershor të vitit 2008, Këshilli gjyqësor ka formuar Komisionin për përcaktimin e ushtrimit jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësorë.

Në bazë të kërkesës së V.V. dhe raportit të Komisionit në lidhje me atë se vallë kërkesa është e qëndrueshme, më 3 tetor të vitit 2008, gjatë seancës së përgjithshme të Këshillit gjyqësor është iniciuar procedura në lidhje me ankuesin e parë për shkak të ushtrimit jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësorë. Pas shqyrtimit të dëshmive të cilat janë ofruar nga ana e ankueses dhe nga ana e V.V., më 1 dhjetor Komisioni për përcaktim të ushtrimit jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësorë, ka përpiluar raportin lidhur me çështjen se vallë kërkesa për shkarkimin e ankuesit të parë ka qenë e arsyeshme dhe të njëjtin e ka dorëzuar deri te Këshilli gjyqësor.

Më 17 dhjetor të vitit 2008, në seancën e përgjithshme të Këshillit gjyqësor, në përbërjen e të cilit ka qenë edhe V.V., është shkarkuar ankuesi i parë për shkak të ushtrimit jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësorë.

Ankuesi i parë e ka kontestuar vendimin para instancave të shkallës së dytë, përkatësisht para Këshillit për vendosje në lidhje me ankesat, organ ky i formuar në suaza të Gjykatës supreme, por kjo ankesë ka qenë e refuzuar dhe ka qenë i konfirmuar vendimi i Këshillit gjyqësor.

### **Faktet relevante në lidhje me shkarkimin e ankuesit të dytë nga funksioni i gjykatësit (ankesa numër 58738/09)**

Fakte të ngjashme hasen edhe në procedurën për shkarkim të ankuesit të dytë, përkatësisht më datën 21 korrik të vitit 2008, R.P., anëtarë i Këshillit gjyqësor ka parashtruar kërkesën deri te Këshilli gjyqësor për inicim të procedurës për ushtrim jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësorë në lidhje me ankuesin e dytë. Shkaqet e kësaj kërkesë kanë qenë, pohimet se në veti të gjykatësit kujdestar hetues, ankuesi i dytë nuk ka manifestuar sjellje të përgjegjshme gjatë hetimit të incidentit i cili është shfaqur në qendrën e paraburgimit në Tetovë.

Në datën e papërcaktuar, Këshilli gjyqësor ka formuar komisionin për rastin e ankuesit të dytë dhe i njëjti ka parashtruar raportin në të cilin ka kërkuar iniciimin e procedurës kundër ankuesit të dytë për shkak të ushtrimit jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësorë.

Me dy vendimet e posaçme të sjella më datën 29 dhjetor të vitit 2008, në seancën e përgjithshme të Këshillit gjyqësorë, në të cilin R.P. ka qenë anëtarë, është iniciuar procedura kundër ankuesit të dytë për shkak ushtrimit jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësorë dhe është urdhëruar për suspendimin e tij të përkohshëm. Kundër vendimeve nuk ka ekzistuar mundësia e parashtrimit të ankesës.

Pas debatit të mbajtur gjyqësorë në të cilin kanë marrë pjesë ankuesi dhe R.P., ku i kanë prezantuar argumentet e tyre dhe fjalimet përfundimtare, më 12 shkurt të vitit 2009 në Seancën e përgjithshme të Këshillit gjyqësor, në përbërjen e të cilit ka marrë pjesë edhe R.P., është shkarkuar ankuesi i dytë për ushtrim jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësorë.

Ankuesi i dytë ka parashtruar ankesën kundër shkarkimit të tij deri te Këshilli për shqyrtimin e ankesave i cili ka qenë i formuar pranë Gjykatës supreme në lidhje me rastin e tij, duke pohuar mes tjerash se atij nuk i është dhënë rasti që të prononcohet në lidhje me dëshmitë që janë shpalosur kundër tij me rastin e dhënies së kërkesës për shkarkimin e tij. Por kjo ankesë është refuzuar.

Më 25 qershor të vitit 2009, ankuesi i dytë ka kontestuar shkarkimin e tij para Gjykatës administrative, me parashtrimin e padisë për kontestë administrative. Ai mes tjerave, është ankuar edhe për refuzimin e kërkesës së lartëpërmendur për përjashtimin e gjykatësve N.I. dhe J.V., të cilët kanë marrë pjesë gjatë sjelljes së vendimit të Këshillit për veprim në lidhje me ankesat lidhur me rastin e tij. Më pas, Gjykata administrative ka refuzuar padinë e ankuesit të dytë si të palejuar. Ky vendim ka qenë i konfirmuar nga ana e Gjykatës së lartë administrative.

## **ARSYETIMET E GJEDNJ**

Sipas parimeve të përgjithshme të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, paanshmëria nënkupton mungesën e paragjytimeve ose anshmërisë. Duke pasur parasysh faktin e praktikës gjyqësore, GJEDNJ paanshmërinë e përcakton me:

- testin e subjektivitetit, ku duhet të merret parasysh fakti i bindjes personale dhe i sjelljes së një gjykatësi të caktuar, përkatësisht vallë gjykatësi ka manifestuar çfarëdo paragjytime personale ose anshmëri për rastin konkret; dhe
- testin e objektivitetit, përkatësisht me përcaktimin se vallë vetë tribunali dhe përbërja e tij, kanë ofruar garanca të mjaftueshme që të përjashtohet çfarëdo dyshim i arsyeshëm në lidhje me paanshmërinë e tij.

Duke i pasur parasysh rregullat e procedurës së përshkruar më lartë, sipas GJEDNJ parashtruesit e kërkesave kanë gëzuar të drejtat si palë e procedurës së kontestuar. Kërkesat e tyre kanë rezultuar me procedurën e kontestuar, por në të njëjtën ata janë

përfaqësuar dhe kanë vepruar si “prokuror” në raport me ankuesit të cilët në fakt kanë qenë në veti “të pandehurve”. Pas përfundimit të procedurës, parashtruesit e kërkesave, gjithashtu kanë qenë të trajtuar si palë në raport me vendimet e sjella në seancën e përgjithshme të Këshillit gjyqësor në lidhje me shkarkimin e ankuesve. Në rrethana të tilla, GJEDNJ konsideron se ky sistem hap dyshime objektive mbi aspektin e paanshmërisë së këtyre anëtarëve në rastin e vendosjes së qëndrueshmërisë juridike të rasteve që kanë të bëjnë me ankuesit.

Sipas kësaj, GJEDNJ konkludon se konfuzioni për rolet e parashtruesve të kërkesave në procedurat e kontestuara të cilat kanë rezultuar me shkarkimin e ankuesve, kanë nxitur dyshime të arsyeshme objektive lidhur me paanshmërinë e Këshillit gjyqësor.

*Duke i pasur parasysh faktet e lartpërmendura, GJEDNJ ka sajuar konkludimin se në dy rastet ekzistojnë shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të Konventës.*

## **DËMSPËRBLIMI JURIDIK OSE KOMPENSIMI I DËMIT**

GJEDNJ ka vendosur se shteti duhet ti paguaj shumën prej 4.000 euro secilit prej ankuesve si dëmshpërblim jo material dhe shumën prej 300 euro ankuesit të dytë për mbulimin e shpenzimeve për përfaqësim para GJEDNJ.

3. **Poposki dhe Duma kundër Republikës së Maqedonisë**, ankesat me numër 69916/10 dhe 36531/11, lidhur me aktgjykimin e datës 07.01.2016

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) më datën 07.01.2016 solli aktgjykimin në lidhje me rastin Poposki dhe Duma kundër Republikës së Maqedonisë.

Ankuesit janë ankuar se Këshilli gjyqësor i cili i ka shkarkuar nga funksioni gjyqësor, nuk ka qenë “tribunal i pavarur dhe i paanshëm”.

## **FAKTET E RASTIT**

### **Shkarkimi i ankuesit të parë nga funksioni gjyqësor (ankesa numër 69916/10)**

N.H.A., anëtar i Këshillit gjyqësor, ka kërkuar që Këshilli gjyqësor të inicioj procedurën për përcaktimin e ushtrimit jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësor në lidhje me ankuesin e parë. Në kërkesën e tij N.H.A., ka pohuar se ankuesi i parë i ka shkelur rregullat për përfaqësim juridik të palëve në rastin kur ai ka qenë kompetent për vendosje.

Në lidhje me këtë rast është formuar Komisioni për përcaktimin e ushtrimit jo profesional dhe të pa ndërgjegjshëm të funksionit gjyqësor. Në bazë të kërkesës së N.H.A., përgjigjeve të ankuesit të parë dhe në bazë të dëshmive të ofruara, Komisioni ka dorëzuar raportin deri te Këshilli gjyqësor, me të cilin ai ka kërkuar që të iniciohet procedura kundër ankuesit të parë për përcaktimin e ushtrimit jo profesional dhe të pa ndërgjegjshëm të funksionit gjyqësor, gjë të cilën Këshilli gjyqësor e ka realizuar me aktvendim të posaçëm.

Më 10 nëntor të vitit 2009, Komisioni ka mbajtur debatin gjyqësor në të cilin janë marrë në pyetje N.H.A., dhe ankuesi i parë. Ankuesi i parë ka deklaruar se në atë rast ai ka dorëzuar kërkesë me shkrim për përjashtimin e N.H.A., duke u thirrur në mungesën e paanshmërisë, por me këtë rast nuk është sjell vendimi në lidhje me këtë kërkesë.

Më 9 dhjetor të vitit 2009, në seancën e përgjithshme të Këshillit gjyqësor në të cilin ka qenë i përfshirë edhe N.H.A., është shkarkuar ankuesi i parë nga funksioni gjyqësor për shkak të ushtrimit jo profesional dhe të pa ndërgjegjshëm të funksionit gjyqësor, duke rezultuar me konkluzionin se ai i ka shkelur rregullat e përfaqësimit juridik dhe të drejtë të palëve.

Ankuesi i parë e ka kontestuar këtë vendim para instancave të shkallës së dytë, përkatësisht para Këshillit për vendosje në lidhje me ankesat, trup ky i formuar pranë Gjykatës supreme. Ankuesi gjithashtu ka kërkuar largimin e gjykatësit T.S., nga Këshilli për vendosje në lidhje me ankesat, për shkak të marrëdhënieve jo të mira personale me të njëjtin. Më 22 mars të vitit 2010, kryetari i Gjykatës supreme, e ka refuzuar kërkesën e ankuesit të parë, duke mos gjetur bazën e qëndrueshmërisë në lidhje me dyshimet për paanshmërinë e gjykatësit T.S.

Më 27 prill të vitit 2010, Këshilli për vendosje lidhur me ankesat, në të cilin në veti të anëtarit ka qenë gjykatësi T.S., ka refuzuar ankesën dhe ka konfirmuar vendimin e Këshillit gjyqësor për shkarkimin e tij, vendim ky i sjell më 9 dhjetor të vitit 2009.

### **Faktet relevante në lidhje me shkarkimin e ankuesit të dytë nga funksioni i gjykatësit (ankesa numër 36531/11)**

Me dy parashtresa të veçanta, më datën 8 qershor dhe 26 gusht të vitit 2009, ministri i drejtësisë i cili ka qenë anëtarë i Këshillit gjyqësor në pajtim me funksionin që ka ushtruar, nga Këshilli gjyqësor ka kërkuar që të inicioj procedurën kundër ankuesit të dytë për përcaktimin e ushtrimit jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësor. Kërkesat kanë qenë në lidhje me dy lëndë të veçanta penale (Kok. Nr. 7/08 dhe K. Nr. 1297/02-I), në të cilat ankuesi i dytë ka qenë kryetar i këshillave që kanë vendosur në lidhje me këto lëndë. Me këtë rast janë ofruar argumente se ajo ka dështuar që të identifikoj identitetin e personit të gjykuar (në lidhje me lëndën numër Kok.nr. 7/08) dhe se ka pasur konflikt të interesave (në lëndën nr. K.nr.129/02 – I).

Këshilli gjyqësor ka formuar Komisionin në lidhje me rastin e ankuesit të dytë, në të cilin nuk ka qenë anëtarë ministri i drejtësisë. Në bazë të kërkesave, përgjigjes së ankuesit të dytë dhe dëshmive të siguruar, Komisioni ka dorëzuar raportin deri te Këshilli gjyqësor në

të cilin ka kërkuar që të iniciohet procedura kundër saj, për përcaktimin e ushtrimit jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësor.

Më 12 mars të vitit 2010, në seancën plenare të Këshillit gjyqësor është iniciuar procedura kundër ankuesit të dytë për shkak të ushtrimit jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësor dhe me vendim gjykatësja përkohësisht ka qenë e suspenduar nga funksioni i gjykatësit.

Më 24 mars të vitit 2010, kryetari i Këshillit gjyqësor e ka refuzuar si të pa bazë ankesën e ankuesit të dytë kundër vendimit të lartërmendur. Në të njëjtën ditë, kryetari i Këshillit gjyqësor nga Këshilli gjyqësor ka kërkuar që të inicioj procedurën për përcaktimin e ushtrimit jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësor edhe për gjykatësit tjerë të cilët kanë vendosur së bashku me ankuesin e dytë, pranë Gjykatës së Apelit Shkup në lidhje me lëndën penale numër Kok. Nr. 7/08. Baza juridike e kërkesës ka qenë e njëjtë sikur edhe baza juridike e theksuar në lidhje me kërkesën e 8 qershorit të vitit 2009.

Më 25 mars të vitit 2010, kryetari i Këshillit gjyqësor është pajtuar që të bëhet parashtrues në lidhje me kërkesat e 26 gushtit të vitit 2009 dhe të kërkesës nga data 24 mars e vitit 2010. Është arritur marrëveshja që këto procedura të bashkohen.

Më 5 maj të vitit 2010, kryetari i Komisionit të formuar në lidhje me rastin e ankuesit të dytë, ka refuzuar kërkesën e saj për debat publik. Në vendimin është theksuar se procedura për përcaktimin e ushtrimit jo profesional dhe të pa ndërgjegjshëm të funksionit gjyqësor para Këshillit gjyqësor është me karakter të besueshëm dhe se ajo zhvillohet në mungesë të publikut me qëllim që të mbrohet integriteti i gjykatësit kundër të cilit është iniciuar procedura e njëjtë.

Më 15 qershor të vitit 2010, në seancën e përgjithshme të Këshillit gjyqësor, duke e përfshirë këtu edhe ministrin e drejtësisë dhe kryetarin e Këshillit gjyqësor, është shkarkuar ankuesi i dytë dhe gjykatësi V.XH., nga funksioni gjyqësor për shkak të ushtrimit jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësor. Bazat juridike për shkarkimin e ankuesit të dytë, kanë qenë po të njëjtat sikur edhe në kërkesën për shkarkimin e parashtruar nga ana e ministrit për drejtësi. Këshilli gjyqësor ka ndërprerë procedurën për përcaktimin e ushtrimit jo profesional dhe të pa ndërgjegjshëm të funksionit gjyqësor në lidhje me gjykatësit tjerë të theksuar në kërkesën e 24 marsit të vitit 2010. Vendimi i është dorëzuar ankuesit të dytë, parashtruesit të kërkesës dhe kryetarit të Gjykatës së Apelit Shkup.

Ankuesi i dytë ka parashtruar ankesën deri te Këshilli për vendosje në lidhje me ankesat pranë Gjykatë supreme, kundër shkarkimit të lartpërmendur. Ajo është ankuar se ministri i drejtësisë si anëtarë i Këshillit gjyqësor në bazë të funksionit, dhe si person i cili ka iniciuar procedurën për shkarkimin e saj, ka qenë në veti të palës në vendimin për shkarkimin e saj. Ajo ka kërkuar lejen për pjesëmarrje në seancën para Këshillit për vendosje në lidhje me ankesat me qëllim që të ofroj arsyetimet në lidhje me rastin e saj.

Në debatin e mbajtur më 10 dhjetor të vitit 2010, në prani të ankuesit të dytë, Këshilli për vendosje në lidhje me ankesat i formuar pranë Gjykatës supreme për rastin e saj, e ka konfirmuar vendimin për shkarkim në bazë të shkaqeve të ofruara nga Këshilli gjyqësor.



Ankuesi i dytë, ka parashtruar ankesë kushtetuese deri te Gjykata kushtetuese, duke pohuar se shkarkimi i saj paraqet shkelje të të drejtave të saja kushtetuese. Më 22 qershor të vitit 2011, Gjykata kushtetuese ka refuzuar ankesën e saj duke theksuar se nuk është kompetent që ta rishqyrtoj ligjshmërinë e vendimit të Këshillit gjyqësor. Në lidhje me atë se vallë shkarkimi i ankuesit të dytë ka përfshirë lirinë e saj të shprehjes, Gjykata kushtetuese ka vlerësuar se duhet të bëhen dallime në mes ushtrimit të funksionit gjyqësor dhe lirisë së shprehjes. Gjykata kushtetuese, ka sjell aktgjykimin se funksioni gjyqësor paraqet të drejtën dhe detyrën për vendosje në pajtim me ligjin dhe se kjo e drejtë dhe detyrë nuk bën pjesë në të drejtat dhe liritë për të cilat kjo gjykatë është kompetente që të vendos në suaza të Kushtetutës.

## **ARSYETIMET E GJEDNJ**

Sipas parimeve të përgjithshme të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, paanshmëria nënkupton mungesën e paragjyqimeve ose anshmërisë. Duke pasur parasysh faktin e praktikës gjyqësore, GJEDNJ paanshmërinë e përcakton me:

- testin e subjektivitetit, ku duhet të merret parasysh fakti i bindjes personale dhe i sjelljes së një gjykatësi të caktuar, përkatësisht vallë gjykatësi ka manifestuar çfarëdo paragjyqime personale ose anshmëri për rastin konkret; dhe
- testin e objektivitetit, përkatësisht me përcaktimin se vallë vetë tribunali dhe përbërja e tij, kanë ofruar garanca të mjaftueshme që të përjashtohet çfarëdo dyshim i arsyeshëm në lidhje me paanshmërinë e tij.

GJEDNJ thekson faktin se në bazë të Ligjit për Këshillin gjyqësorë i cili është në fuqi, cilido prej anëtarëve të Këshillit gjyqësor, nga Këshilli gjyqësor mund të kërkoj që të përcaktohet se vallë ka ekzistuar ushtrimi jo profesional dhe i papërgjegjshëm i funksionit gjyqësor nga ana e gjykatësit. Në fakt, procedura e tillë ka qenë e kërkuar edhe nga ana e N.H.A., anëtarë i Këshillit gjyqësorë në lidhje me ankuesin e parë, por edhe nga ana e ministrit të drejtësisë në lidhje me ankuesin e dytë. Më pas, kryetari i Këshillit gjyqësor ka marrë rolin e ministrit si parashtrues.

Duke i pasur parasysh rregullat e procedurës së përshkruar më lartë, GJEDNJ konsideron se parashtruesit e kërkesave kanë gëzuar të drejtën në veti të palës gjatë procedurës së kontestuar. Kërkesat e tyre, kanë rezultuar me procedurën e kontestuar dhe sipas kësaj ata kanë vepruar si “prokurorë” në raport me ankuesit përkatësisht “të pandehurit” në këtë rast. Pas përfundimit të procedurës, parashtruesit e kërkesave gjithashtu kanë qenë të përfaqësuar në veti të palës në vendimet e seancës së përgjithshme të Këshillit gjyqësor, në lidhje me shkarkimin e ankuesve.

Në rrethana të tilla, GJEDNJ konsideron se sistemi në të cilin anëtarët e Këshillit gjyqësor, të cilët i kanë zbatuar para hetimet dhe në kërkesën e të cilëve janë iniciuar procedurat e kontestuara, më vonë kanë marrë pjesë në procesin e sjelljes së vendimeve për shkarkimin e ankuesve nga funksionet e gjykatësve. E gjithë kjo rezulton me lindjen e

dyshimeve mbi paanshmërinë e atyre anëtarëve në kohën kur është vendosur për qëndrueshmërinë juridike të rasteve që kanë të bëjnë me ankuesit.

Sipas kësaj, GJEDNJ konkludon se konfuzioni lidhur me rolet e parashtruesve të kërkesave në procedurat e kontestuara të cilat kanë rezultuar me shkarkimin e ankuesve, kanë nxitur dyshime të arsyeshme dhe objektive për paanshmërinë e Këshillit gjyqësor.

*Duke i pasur parasysh faktet e lartpërmendura, GJEDNJ ka sjuar konkludimin se në dy rastet ekzistojnë shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të Konventës.*

## **DËMSPËRBLIMI JURIDIK OSE KOMPENSIMI I DËMIT**

GJEDNJ ka vendosur se shteti duhet ti paguaj shumën prej 4.000 euro, secilit prej ankuesve si dëmshpërblim jo material dhe shumën prej 150 euro ankuesit të dytë për mbulimin e shpenzimeve për përfaqësim para GJEDNJ.

### **4. Neshkoska kundër Republikës së Maqedonisë, A.nr. Ankesa numër 60333/13, aktgjykimi i datës 21.01.2016**

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) më datën 21.01.2016 ka sjell aktgjykimin në lidhje me rastin Neshkoska kundër Republikës së Maqedonisë.

Aplikuesja është ankuar se sipas nenit 2 dhe 13 të Konventës, hetimi për vrasjen e djalit të saj nuk ka qenë efektiv dhe se asaj në këtë drejtim nuk i është ofruar mjete përkatës juridik.

## **FAKTET E RASTIT**

### **Ngjarjet të cilat i kanë paraprirë hetimit**

Më 6 qershor të vitit 2011, rreth orës 00:20 pas mesnate, I.S., përkatës i Njësitit për detyra të specializuara pranë Ministrisë së punëve të brendshme, ka vrarë M.N., në sheshin qendrorë në Shkup gjatë manifestimit publik lidhur me rezultatet e zgjedhjeve parlamentare. Vrasja ka ndodhur pasi që M.N. është orvatur që të ngjitet në binë me qëllim që ti afrohet politikanëve të rangut të lartë, edhe pse I.S. e ka paralajmëruar atë që mos ta bëjë këtë. Pas kësaj M.N. ka ikur dhe I.S. e ka ndjekur atë dhe e ka goditur në pjesën e prapme të qafës, pas kësaj edhe pas rrënies së M.N., I.S. ka vazhduar që ta godas dhe shkelmojë atë. Ashtu siç është konstatuar në raportin e obduksionit të datës 6 qershor të vitit 2011, të përpiluar nga Instituti për mjekësi ligjore, M.N. ka pësuar lëndime

të shumta dhe të rënda trupore, dhe se shkaku i vdekjes ka qenë hemorragjia cerebrale. M.N. ka vdekur në ora 0:30 pas mesnate. Gjykatat kanë konstatuar (në kundërshtim me deklaratën e I.S.), se në kohën relevante I.S. nuk ka qenë i angazhuar për ushtrim të detyrës, por se ai ka marrë pjesë në solemnitetin e lartpërmendur.

Pasi që zëdhënësi i Ministrisë për punë të brendshme, më 7 qershor të vitit 2011 ka kumtuar se për shkaktimin e vdekjes së M.N., ka qenë i dyshar një nëpunës i shërbimeve policore, me mijëra njerëz kanë dalë nëpër rrugët e Shkupit që të protestojnë. Këto protesta kanë zgjatur dyzet ditë dhe të njëjtat janë shëndërruar në lëvizjen e quajtur “Stop për brutalitetin policor”. Më 14 qershor të vitit 2011, më shumë se gjashtë mijë qytetarë kanë nënshkruar peticionin me të cilin kanë kërkuar që organet kompetente ta përcaktojnë të vërtetën për vdekjen e M.N., dhe ti dënojnë personat përgjegjës, si dhe të implementojnë masat ligjore, strukturore dhe masat tjera për veprimtarinë, punësimin dhe përgjegjësinë e nëpunësve pranë Ministrisë për punë të brendshme.

### **Procedura penale**

Më 8 qershor të vitit 2011, prokurori publik nga gjykatësi hetues ka kërkuar që të inicioj hetimet kundër I.S., në lidhje me vdekjen e M.N. Gjykatësi hetues ka përcaktuar masën e paraburgimit. Më 3 tetor të vitit 2011, prokurori publik ka ngritur aktakuzën kundër I.S., duke e ngarkuar të njëjtin për vrasje. Në aktakuzën, prokurori nga gjykatësi i shkallës së parë ka kërkuar që ta marrë në pyetje I.S., aplikuesen, njëzeteshtatë dëshmitarët dhe katër ekspertët si dhe të lejoj shpalosjen e një numri të madh të dëshmive materiale. Gjykimi i I.S., ka filluar në Gjykatën themelore Shkup I, ku janë marrë në pyetje më shumë se tridhjetë dëshmitarë dhe aty janë shqyrtuar dëshmitë dhe raportet nga rikonstruksioni i ngjarjes, dëshmitë e siguruara nga ekspertët e mjekësisë ligjore, fotografitë dhe dëshmitë tjera të dokumentuara.

V.B., i punësuar në ndërmarrjen publike për energji elektrike, i cili ka qenë dëshmitarë i këtij incidenti, ka dëshmuar dhe konfirmuar në veçanti faktin se I.S., ka ndjekur M.N., dhe se e ka goditur atë në pjesën e prapme, dhe si rezultat i kësaj M.N., ka rënë në tokë, duke e goditur në pjesën e prapme të kokës gjatë rënies. I.S., ka goditur M.N. dy herë në pjesën e stomakut; M.N., ka humbur vetëdijen. I.S., ka ngritur M.N., dhe e ka vendosur në ulësen e afërt dhe gjatë kësaj ai është përpjekur që ta ri animoj atë. Pas arritjes së nëpunësve të shërbimit policor, V.B. dhe I.S., e kanë ngritur M.N. nga ulësja dhe e kanë zhvendosur në vendin ku ndihma e parë ka pasur qasje më të lehtë deri te vendi i ngjarjes. V.B., ka deklaruar se nuk janë vërejtur lëndime të dukshme trupore te M.N.

Më 16 janar të vitit 2012, gjykata e shkallës së parë ka sjell aktgjykimin me të cilin ka përcaktuar se I.S., ka qenë fajtor për vrasjen e M.N., dhe të njëjtin e ka gjykuar me burgim në kohëzgjatje prej katërmëdhjetë viteve. Më pas, gjykata e ka udhëzuar aplikuesen (e cila i bashkëngjitet ndjekjes penale si përfaqësues ligjor i të ndjerit M.N.) që të theksoj kërkesën e dëmit me parashtrimin e paditës së posaçme civile për kompensim të dëmit. Më 9 korrik të vitit 2012, Gjykata e apelit Shkup e ka konfirmuar gjendjen faktike të përcaktuar nga ana e gjykatës së instancës më të ulët, gjykimin dhe dënimin e I.S. Më 7

maj të vitit 2013, Gjykata supreme e ka refuzuar kërkesën nga I.S., për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotfuqishëm dhe i ka konfirmuar aktgjykimet e miratuara nga gjykatat e instancave më të ulëta.

Më 12 tetor të vitit 2011, derisa ka zgjatur hetimi penal kundër I.S., aplikuesja ka parashtruar padi penale kundër Z.J., P.K., V.B. dhe nëpunësit të pa identifikuar të shërbimit policor, duke konstatuar se Z.J., dhe P.K., kanë bërë lëshim në lidhje me përcaktimin e identitetit të I.S., dhe në vend që ta arrestojnë të njëjtin, atij i kanë lejuar që ta braktis vendin e incidentit. Në lidhje me V.B., aplikuesja ka pohuar se ai ka qenë në dijeni se I.S., ka kryer vrasjen e djalit të saj, por ka bërë përpjekje që ta fsheh veprën penale me zhvendosjen e trupit të M.N. dhe me mos paraqitjen e I.S., si shkaktar dhe realizues të veprës penale. Aplikuesja ka theksuar faktin se nëpunësi i pa identifikuar i shërbimit policor (i cili më vonë ka qenë i identifikuar si D.I.) gabimisht i ka treguar prokurorit publik dhe gjykatësit hetues se M.N., ka ndërruar jetën si rezultat i mbi dozimit me drogë.

Më 29 dhjetor të vitit 2011, prokurori publik ka refuzuar kallzimin penal të dorëzuar nga aplikuesja, duke konstatuar se nuk ka ekzistuar baza juridike me të cilën do të dëshmohej se Z.J., P.K., V.B., dhe D.I., i kanë kryer veprat e lartpërmendura penale. Prokurori ka konstatuar se Z.J. dhe P.K., nuk kanë qenë të pranishëm në çastin kur I.S., ka goditur M.N. Ata kanë arritur më vonë në vendin e ngjarjes dhe se ata nuk e kanë përcaktuar identitetin e I.S., i cili u ka thënë atyre se M.N., e ka humbur vetëdijen. Ata e kanë kontaktuar shërbimin e ndihmës së parë dhe e kanë njoftuar stacionin rajonal policor. B.S., dhe I.S., e kanë zhvendosur trupin e M.N. në sipërfaqen e afërt të gjelbëruar me qëllim që ta lehtësojnë qasjen e ndihmës së parë deri te vendi i ngjarjes.

Më 12 mars të vitit 2012, prokurori i lartë publik, ka konstatuar se ky aktgjykim ka qenë ligjor dhe i rregullt dhe se i njëjti është bazuar në materialet të cilat kanë qenë në disponim. Në seancën gjyqësore të mbajtur pa praninë e opinionit, më 10 maj të vitit 2012, këshilli i përbërë prej tre anëtarëve ka refuzuar aktakuzën e parashtruar nga aplikuesja, duke mos konstatuar baza juridike për devijime nga aktgjykimi i miratuar nga prokurori publik më datën 29 dhjetor të vitit 2011. Aplikuesja është ankuar kundër këtij aktgjykimi, duke kontestuar se gjatë veprimit të këshillit, nuk ka pasur kurrfarë hapa procedurale ose debate.

Më 10 shtator të vitit 2012, Gjykata e apelit Shkup ka refuzuar ankesën e aplikueses dhe ka konfirmuar aktgjykimin e sjell nga gjykata e instancës më të ulët. Ky aktgjykim i është dorëzuar aplikantes më 20 mars të vitit 2013.

## **ARSYETIMET E DHËNA NGA GJEDNJ**

Obligimi që të mbrohet e drejta e jetës, sipas nenit 2 të Konventës, është në lidhje me obligimin e përgjithshëm të shtetit, sipas nenit 1 të Konventës ku thuhet se : “çdonjërit nën jurisdiksonin e tij, shteti duhet ti siguroj të drejtat dhe liritë e përkufizuara me Konventën”, në mënyrë implicite imponon ekzistencën e ndonjë forme të hetimit efektiv zyrtarë në rastet kur ekzistojnë shkaqe që të besohet se ndonjë person ka vdekur nën

rrethana të dyshimta. Që një hetim të jetë efektiv, personat që janë kompetent dhe të cilët zbatojnë hetimet, duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm, si para ligjit ashtu edhe në praktikë. Qëllimi esencial i hetimit të tillë është siguri i zbatimit të ligjeve vendore të cilat mbrojnë të drejtën e jetës, dhe në rastet kur janë të përfshirë agjentët ose organet shtetërore, duhet të sigurojnë përgjegjësinë e tyre për rastet e vdekjes në rastet që bëjnë pjesë në ingjencat e tyre. Konkluzionet nga hetimi, duhet të bazohen në analizat e tërësishme, objektive dhe të paanshme të të gjitha elementeve relevante.

GJEDNJ konstatoi se argumentet e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me gjendjen faktike dhe çështjet juridike, mbështeten mbi një numri të madh të dëshmive gojore dhe të shkruara. Këto argumente kanë qenë të konfirmuara para tre instancave gjyqësore gjatë një periudhe kohore prej dy viteve. Gjykata sajoi konkluzionin se aplikuesja nuk e konteston gjendjen faktike të përcaktuar nga gjykatat vendore në lidhje me rolin e I.S., në incidentin e lartpërmendur. Prej këtui, Gjykata konsideron se veprimi i parregullt i theksuar më lartë, në lidhje me të cilin bazohet argumenti ankues, nuk ka qenë prejudikues për zbatim efektiv të hetimit, në kuptim të nenit 2 të Konventës në pjesën që ka të bëjë me përcaktimin e gjendjes relevante faktike dhe identifikimin dhe dënimin e I.S., personit përgjegjës për vdekjen e M.N., meqenëse dëshmitë e disponueshme dhe cilësia e tyre, të shpalosur gjatë debatit, nuk kanë qenë të komprometuar nga çfarëdo mangësie të theksuar, në të cilat mbështeten argumentet e ankesës. Prej këtui, Gjykata konsideron se nuk ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës për nga aspekti i tij procedural.

Duke pasur parasysh argumentet që kanë të bëjnë me nenin 2, Gjykata konsideron se edhe pse argumentet e ankesës, sipas nenit 13 dhe në lidhje me nenin 2 lejohen si të tilla, nuk ka nevojë për shqyrtim të posaçëm të tyre.

**5. *Ivanovski kundër Republikës së Maqedonisë*, A. numër 29908/11, aktgjykimi i datës 21.01.2016**

Më 21 janar të vitit 2016, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), solli aktgjykimin në lidhje me rastin Ivanovski kundër Republikës së Maqedonisë, me të cilin konstatoi shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), në bazë të shkëljes së drejtësisë për nga aspekti i procedurës dhe të nenit 8 të Konventës, i cili ka të bëjë me të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare. Rasti ka të bëjë me procedurën e lustrimit të aplikuesit, i cili si pasojë e njëjtës ishte i shkarkuar nga funksioni i gjykatësit pranë Gjykatës kushtetuese të Republikës së Maqedonisë.

Në vijim pason prezantimi i shkurtër i aktgjykimit të GJEDNJ, duke i përfshirë edhe faktet e rastit të lartpërmendur, argumentet e aplikuesit si dhe arsyetimet e GJEDNJ.

## **GJENDJA FAKTIKE**

Trendafil Ivanovski (aplikuesi) ka qenë kryetar i Gjykatës kushtetuese dhe në veti të bartësit të funksionit publik në vitin 2009, deri te Komisioni për lustrim ka dorëzuar deklaratën se nuk ka bashkëpunuar me organet e sigurisë shtetërore. Deklarata ka qenë e dorëzuar në pajtim me Ligjin për lustrim nga viti 2008, në pajtim me këtë deklaratë, mosbashkëpunimi me organet e sigurisë shtetërore gjatë periudhës së viteve 1944 dhe 2008, ishte i implementuar si kusht plotësues për ushtrimin e funksionit publik.

Gjatë vitit 2010, Komisioni për lustrim ka kërkuar nga Arkivi shtetërorë i R. Maqedonisë, qasje të drejtpërdrejtë për kontrollimin e të gjitha të dhënave të disponueshme, shkresave dhe dokumenteve të tjera në lidhje me aplikuesin dhe në bazë të kësaj, ka sajuar konkludimin se deklarata e aplikuesit nuk ka qenë në pajtim me dëshmitë me të cilat ka disponuar. Aplikuesi ka kontestuar konkluzionin e tillë iniciues të Komisionit, në kohën e debatit publik i cili është mbajtur më 27 shtator të vitit 2010.

Me vendimin e datës 29 shtator të vitit 2010, Komisioni ka refuzuar parashtresën e aplikuesit i cili nuk ka qenë në pajtim me informatat e disponueshme dhe prej këtu është konstatuar se aplikuesi nuk e ka përmbushur kushtin plotësues për ushtrim të funksionit publik. Vendimi është mbështetur në dosjen personale të aplikuesit sipas të cilit aplikuesi ka qenë i përfshirë në grupin nacionalist të shkollarëve të mesëm. Bashkëpunimin e ka filluar gjatë vitit 1964 dhe ai ka qenë i çregjistruar në vitin 1983, gjatë kësaj ai ka ofruar informacione për studentët të cilët kanë qenë të ndjekur nga ana e shërbimeve të sigurisë.

Aplikuesi ka parashtuar padinë deri te Gjykata administrative, kundër vendimit të miratuar nga ana e Komisionit më datën 29 shtator të vitit 2010, në këtë ankesë ai është ankuar në lidhje me aspektin e padrejtësisë së procedurës së lartëpërmendur. Ai në veçanti është ankuar për mungesën e mundësisë që tërësisht ti shpalos argumentet e veta në lidhje me informatat e klasifikuara (të besueshme) në lidhje me lëndën; afatin e shkurtuar efektiv për përpilimin e padisë së tij dhe për dallimet evidente në mes shkresave në Arkivin shtetërorë dhe shkresave të Komisionit, deri te cilat ai më parë ka pasur qasje.

Gjykata administrative, ka sjell aktgjykimin me të cilin e ka refuzuar padinë e aplikuesit.

Aplikuesi deri te Gjykata supreme ka parashtuar padinë në muajin nëntor të vitit 2010 dhe i ka përsëritur argumentet e lartëpërmendura. Me aktgjykimin e muajit mars të vitit 2011, Gjykata supreme e ka refuzuar ankesën e aplikuesit dhe ka konfirmuar aktgjykimin e Gjykatës administrative.

Në muajin prill të vitit 2011, në bazë të Ligjit për lustrim dhe në bazë të konkluzionit të Komisionit, Parlamenti ka konstatuar se aplikuesi nuk e ka përmbushur kushtin plotësues dhe në pajtim me këtë e ka shkarkuar të njëjtin nga funksioni i gjykatësit pranë Gjykatës kushtetuese.

## ARSYETIMET E GJEDNJ

### 1. Neni 6 i KEDNJ

Aplikuesi para GJEDNJ ka theksuar shumë argumente për shkeljen e më shumë aspekteve të ndryshme, përkatësisht shkeljen e të drejtave që pasojnë nga neni 6 i KEDNJ.

GJEDNJ si të pa kontestuar e ka konstatuar zbatimin e nenit 6 të Konventës në lidhje me rastin konkret. Gjatë kësaj, Gjykata nuk ka konstatuar shkelje të nenit 6, paragrafi 1 të Konventës, në bazë të mungesës së qasjes deri te gjykata, duke pasur parasysh faktin se vendimi i Komisionit për lustrim në rastin konkret të aplikuesit, ka qenë nën mbikëqyrjen gjyqësore të Gjykatës administrative dhe më pas edhe nën mbikëqyrjen e Gjykatës supreme, si gjykata me “kompetencë të plotë” të cilët e kanë shqyrtuar gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës gjatë veprimit në lidhje me lëndën e aplikuesit.

GJEDNJ ka konstatuar shkelje të nenit 6, paragrafi 1 të Konventës në bazë të mungesës së aspektit të drejtësisë gjatë procedurës, marrë si një tërësi. Përkatësisht, duke pasur parasysh faktin se në rastin e shqyrtuar janë shpalosur argumente të ndryshme në favor të konstatimit për padrejtësinë e procedurës vendore, në lidhje me më shumë aspekte të ndryshme që kanë të bëjnë me nenin 6 të Konventës. GJEDNJ ka konstatuar se në rrethana të tilla, si qasje më përkatëse do të ishte shqyrtimi i aspektit të drejtësisë së procedurës marrë si një tërësi e vetme. Gjatë kësaj, gjykata ka pasur parasysh faktin se në pajtim me praktikën gjyqësore të kësaj Gjykate, mund të sajohet konkludimi se procedura marrë si një tërësi, nuk ka qenë e drejtë, bile edhe në rastet kur secili prej efekteve procedurale, marë në veçanti, nuk do ta sillnin Gjykatën në konkluzione të njëjta.

Duke i pasur parasysh argumentet e aplikuesit në këtë kontekst, GJEDNJ ka konstatuar se në këtë rast ka munguar anshmëria subjektive te gjykatësit të cilët kanë vepruar në lidhje me lëndën e aplikuesit, për shkakun se asgjë nuk dëshmon për anshmërinë e tyre ose ri bindjen personale në lidhje me lëndën e aplikuesit, por gjykata i ka klasifikuar si të qëndrueshme dyshimet për pavarësi dhe paanshmëri në pajtim me testin e objektivitetit lidhur me paanshmërinë dhe pavarësinë.

Prej këtu, Gjykata ka sajuar konkludimin se ekzistojnë shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me aspektin e tërësishtëm të padrejtësisë së procedurës në lidhje me rastin konkret.

Në favor të konkluzionit të GJEDNJ, se procedura për lustrimin e aplikuesit ka qenë e padrejtë, marë në tërësi, Gjykata ka konstatuar si të panevjuhme që ti shqyrtoj argumentet tjera të aplikuesit të cilat ai ka ofruar si shtojcë të konstatimit për qasje të padrejtë të procedurës në fjalë, në veçanti në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatësve të cilët kanë vendosur në lidhje me lëndën e aplikuesit dhe në këtë kontekst edhe të argumenteve të shpalosura në lidhje me avancimin e karrierës së gjykatësve të njëjtë.

Aplikuesi para Gjykatës ka theksuar argumentet për shkeljen e aspekteve të tjera që kanë të bëjnë me nenin 6 të KEDNJ, në veçanti në lidhje me barazinë e mjeteve juridike dhe

kontradiktave të procedurës, të cilat GJEDNJ vendosi që mos ti shqyrtoj në dritën e konkluzionit të lartpërmendur për shkeljen e së drejtës për procedurë të drejtë.

## 2. Neni 8 i KEDNJ

Aplikuesi thekson tre argumente të ndryshme që kanë të bëjnë me shkeljen e nenit 8 të KEDNJ. Njëri ka të bëjë me faktin se procedura për lustrim ka pasur ndikime negative mbi autoritetin, dinjitetin dhe integritetin moral të tij, që është në kundërshtim me nenin 8, i cili garanton edhe të drejtën e autoritetit dhe dinjitetit, kurse argumenti i dytë është në lidhje me theksimin e qasjes së pa autorizuar deri te dosjet e shërbimeve të sigurisë dhe argumenti i tretë ka të bëjë me faktin se ai ka mbetur i regjistruar në evidencat e tilla, gjë që ka shkelur të drejtën e tij në pajtim me nenin 8 të KEDNJ.

GJEDNJ konstatoi se është i lejuar argumenti i aplikuesit në lidhje me procedurën për lustrim, dhe konstatoi mos qëndrueshmërinë e argumentit të ofruar nga ana e aplikuesit që ka të bëjë me faktin se ai ka mbetur i regjistruar në evidencat e shërbimeve të mëparshme të sigurisë, duke pasur parasysh faktin se në praktinën e saj të mëparshme, GJEDNJ tani më ka konstatuar se masat për lustrim, synojnë drejtë qëllimeve legjitime në pajtim me nenin 8, paragrafi 2 të KEDNJ. Prej këtu është sajuar konkluzioni se ruajtja e dosjeve të shërbimeve të sigurisë, nga regjimi i mëparshëm për qëllime të lustrimit, vetëvetiu nuk mund të konsiderohet si kundërshtim i KEDNJ. Në lidhje me argumentet e aplikuesit për qasje të pa autorizuar deri te të dhënat personale të tij, përkatësisht deri te dosja personale e tij, GJEDNJ ka sajuar konkludimin se argumenti i tillë është i përfshirë në argumentet e theksuara në procedurat vendore, në kontekst të faktit se edhe dosja e tij ka qenë e falsifikuar.

Në lidhje me atë se vallë ka ekzistuar ndërhyrje në sferën e të drejtës së respektimit të jetës private të aplikuesit, GJEDNJ ka konstatuar ekzistimin e pakontestueshëm të pasojave mbi jetën private të aplikuesit, si rezultat i vendimit të Komisionit për lustrim dhe ndalesës së ushtrimit të funksionit publik.

Në lidhje me ligjshmërinë e ndërhyrjes së tillë, GJEDNJ ka marrë parasysh faktin se ndërhyrja në jetën private ka qenë e bazuar në Ligjin për lustrim, dhe se ndërhyrja e tillë ka qenë në qasje dhe e mundshme, dhe prej këtu edhe ndërhyrja në jetën private të aplikuesit ka qenë e ligjshme.

Në lidhje me qëllimin legjitim të ndërhyrjes në jetën private të aplikuesit, GJEDNJ edhe pse ka konstatuar se implementimi i lustrimit, gjashtëmbëdhjetë vite pas miratimit të Kushtetutës demokratike të shtetit, mund të inicioj dyshime në lidhje me qëllimet e saja të vërteta, duke pasur parasysh marginat e lejuara të zbatimit që u ofrohen shteteve, ka konstatuar gadishmërinë që të pranoj faktin se ndërhyrja në jetën private të aplikuesit ka qenë në pajtim me nenin 8 paragrafi 2 të Konventës, përkatësisht lustrimi ka pasur qëllime legjitime – mbrojtjen e sigurisë kombëtare.

GJEDNJ konstatoi se ndërhyrja në jetën private të aplikuesit nuk ka qenë “e domosdshme në shoqërinë demokratike”. Gjatë këtij konstatimi, GJEDNJ në aktgjykimin e tij përkujton



se ndërhyrja në jetën private konsiderohet si “e domosdoshme në shoqërinë demokratike”, nëse nënkupton:

- „nevojë të domosdoshme sociale”;
- në veçanti nëse është proporcional me qëllimin legjitim drejtë së cilës synon, dhe
- nëse shkaqet e ofruara nga ana e organeve vendore si arsye për këtë ndërhyrje janë “relevante dhe të mjaftueshme”.

Gjatë sajimit të konkluzionit të lartpërmendur, GJEDNJ ka marrë parasysh faktin se çështja për atë se vallë aplikuesi ka vepruar nën presione kur ka filluar bashkëpunimin me shërbimet, do të duhet të shqyrtohet si faktor kryesor gjatë balancimit të interesave të sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes së drejtave të aplikuesit. Prapëseprapë, në pajtim me legjislativin vendor, institucionet kombëtare, duke i përfshirë këtu edhe gjykatat nuk kanë qenë të detyruara që ta shqyrtojnë këtë çështje. Për këtë arsye, argumenti i aplikuesit për mungesën e pëlqimit për bashkëpunim ka qenë i vlerësuar si irelevant nga ana e gjykatave vendore. Për këto arsye, analiza e gjykatave vendore nuk ka qenë dhe nuk ka mundur të jetë e detajuar në masë të mjaftueshme që të sajohet konkludimi se ndërhyrja ka qenë “e domosdoshme në një shoqëri demokratike”, në kuptim të nenit 8 të Konventës.

Në çdo rast, GJEDNJ ka sajuar konkludimin se ndërhyrja në të drejtat e aplikuesit, lidhur me nenit 8 të Konventës, ka qenë jo proporcionale me qëllimin legjitim, drejtë realizimit të të cilit ka synuar ky lloj i ndërhyrjes. Gjatë sajimit të këtij konkluzioni, GJEDNJ ka pasur parasysh këtë:

- Si pasojë e rezultatit të procedurës për lustrim, aplikuesi jo vetë që ka qenë i shkarkuar nga funksioni i gjykatësit në Gjykatën kushtetuese, por është përfshirë edhe në një qasje të gjerë të kufizimeve në lidhje me punësimin e tij në periudhën prej 5 viteve të ardhshme;
- Ligji për lustrim ka qenë i miratuar rreth gjashtëmbëdhjetë vite pas miratimit të Kushtetutës demokratike të shtetit dhe se në këtë kuptim, çdo cenim potencial që do të paraqisnin të lustruarit në mënyrë iniciuese, me kalimin e kësaj kohe me siguri kjo mundësi është zvogëluar, gjë që sipas GJEDNJ është një faktor relevant gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes në jetën private;
- Fakti që aplikuesi ka qenë i rekrutuar nga ana e shërbimeve të mëparshme të sigurisë kur ai akoma ka qenë i moshës së mitur. Edhe përkaj konkluzionit të sajuar nga ana e organeve vendore se ai ka vazhduar bashkëpunimin me shërbimet edhe pas moshës së pjekurisë, kontaktet e tija me të njëjtit kanë pushuar më vonë deri në vitin 1983, rreth 27 viteve para fillimit të procedurës për lustrimin e tij. Për këto arsye GJEDNJ, siç thekson në atë gjykimin e tij, nuk ka fituar bindjen se pas kalimit të 27 viteve, aplikuesi ka prezantuar çfarëdo lloj cenimi, nëse fare edhe ka prezantuar cenim për shoqërinë demokratike, cenim i cili do të arsyetonte ndërhyrjen në jetën e tij private, në trajtën e kufizimit të përmasave të gjera mbi aktivitetet e veta profesionale në periudhën prej 5 viteve dhe stigmatizimin e bashkëpunëtorit. Stigmë të cilën ai do ta barte një periudhë edhe më të gjatë kohore. Në këtë kontekst, GJEDNJ vëren se organet vendore, të cilat

kanë vepruar me këtë lëndë të aplikuesit, nuk kanë bërë vlerësimin e rrezikut që ka paraqitur aplikuesi.

Prej këtu, Gjykata ka detektuar shkelje të nenit 8 të Konventës.

### 3. Neni 13 i Konventës.

Duke pasur parasysh argumentimet në lidhje me nenin 6, GJEDNJ ka sjuar konkludimin se është e domosdoshme të rishqyrtohet se vallë ekzistojnë shkelje të nenit 13 të Konventës.

## DËMSPËRBLIMI JURIDIK OSE KOMPENSIMI I DËMIT

GJEDNJ konstatoi ekzistimin e dëmit të natyrës jo materiale dhe në këtë bazë aplikuesit i përcakton shumën prej 4.500 euro. GJEDNJ gjithashtu aplikuesit i përcaktoi shumën prej 850 euro si kompensim për shpenzimet e realizuara gjatë procedurës së përfaqësimit të tij para gjykatës ndërkombëtare.

### 6. *Mitrova dhe Saviq kundër Republikës së Maqedonisë*, A. numër 42534/09, aktgjykimi i datës 11.02.2016

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) më datën 11.02.2016 solli aktgjykimin në lidhje me rastin Mitrova dhe Saviq kundër Republikës së Maqedonisë.

Aplikuesit janë ankuar në lidhje me nenin 8 të Konventës, se atyre u është cenuar e drejta e jetës private dhe familjare, shtëpia dhe shkresat e tyre.

## FAKTET E RASTIT

Lënda pason nga fletë aplikimi (numër 42534/09) i parashtruar nga ana e dy aplikuesve, zonja Spaska Mitrova (në veti të “aplikuesit të parë”) dhe S. Saviq (në veti të “aplikuesit të dytë”) më 20 korrik të vitit 2009. Aplikuesi i parë është nëna e aplikuesit të dytë, të njëjtit jetojnë në qytetin e Gjevgjeliës dhe që të dy aplikuesit posedojnë nështetësi të Maqedonisë, kurse e ëma posedon edhe nështetësinë e Bullgarisë.

Aplikuesi i parë, ka qenë në lidhje bashkëshortore nga viti 2006, dhe gjatë kohëzgjatjes së kësaj lidhjeje ka lindur aplikuesi i dytë, zonjusha S. Saviq. Pas shkurrezimit gjatë vitit 2007, para Gjykatës themelore në Gjevgjeli, kujdestaria mbi vajzën i është përcaktuar aplikuesit të parë.

Argumentet ankuese të aplikuesit kanë të bëjnë me disa vendime (administrative, penale dhe civile) me të cilat është përcaktuar e drejta e vizitës dhe e drejta e përkujdesit, edukimit dhe e alimentacionit për S. Saviq, e cila pas divorcit të prindërve të saj, në vitin 2007 ka qenë nën përkujdesin dhe kujdestarinë e nënës së saj, zonjës Spaska Mitrova.

E drejta e vizitës dhe e takimeve me të atin e vajzës ka qenë e përcaktuar me Aktvendimin e miratuar nga ana e Qendrës për punë sociale. Pas disa refuzimeve të përsëritura nga e ëma e vajzës, që të mundësoj takimin e vajzës së saj me të atin, edhe përskaj Aktvendimit të miratuar, ajo ka qenë e shpallur si fajtoare gjatë dy fazave të veçanta gjyqësore, gjatë muajit korrik dhe muajit dhjetor të vitit 2007, me këtë rast asaj i është shqiptuar masa e arrestit të kushtëzuar.

Për shkak të gjendjes së tillë faktike, Qendra për punë sociale ka miratuar Aktvendimin me të cilin është zmadhur mundësia për kontakte në mes të atit dhe fëmijës. Edhe përskaj kësaj, e ëma ka vazhduar që ta pengoj të atin që të kontaktoj dhe vizitoj vajzën e tij, dhe si rezultat i gjithë kësaj ajo ka qenë e gjykuar për të tretën herë në muajin korrik të vitit 2008. Duke pasur parasysh faktin se dënimet e mëparshme me burgim, atë nuk e kanë ndaluar që të përsërit veprën, ajo ka qenë e gjykuar me burgim në kohëzgjatje prej 3 muajve. Fëmia është dhënë në përkujdesin e babait më 30 korrik të vitit 2009, në kohën kur e ëma ka filluar me vuajtjen e dënimit me burgim.

Pas lirimit të saj më 8 tetor të vitit 2009, Qendra për punë sociale ka vendosur që të organizoj takimin me fëmijën e saj dhe ky takim është realizuar për herë të parë pas lirimit të nënës, më 19 shkurt të vitit 2010.

Qendra për punë sociale, gradualisht e ka zmadhuar numrin e kontakteve, derisa e ëma sërish e ka fituar të drejtën e kujdestarisë në muajin shkurt të vitit 2011, pasi që është refuzuar kërkesa e babait për kujdestari, kërkesë kjo e parashtruar para gjykatës civile në muajin gusht të vitit 2008.

Në muajin mars të vitit 2012, Gjykata supreme ka anuluar aktgjykimin e miratuar nga gjykata e instancës më të ulët, dhe si shkak kryesor për këtë anulim ka qenë refuzimi i nënës që i ati të takohet me fëmijën gjatë periudhës nga muaji maj i vitit 2007 deri në muajin dhjetor të vitit 2008 dhe në këtë rast Gjykata supreme ka konstatuar se si interes më i favorshëm për fëmijën do të ishte që babait ti përcaktohet kujdestaria mbi fëmijën.

Menjëherë pas miratimit të këtij aktgjykimi, Qendra për punë sociale ka përcaktuar modus të ri të organizimit të kontratës në mes prindërve, sipas cilit gjatë ditëve të javës, vajza do të qëndroj me të ëmën kurse me babain do të qëndroj gjatë vikendeve. Kjo kontratë është në fuqi deri në çastin aktual.

Duke u thirrur në nenin 8 (e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare), aplikuesit ankohen për dënimin me burgim të nënës së fëmijës, më pas edhe për dëshimet e qendrës për punë sociale gjatë përcaktimit të takimeve me të ëmën për disa muaj me radhë, gjatë kohës së burgimit të saj si dhe për aktgjykimin e miratuar nga ana e Gjykatës supreme me të cilin i është marrë kujdestaria e ëmës mbi vajzën e saj.

## ARSYETIMET E GJEDNJ

### Aspekti i lejueshmërisë

Për nga aspekti i lejueshmërisë, GJEDNJ ka konstatuar se argumentet ankuese të aplikuesve ti shpall si të lejuara.

### Në lidhje me shkeljet e lartëpërmendura të nenit 8 të KEDNJ

Në bazë të argumenteve ankuese të aplikuesve, të cilat kanë të bëjnë me faktin se vallë dënimi me burgim është “i domosdoshëm në një shoqëri demokratike”, GJEDNJ ka konstatuar se këtë vedim do ta sjell duke e shqyrtuar rastin si një tërësi. Në lidhje me atë se nuk ka qenë i anashkaluar fakti se dënimi ka qenë i shqiptuar pasi që e ëma më parë ka qenë e gjykuar për veprën e njëjtë, dy herë me radhë asaj i është shqiptuar dënimi i kushtëzuar me burgim. Edhe përkaj këtyre akuzave dhe aktgjytimeve, e ëma ka vazhduar me mos bashkëpunimin dhe pengimin e takimeve me të atin e vajzës.

GJEDNJ, ka shprehur kënaqësi në lidhje me organet vendore të cilët kanë zbatuar vlerësimin e pranueshëm të fakteve relevante dhe që kanë ndërmarrë masën e cila është proporcionale me qëllimet legjitime të procedurës.

GJEDNJ nuk e konteston të drejtën e të burgosurit, për respektimin e jetës së tij familjare. E drejtë kjo të cilën organet kompetente kanë qenë të detyruar që t’ia mundësojnë ose të ndihmojnë për realizimin e kësaj të drejte, dhe gjatë kësaj gjykata vëren se gjatë kohës së arrestit, aplikuesit nuk kanë realizuar asnjë takim, por, në të njëjtën kohë gjykata vëren edhe atë se nga ana e aplikueses së parë nuk është parashtruar kërkesa për takime deri te Qendra, dhe se qendra nuk është kompetente që vetëvetiu sipas detyrës zyrtare ti përcaktoj të drejtat e tyre.

Menjëherë pas lirimit nga burgimi i aplikueses së parë, është parashtruar kërkesa për takim dhe kjo kërkesë ka qenë e shqyrtuar nga Qendra dhe me këtë rast është përcaktuar e drejta e vizitës. Duke pasur parasysh lartpërmendurën, GJEDNJ e përjashton përgjegjësinë e shtetit për mos takimin e aplikuesve.

Për sa i përket vendimit të Gjykatës supreme, me të cilin kujdestaria mbi vajzën i është përcaktuar të atit të saj, GJEDNJ shpreh kënaqësinë lidhur me vendimin e miratuar, me të cilin si primare janë konsideruar interesat më të mirë të fëmijës dhe ky vendim ka qenë në sferën e vlerësimit të lirë të Shtetit, dhe me këtë rast Gjykata konsideron se shkaqet e prezantuar janë relevante dhe të mjaftueshme.

Në aktgjykimin e tij në lidhje me rastin konkret, GJEDNJ ka konstatuar se shteti nuk ka shkelur nenin 8 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, me të cilën garantohet e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare, për arsye se të gjitha organet shtetërore të cilat kanë qenë të involvuar në lëndën e shqyrtuar, kanë vepruar në pajtim

me praktikën gjyqësore të GJEDNJ, dhe të njëjtit i kanë marrë parasysh interesat më të mira të fëmijës.

Vendimi ka qenë i miratuar me pesë vota “për” krahas dy votave “kundër”, dhe për këtë arsye gjykatësit të cilët janë prononcuar kundër vendimit kanë dorëzuar mendim të ndarë dhe të përbashkët me shkrim.